Ardian RAMADANI

SHPALOSJA E LABIRINTHIT

(STUDIME, ARTIKUJ DHE ANALIZA)

(STUDIME, ARTIKUJ DHE ANALIZA)

Ardian RAMADANI

SHPALOSJA
E
LABIRINTHIT

(STUDIME, ARTIKUJ DHE ANALIZA)

(STUDIME, ARTIKUJ DHE ANALIZA)

ARDIAN RAMADANI
SHPALOSJA E LABIRINTHIT

(Studime, Artikuj dhe Analiza)

Tetovë, 2010

Biblioteka: **Diplomaci-Publicistikë**

Titulli:
Shpalosja e labirinthit
(studime, artikuj dhe analiza)

Botues:
Autori

Redaktor
Prof. Asoc. Dr. Lisen Bashkurti
(Akademia Diplomatike Shqiptare)

Redaktore gjuhësore
Pranvera Nuhiu-Xheladini

Recensues:
Qerim Pllana, shkrimtar
(Lidhja e shkrimtarëve- Prishtinë)
Mr. Arsim Sinani
(Akademia Diplomatike Shqiptare)

Lektor:
Haqim Ibraimi

Përgatitja teknike:
Kastriot Osmani

Shtypi:
Shtypshkronja "GRAFOTEKS"- Kumanovë

CIP – Каталогизација во публикација
Народна и универзитетска библиотека "Св Климент Охридски", Скопје

327(497)

RAMADANI, Ardian
Shpalosja e labirintit: (studime, artikuj dhe analiza)/ Ardian Ramadani. - Kumanovë : Ramadani A., 2010.-182 str.;23 sm

Bibliografija: str. 173-176

ISBN 978-608-65156-0-7

a) Balkan-Me|unarodni politiſki priliki
COBISS.MK-ID 82975242

© Të drejtat e rezervuara të autorit

Ardian RAMADANI

SHPALOSJA E LABIRINTHIT
(STUDIME, ARTIKUJ DHE ANALIZA)

Tetovë, 2010

Përkushtim

Në shenjë respekti dhe dashurie, përjetësisht bashkëshortes sime, Gëzimes dhe birit tim, Florijonit

PARATHËNIE

Kolegu Mr. Ardian Ramadani në librin e tij "SHPALOSJA E LABIRINTHIT" me shumë pedantëri i është përkushtuar punës dhe me konsekuencë të pashoq mban qëndrim vertikal intelektual për të thënë të vërtetën dhe vetëm të vërtetën. Për të, na sjell një botim shumë të mirë dhe me shumë tema interesante për opinionin tonë.
Në këtë libër ai paraqitet me gjithë intelektin e tij, me fuqinë e tij krijuese dhe na bën analiza të rëndësishme si dhe sjell artikuj e tema të cilat duhet të lexohen me shumë kujdes.

Në të vërtetë, Ardiani me këtë libër shpalos vlerat e tija të pamohueshme intelektuale dhe shpresojmë se shumë shpejt do të bëjë edhe botime tjera me hulumtime dhe studime të rëndësishme mbi tema të caktuara, por ajo që shihet është se ai pëlqen të studiojë dhe flas me shumë zell për Francën dhe Risheljenë, për Ballkanin dhe popujt e tij, për problemet dhe vizionin për një të ardhme, si një i ri që kërkon të kalojë përtej mureve të Europës dhe të bëhet pjesë e këtij civilizimi dhe qytetërimi.

Më duhet të them se Libri "Shpalosja e labirinthit- Studime, Artikuj dhe Analiza", paraqet një botim shumë të veçantë që në vete ngërthen tema nga fusha e politologjisë, sociologjisë, historisë, diplomacisë. Poashtu në këtë libër do të mund të gjeni edhe tema nga kultura, nga jeta shoqërore dhe edukativo-arsimore. Ajo që vlen të thuhet është se kolegu Ardian Ramadani është i pasionuar pas gjuhës frënge dhe problematikave evropiane, ku me shumë kujdes na sjell tema që për botën shqiptare janë të veçanta dhe shumë domethënëse.

Analiza e Ardianit është shumë e thuktë për problemet që ka trajtuar dhe e përgëzoj për punën e bërë intelektuale, si dhe e inkurajoj atë dhe bashkëmoshatarët e tij që të na befasojnë me punime të këtilla që tregon për vlerat e mirrëfillta, qytetërimin dhe angazhimin e rinisë për të studiuar në tema që kanë të bëjne me Evropën dhe evropianët, me kulturën dhe civilizimin, me diturinë dhe diplomacinë.
Libri "Shpalosja e labirinthit" është një përpjekje e suksesshme, që trajton problematika nga më të ndryshmet dhe shumë interesante dhe të rëndësishme mbi të gjitha.

Nuk më mbetet asgjë tjetër, përpos që ta përgëzoj Ardianin për këtë përkushtim dhe t`i uroj sukses në punën e tij të mëtejme si studiues, si intelektual dhe si diplomat e pedagog.

Me shumë respekt,
Prof. Asoc. Dr. Lisen Bashkurti
Ambasador dhe President i Akademisë Diplomatike Shqiptare

Recension për librin "Shpalosja e labirinthit- Studime, Artikuj dhe Analiza", nga Mr. Ardian Ramadani

Libri **"Shpalosja e labirinthit- Studime, Artikuj dhe Analiza",** paraqet një ndihmesë të theksuar dhe të shquar nga lëmenjë të ndryshëm, edhe atë nga fusha e politikologjisë, sociologjisë, historisë, diplomacisë, kulturës, nga ajo shoqërore dhe edukative arsimore. Duke e lexuar librin mund të fitohet përshtypja se bëhet fjalë për një libër që ngërthen tematika të ndryshme që janë funksionale dhe tejet utilitare për rrethanat aktuale. Nëpërmjet këtij libri dhe tematikave të ndryshme përbrenda saj, autori na bën të ditur shumë gjëra, bën ndriçimin e shumë dukurive dhe fenomeneve të ndryshme që e shqetësojnë shkencën, shoqërinë dhe njeriun, si pjesë përbërëse të shoqërisë. Autori, analizon dhe shpalos gjëra që në dukje janë të lehta për t`u kuptuar, por nëse futemi në finesa do të gjendemi përballë shumë dilemave. Këto dilema autori i heq pa mëdyshje, duke qartësuar dhe elaboruar shumë gjëra që shfaqen si rebuse e që kërkojnë trajtim adekuat dhe cilësor. Është rast i veçant dhe njëherazi mjaft i gëzueshëm, kur një studiues mjaft i ri, rritet së bashku me rritjen e demokracisë në këtë pjesë të globit, merr pjesë aktive në procese të ndryshme shoqërore-politike dhe kulturore-edukative, si dhe me një portret të mprehtë, me një qëndrim serioz, me një disiplinë, dëshirë, kurajë dhe zell të pazakontë, i përqaset gjërave që duhet qasur me shumë vëmendje dhe guxim.

Tekstet e paraqitura në këtë libër, shumica janë më parë të botuara nëpër revista të ndryshme dhe gazeta, e që tani janë të përmbledhura si një tërësi homogjene dhe të lidhura në varg serik, saqë të japin impresionin se i ndihmojnë njëra-tjetrës dhe që çdo shkëputje eventuale mund të prishë kohezionin logjik të librit. Autori duke theksuar bindjet e tija, si dhe duke i argumentuar ato njëkohësisht bëhet protagonist i thënies " Atë që e bëra për shkencën i takon tërë botës".

Autori i librit përmes teksteve na bën me dije që shkenca pa ndërgjegje është shkatërrim i shpirtit. Andaj edhe është mjaft i ndërgjegjshëm për tekstet në fjalë. Të merresh me shkencë është satisfaksion, por njëkohësisht është edhe impenjim i mundimshëm dhe përgjegjësi. Shkenca vetvetiu paraqet dinjitet. Por ky dinjitet duhet të dihet se si duhet ndërtuar. Siç do të thoshte Danteja, ***"Rruga që të shpie kah lavdia, asnjëherë nuk ka qenë e shtruar me lule",*** është mjaft e qëlluar dhe domethënëse. Andaj edhe rruga e trasuar nga autori nuk është aspak e lehtë. Ajo bart në vete shumë sfida, provokime të kohës, por njëkohësisht edhe satisfaksionin shpirtëror për të nxjerrë në pah të vërtetën dhe vetëm të vërtetën. Shumë shekuj më parë dijetari i shquar francez **Sen Simoni,** njeri i ditur dhe pjesëtarë i elitës franceze kishte theksuar se për mbijetesën e shtetit dhe kombit francez nuk janë me rëndësi të madhe nëse vdesin pushtetarët, shtetarët, qeveritarët, mbretërit, fisnikët e ndryshëm, ministrat, këshilltarët, gjeneralët, klerikët, gjykatësit, prefektët. Për ta dhe mbijetesën e shtetit dhe kombit francez është më me rëndësi dhembja e madhe e humbjes, apo vdekja e disa fizikanëve, kimistëve, poetëve, skulptorëve, letrarëve, mjekëve, farmacistëve, arkitektëve, inxhinierëve, mekanikëve e shumë e shumë njerëzve të degëve të ndryshme dhe profesionistë tjerë. Andaj mund të shtojmë se inteligjenca nuk është diçka që mund të krijohet aty për aty ad-hoc. Ajo rritet dalëngadalë sikurse foshnja, kultivohet dhe gradualisht ngjizet, për t`u bërë e pavdekshme. I mjerë është ai popull i cili injoron inteligjencën e vet, por vaj halli për inteligjencën që nuk është në shërbim të popullit dhe kombit. Andaj besoj që autori i

këtyre teksteve bën pjesë në kategorinë e njerëzve të shkencës që e shohin veten si pjesë të inteligjencës aktive dhe jo pasive, të asaj vepruese e jo të asaj vëzhguese, injoruese, servile dhe nënshtruese.

Interesant në këtë libër është edhe stili i të shkruarit. Gjuha e përdorur në këtë libër është mjaft e pasur, kohezive dhe e kapshme për auditorin, sepse autori shkruan me një stil direkt, të qartë, komunikativ, pa komplikacione, pa dykuptimshmëri dhe pa dilema. Mund të ekzistoj vetëm dilema në mes të asaj se herë na shfaqet si publicist, e herë si studiues, analist e herë si komentator etj. Por, këtë mangësi e kemi secili nga ne. Megjithë kritikat eventuale që do të ishin të mirëseardhura, ky libër i ka vlerat e veta teorike dhe si i tillë paraqet një kontribut për ndriçimin e shumë dukurive dhe fenomeneve, sidomos të përditshmërisë sonë.

Qëndrimet e veta autori i shpreh me një origjinalitet që është karakteristike për njerëzit e dijes dhe shkencës. Shpresojmë se ky libër **"*Shpalosja e labirinthit- Studime, Artikuj dhe Analiza ", i autorit, Mr. Ardian Ramadani,*** në masë të madhe do të bind edhe lexuesin dhe auditorin për konstatimet, gjykimet dhe vlerësimet tona. Le të shërbejë si një udhërrëfyes dhe model edhe për të tjerët që duan të merren me shkencë.

Qerim Pllana, shkrimtar
Prishtinë, më 20.11.2009

Recension për librin "Shpalosja e labirinthit- Studime, Artikuj dhe Analiza", nga Mr. Ardian Ramadani

Jo rastësisht nuk është e thënë që njeriu është masë e të gjitha sendeve. Atë e bëjnë të përjetshëm vlerat e tij. Vlerat janë sinonim i sukseseve të njeriut. Kësisoj këto suksese duhet të materializohen dhe të shkruhen ndokund, sepse nëse mbeten të pashkruara, ato i merr era e harrimit. Në këtë libër autori paraqet një tablo të ngjarjeve të shumta nga fusha të ndryshme me të cilat është preokupuar dhe shqetësuar. Janë shkoqitur gjëra të cilat kanë të bëjnë direkt me impenjimet e tij, me rrethanat me të cilat ai është ballafaquar dhe me gjëra të cilat kanë pasur impakte direkte në mendësinë e tij. Kësisoj në fillim intervistat shërbejnë si uvertyrë për auditorin dhe lexuesin për të pasur një tablo të qartë dhe perceptim mbi autorin e librit. Mandej pjesët tjera lejnë hapësirë për të gjithë lexuesit që të kuptojnë mirë mundësitë dhe kapacitetet e tij për të analizuar fenomene të ndryshme, problematika dhe dukuri të ndryshme aktuale. Kësisoj shkrimet në këtë libër të cilët mund të jenë lexuar paraprakisht nga lexues të ndryshëm, sepse janë të botuara paraprakisht nëpër gazeta të ndryshme dhe të postuara në web portale të ndryshme, shërbejnë si një lajtmotiv për autorin dhe si një shtytje për të vazhduar më tutje të merret me analiza të ndryshme dhe me shkencën në përgjithësi. Edhe pse shkrimet në dukje shtjellojnë tematika të edukative, ata janë të lidhura në varg serik dhe çdo shkëputje eventuale do të zbehte kuptimin e librit në përgjithësi. Në shkrimet e tij autori nuk ka përdoruar aspak anime apo simpati ndaj ndonjë subjekti politik. Por përkundrazi dukuritë negative i ka shikuar nën prizmin e asaj që quhet objektivitet, sepse shkenca pa objektivitet është karikaturë. Siç do të thoshte Tolstoji:" njeriu është i lirë vetëm atëherë kur i shërben të vërtetës". Kjo thënie është udhërrëfyes për të personalisht, sepse gjërat e shpalosura përmes këtyre shkrimeve, artikujve apo analizave ai është munduar t`i vendos vetëm nën tutelën e objektivitetit dhe asaj që quhet reale. Jo rastësisht edhe titulli "Shpalosje e labirinthit" mund të deshifrohet shumë lehtë, se ka të bëjë me shpalosjen e së vërtetës e cila gjendet çdoherë para nesh, por ndonjëherë për shkak të subjektivitetit të tepruar, hezitohet që ta nxjerrim në shesh. E vërteta është prezent në mënyrë permanente dhe ajo është e vetmja, nuk mund të ketë dy të vërteta, por vetëm një. Ajo nuk len hapësirë për ambiguitete dhe dilema, edhe pse gjendet në labirinthin e dilemave dhe ambiguiteteve. Megjithë qëndrimin e saj në labirinth, ajo mundet shumë lehtë të nxirret prej aty dhe të plasohet para auditorit, por varet nga njeriu se sa është i prirë që ta nxjerrë atë nga labirinthi, ta argumentojë si të tillë, si dhe ta mbrojë atë. Edhe pse përmes këtij libri autori ka shpalosur të vërtetën, ndoshta mund të jetë zënë ngushtë ndonjëherë në kurthin e subjektivitetit. Por, siç do të thoshte Kanti i madh, njeriu nuk mund të ndryshohet, por vetëm të përmirësohet, andaj nuk besoj se mund të ndryshohet ai. Sugjestionet, kritikat pozitive janë çdoherë të mirëpritura, sepse rruga drejt shkencës është përplot peripeci dhe sfida. Ndërsa shpifjet dhe denigrimet si çdoherë janë të parëndësishme për çdo shkencëtarë dhe nuk duhet të merren parasysh. Autori shpalos gjëra të rëndësishme nga fusha të ndryshme edhe atë nga fusha e politikologjisë, sociologjisë, historisë, diplomacisë, kulturës, nga ajo shoqërore dhe sociale,etj. Ai nuk duhet të shqetësohet për zërat dhe shpirtrat e trazuar eventual, sepse duhet të ketë parasysh Molierin, shkrimtarin e madh francez, i cili thoshte që njeriu i mençur dhe i ditur nuk ulet nga të sharat e llafazanëve. Sepse nëse merresh me llafazanët, nuk mund ta

ndriçosh të nesërmen me të sotmen. E shkenca pa të nesërmen është e prirë të pushojë së qeni shkencë.

Në këtë libër autori ka paraqitur gjërat me shumë kujdes dhe elegancë, duke mos e lënë anësh asnjëherë ndërgjegjen e tij. Sepse shkenca pa ndërgjegje është shkatërrim i shpirtit. Ajo do saktësi, argumente, faktografi...

Krejt në fund mund të shtoj që libri "Shpalosja e labirinthit" mëton të argumentojë thënien e Norbert Vinerit, që shkenca dhe njohuritë kanë sjellë gjithmonë të mirën edhe të keqen. Andaj i takon arsyes njerëzore që ta bëjë gjykimin dhe zgjedhjen e drejtë.

Prandaj, lexues i dashur, pasi të lexosh mirë këto shkrime, gjyko dhe vlerëso si duhet duke përdorur arsyen e shëndoshë. Sepse zakonisht njeriu bindet më mirë atëherë kur arsyet i gjen vetë, se sa kur paraqiten nga ndokush tjetër.

Mr. Arsim Sinani, Gazetar dhe publicist

Pasqyra e lëndës

PARATHËNIE..... 4

Recension për librin "Shpalosja e labirinthit- Studime, Artikuj dhe Analiza", nga Mr. Ardian Ramadani..... 5

Recension për librin "Shpalosja e labirinthit- Studime, Artikuj dhe Analiza", nga Mr. Ardian Ramadani..... 8

Pjesa e parë

(STUDIME, ARTIKUJ DHE ANALIZA)
(MAQEDONI)
Maqedonia- Marrëdhëniet mes maqedonasve dhe shqiptarëve 1991-2009..... 8
(BALLKANI)
Dinamika e zhvillimeve politike në Ballkan..... 15
(FRANCË, BALLKAN, TURQI)
Politika e Francës ndaj Ballkanit dhe Turqisë si dhe kthesa e Sarkozit..... 20
(BALLKAN- EVROPË)
Edhe Ballkani duhet në UE, por..... 23
(DIPLOMACI DHE MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE)
Marrëdhëniet ndërkombëtare-Njohuri gjenerale..... 25
(KOSOVË, SHQIPËRI DHE MAQEDONI)
"Sërish vjen marsi!"..... 28
Pjesëmarrja e të rinjve në jetën politike..... 30
(MAQEDONI)
Maqedonia: femër e veshur deri në fyt, por me politikë aventuriere..... 34

Pjesa e dytë

(FRANCË)
Sistemi i Versajës..... 36
Franca: promotor i interesave të saja kombëtare dhe evropianizmit..... 38
Frankofonia dhe udhëtimi i saj nëpër kohë..... 40
(AREALI EVOLUTIV GJINOR)
Multikulturalizmi dhe të drejtat gjinore..... 42
(INSTITUCIONE NDËRKOMBËTARE)
OKB: Sfidat, rreziqet dhe kërcënimet e sigurisë..... 45

(GJUHËSI)
Pse duhet të promovohen dhe të mësohen gjuhët e huaja e posaçërisht gjuha frënge..... 50

(KAPITULL I VEÇANTË)

(ARSIMIM DHE SHKENCË)

Nevoja për ndryshimin e sistemit arsimor: domosdoshmëri apo dëshirë..... 53

(POLEMIKË DHE DEBAT)

Sikur... 55
Nacionalizmi shqiptar: a është rruga e vetme e realizimit të aspiratave shqiptare..... 57
O sa mirë që jam shqiptar, o hej.... 60
Festa e 28 Nëntorit mes hidhërimit dhe pikëllimit..... 62
Rreziku për identitet të ri kombëtar..... 64
Kombi shqiptar përballë sfidave të jashtme dhe të brendshme..... 66

(MESKAPITULL)

(MAQEDONI)

"Unë di që asgjë nuk di"..... 69
"Zgjedhjet pa zgjidhje"..... 71

Pjesa e tretë

(KOSOVË)

17 Shkurti – Realitet dhe gëzim i shkurtër..... 74

(MAQEDONI)

Qeverisja aktuale dhe ngecja e implementimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit..... 76
Edhe më tej ai është Invictus..... 79
21 vite të dhembshme pa birin më të dashur kumanovar..... 81
Blasfemitë e radhës..... 85

(POLEMIKË)

Ambiguitetet dhe dilemat e shpëtimtarit të një kombi të kontestuar..... 87
Mund të ndodhë edhe kjo..... 90

Pjesa e katërt

(KAPITULL I VEÇANT DHE EKSKLUZIV)

Enciklopedia e monstrumëve..... 114
Zgjidhja është aty, po ju "nuk e shihni" dot..... 116
Kumanova shqiptare në prag të Vitit të Ri 2010..... 118

Literatura..... 122
Lista e shkurtesave..... 128

Pjesa e parë

(STUDIME, ARTIKUJ DHE ANALIZA)

(M A Q E D O N I)

MARRËDHËNIET MES MAQEDONASVE DHE SHQIPTARËVE (1991-2009)

Republika e Maqedonisë, ish-Republikë në kuadër të ish- Federatës Jugosllave, arriti të shkëputej nga Federata Jugosllave në formën më të ***"lehtë"*** për dallim prej shteteve tjera. Edhe sot e kësaj dite mbetet enigmatike se si arriti të shkëputet ky shtet me dy milionë banorë, me 25 333 km katrorë[1], me një pozitë tejet të volitshme gjeografike, nga Jugosllavia e atëhershme e Millosheviçit, pa përjetuar tmerret dhe vështirësitë e soldateskës millosheviçiane, sikur që përjetuan ish-Republikat tjera si: Sllovenia, Kroacia, Bosnja e Hercegovina dhe Kosova. Kjo e fundit në atë kohë ishte krahinë autonome. Sipas disa analistëve Maqedonia u ***"la me qëllim"*** nga serbët, sepse sipas tyre, puna ishte e kryer. Ata pas përfundimit të misioneve të tyre të ***"suksesshme"*** në Republikat tjera dhe pas heqjes së autonomisë së Kosovës, do të ktheheshin shumë shpejt edhe në këtë shtet triumfalisht dhe do ta aneksonin apo pushtonin edhe këtë shtet, që sipas tyre do të ishte tejet e lehtë. Por gjërat ndryshuan. Pas takimit Gligorov-Millosheviç ky shtet u nda përfundimisht. U pavarësua, u mbajtën zgjedhjet e para të lira pluraliste, u aprovua dhe u miratua kushtetuta, por kjo kushtetutë do të ishte burimi i pashtershëm i problemeve, që do të shfaqte kriza mes dy komuniteteve me shumicë në këtë Republikë, mes komunitetit shqiptar dhe atij maqedonas. Komuniteti shqiptar nuk e pranoi kurrë këtë Kushtetutë e cila ua minonte atyre të drejtat legjitime të parapara edhe në Kushtetutën e vitit 1974. Tani të drejtat e tyre ishin minuar. ***"Nuk kishte"*** hapësirë për tjetër veprim, veçse për një sensibilizim të faktorit politik shqiptar, që në atë kohë këtë spektër politik të këtij komuniteti e përbënin vetëm dy parti: Partia për Prosperitet Demokratik dhe Partia Demokratikë Popullore, që të organizohej një referendum për shpallje të autonomisë territoriale në kuadër të Republikës së Maqedonisë. Por pushteti i atëhershëm maqedonas, i tërbuar me veprimet e shqiptarëve, u vërsul ndaj organizimit të tyre dhe arriti të eliminojë këtë veprimtari dhe aktivitet, me ç'rast do të pësonin edhe shumë qytetarë të pafajshëm shqiptarë. Kjo do të shtonte edhe më tepër mospajtueshmërinë dhe dallimet mes dy komuniteteve, si dhe do të shpinte në acarim të mëtutjeshëm të situatës mes këtyre dy komuniteteve, sepse komuniteti i cili pretendonte se ishte shumicë, respektivisht ai maqedonas i minonte të drejtat natyrore, apo njerëzore komunitetit, i cili pretendonte se ishte poashtu shumicë, por qëllimisht i diskriminuar dhe i emëruar në Kushtetutë si komuniteti pakicë. Në njëfarë mënyre shtetarët maqedonas promovonin ***"të drejtat e pakicave"*** të cilat nuk do të shërbenin në qetësimin e situatës, por përkundrazi. Ky ishte edhe deformimi apo gabimi i (pa)qëllimshëm i qeveritarëve maqedonas, sepse ata ***"nuk e dinin"*** se në fakt nuk ekzistojnë lloje tjera të të drejtave, përpos të drejtave njerëzore apo natyrore, siç citon edhe filozofi, shkrimtari dhe mendimtari i madh francez, Rene Descartes, ***"Je pense, donc je suis" (Mendoj, pra jam).*** [2]

---

[1] http://en.wikipedia.org/wiki/Republic_of_Macedonia

[2] http://anty83.blogspot.com/2006/02/je-pense-donc-je-suis.html

Në fakt shtetarët maqedonas të atëhershëm, të frymëzuar nga shkolla e Kumrovecit, shkolla e cila promovonte doktrinën e njëjtë me atë të Rajhut të tretë për çifutët dhe me parime të njëjta të bazuara tek idetë e Naçartanjës së Ilija Grashaninit, Vaso Çubrilloviqit, plan ky që synonte shfarosjen e shqiptarëve, pra vazhdonin që të mohonin të drejtat natyrore të shqiptarëve dhe promovonin se në Maqedoni ***"Sozhitelstvoto e primer za drugite" (Bashkëjetesa është shembull për të tjerët),*** gjë e cila nuk kishte të bënte fare me realitetin, sepse shqiptarët nuk kishin as institucionet e tyre, as shkollat apo Universitetet e tyre, as flamurin e tyre. Po në fakt për çfarë të drejtash flisnin shtetarët maqedonas, të cilët nën ombrellën e tyre kishin disa shqiptarë shqipfolës, pjesëmarrës kukulla apo marioneta në qeverinë e atëhershme maqedonase, pa vizione për kombin e tyre dhe pa platformë për avancimin e të drejtave të tyre. Qeveritarët maqedonas, struktura të ish sigurimit shtetëror, pasues të rrymës komuniste, por të konvertuar në social demokratë, inskenonin vazhdimisht gjëra të cilët pasqyronin shqiptarët si prishës të ekuilibrave të paqes dhe ko-ekzistencës. Si shembull konkret kemi Ladorishtën, ku vriten disa shqiptarë me arsyen se organizonin puç kundër shtetit dhe rrezikonin integritetin territorial të shtetit të brishtë. Ngjarjet vijonin më tej ku do të inskenohej Bit Pazari, afera e armëve, Reçica e Vogël, mbyllja e udhëheqësve që synonin hapjen e Universitetit të Tetovës, gjakosja e protestuesve, të cilët kërkonin të drejtën e tyre legjitime natyrore për shkollim në gjuhën amtare, si dhe vrasja e Abdulselam Eminit. Ishte kjo një shembull i mirë që promovonte synimet shfarosëse të pushtetarëve maqedonas ndaj krijesës shqiptare, si dhe një falënderim ndaj shtetit të tyre amë të quajtur Shqipëri, shtet ky i cili i pari pranoi Maqedoninë me emrin kushtetues, pa synime afeksioni apo pretendime të përcjella me maqedonofobi, përderisa shtetet tjera kontestonin dhe vazhdojnë edhe sot e kësaj dite të kontestojnë njëri kombin maqedonas, si për shembull bullgarët, tjetri emrin kushtetues dhe simbolet shtetërore, pra grekët, e tjetri Autoqefalinë e Kishës Ortodokse, është fjala për serbët. Shqipëria dhe Kosova ishin të vetmet që pranuan apo nxituan të pranonin Maqedoninë si shtet pa shfaqur pretendime territoriale apo shoviniste. Shtetarët maqedonas iu ***"falënderuan"*** me burgosje, rrahje dhe maltretime krijesës shqiptare në Maqedoni, për këtë gjest të Shqipërisë dhe Kosovës. Ngjarjet do të pasonin më tej ku me vendim të Gjykatës Kushtetuese sjellët vendimi për mosvalëvitjen e flamurit shqiptar në komunën e Tetovës dhe të Gostivarit, me ç'rast gjakoset Gostivari, dënohen dhe mbyllen në burg udhëheqësit e komunës së Tetovës dhe Gostivarit. Kjo ngjarje edhe sot e kësaj dite është e pazbuluar deri në fund dhe e pasqaruar mirë, sepse u vranë disa shqiptarë vetëm për dëshirën e Tomisllav Çokreskit, ish ministër i brendshëm. Dilema tjetër është se pse nuk u informua partia shqiptare në pushtet, PPD-ja për aksionin policor. Kjo arsyeton faktin se ajo ishte partia kukull alem e karshi faktorit ndërkombëtar se shqiptarët e Maqedonisë, kinse bashkëjetonin mirë dhe se Maqedonia ishte "Oazë e paqes" si dhe pasqyronte lëçitjen e shqiptarëve prej maqedonasve. Përçarjet mes faktorit politik shqiptar, atij qeveritar PPD-së dhe atij opozitar me synime radikale PDSH-së, patën si impakt vazhdimin e dhunës shtetërore ndaj shqiptarëve si dhe hutimin e komunitetit shqiptar, e pse mos ta them edhe përçarjen apo thellimin e ndasive në mesin e këtij komuniteti edhe më tej. Më 1998 në zgjedhjet parlamentare, pas 8 viteve pushtet, do të vinin forcat djathtiste të udhëhequra nga VMRO-DPMNE e Lubço Georgievskit, Alternativa Demokratike e Vasil Tupurkovskit, ish- udhëheqës dhe politikan komunist dhe PDSH-ja e Arbën Xhaferit, me orientime djathtiste. Për herë të parë do të dukej se gjithçka shkonte mirë, pas lirimit apo faljes së të

burgosurve shqiptarë nga burgjet maqedonase të dënuar politikisht nga Qeveria paraprake, si dhe hapjes së UEJL-së, qendrës studimore e përkrahur nga amerikanët dhe evropianët për studime të studentëve të komunitetit shqiptar dhe komuniteteve tjera jo shumicë. Këtu poashtu bënte pjesë edhe lirimi i ish- udhëheqësve të komunave shqiptare të Tetovës dhe Gostivarit. Në atë kohë kemi sfidën e refugjatëve kosovarë, e cila do sfidonte qeveritarët maqedonas të cilët me ndihmën e faktorit ndërkombëtar dhe shqiptarëve të Maqedonisë do të menaxhonin këtë krizë. Por, kjo krizë është e njohur edhe për ekspozimin apo shfaqjen e synimeve shoviniste të pjesëtarëve dhe qarqeve të caktuara të komunitetit maqedonas, të cilët do të demonstronin me forcë kundër Ambasadës Amerikane, në përkrahje të politikës së etnocidit dhe gjenocidit të kryer nga krimineli Millosheviç në Kosovë si dhe viçave të tjerë. Këta demonstrues, të përkrahur direkt nga strukturat opozitare socialdemokrate dhe qarqe të caktuara proserbe, me ambicie të sëmura shoviniste do të kundërshtonin me ngulm sulmet e NATO-s ndaj Jugosllavisë, saqë do të shkonin aq larg dhe do të djegin edhe vetura të Ambasadës amerikane në Shkup, si dhe do të thirrin në përkrahje të Serbisë dhe politikës së saj antiperëndimore. Për fat të mirë gjithçka mbaroi mirë në favor të drejtësisë për kosovarët, megjithë ambiciet e sëmura maqedonase me orientime proserbe për minim të paqes dhe destabilizim të vendit, kinse me gjetjen e armëve dhe sasive të municionit në fshatin Llojan të Kumanovës dhe me ekspozimin e shqiptarëve si element destabilizues. Këto përpjekje nuk do të ndalonin. Në momentin kur gjithçka dukej se shkonte mirë, ndodhi vrasja e tre policëve maqedonas në kontroll rutine në hyrje të fshatit të banuar kryesisht me shqiptarë, Haraçinë të Shkupit, ku me shpejtësi të menjëhershme, pa argumente, do të fajësoheshin strukturat radikale shqiptare të përkrahura kinse nga Kosova. Qeveria Georgievski u bë e shurdhër ndaj revindikacioneve dhe kërkesave për ndryshim të kushtetutës, gjeneratorit të problemeve. Ajo shkoi aq larg, sa në aksionin policor në Haraçinë do të vriste një shqiptar dhe do të burgoste disa të tjerë, ndërsa do të akuzonte kosovarët për synime dhe pretendime territoriale ndaj Maqedonisë, e në fakt nuk ishte ashtu. Kjo fliste se bashkëjetesa ishte e vënë në pikëpyetje dhe nuk dëshirohej. Në momentin më kritik kemi paraqitjen e formacioneve paraushtarake me emrin Ushtria Çlirimtare Kombëtare, në fshatin Tanushë dhe kërkesat për ndryshim të Kushtetutës me alternativën se do të kishte destabilizim të situatës nëse nuk ndryshohej ajo. Ngjarja do të kulmonte më tej me deklaratën e Stojan Andovit për mosndryshim të Kushtetutës asnjëherë ***"po sekoja cena" (me çdo çmim).*** Udhëheqësit e UÇK-së do të kërkonin edhe më tej më shumë të drejta, por kjo do të haste në vesh të shurdhër te qeveritarët. Në momente të caktuara, nga disa krerë të UÇK-së do të kërkohej edhe luftë për shkëputje të shqiptarëve, respektivisht për ndarje, apo për territore. Kësaj kërkese do t`i ndihmonte edhe deklarata e Akademikëve të Maqedonisë se janë gati të bëjnë koncesione në ***"dobi"*** të shqiptarëve për lëshime territoriale në Maqedoninë Perëndimore, gjë e cila nuk dëshirohej nga shqiptarët, sepse linte jashtë shqiptarët e Kumanovës dhe Shkupit.

Në momentet kur disa asociacione apolitike dhe udhëheqës të Universitetit të Tetovës do të protestonin në qendër të Tetovës kundër dhunës shtetërore, do të dëgjoheshin krismat e pushkave të luftëtarëve shqiptarë në Kalanë e Tetovës. Gjithçka do të ishte e qartë. Maqedonia do të hynte në altarin e quajtur ***luftë.*** Pas aksioneve të forcave policore të përcjella me dhunë ndaj civilëve dhe djegie të pronave të shqiptarëve, do të ***"dorëzohej Kalaja nga luftëtarët shqiptarë"*** që edhe sot e kësaj dite mbeti enigmatike. Menjëherë formacionet, tanimë legale të UÇK-së, do të robëronin e më pas të

lironin konvojin e forcave policore të udhëhequra nga ish- ministri Lube Boshkovski dhe zëvendësi i tij, Refet Elmazi, në Brezë, me ç'rast do të pasonte ngjarja me shfaqjen e luftëtarëve shqiptarë edhe në zonën e komunës së Likovës, konkretisht në Sllupçan dhe Vaksincë, ku do të vriteshin disa policë maqedonas si dhe me shpalljen e zonës së lirë në këtë komunë. Lufta të cilën disa e quajnë edhe si konflikt, tanimë veçse kishte filluar. Ajo u pasua me vrasje nga të dyja palët, si dhe vrasje të civilëve shqiptarë nga ana e policisë së një shteti që pretendonte se ishte demokratik, ndërkaq vriste qytetarët e vet të pafajshëm. Me ndërmjetësimin e faktorit ndërkombëtar ngjarja do të ndryshojë në të mirë të paqes, por jo gjithçka shkonte mirë. Pas përpjekjeve të politikanëve maqedonas për minimin e Marrëveshjes së Ohrit, të nënshkruar në Ohër më 13 gusht 2001 nga të dyja palët në prezencë të faktorit ndërkombëtar, ku ndalej konflikti apo lufta sido që ta quajmë, me ndryshimin e preambulës u pa se nuk ishte ndryshuar koncepti i vjetër dhe nuk ishte stopuar trendi i vuajtjes së komunitetit shqiptar nga komuniteti që pretendonte se ishte shumicë. Ngjarja do të kulmonte me provokimin e paqes dhe me vrasjen e civilëve shqiptarë në Luboten nga forcat policore të udhëhequra direkt nga Lube Boshkoski, cili pas lirimit nga Tribunali i Hagës, sot synon të bëhet kryetar i Maqedonisë, pra edhe i shqiptarëve. Më 2002 pas zgjedhjeve parlamentare në qeveri do të pasonte ndryshimi ku prapë do të kthehesin forcat majtiste në krye me LSDM-në dhe partinë shqiptare, BDI, pretenduese e vijimit të politikës së ish-UÇK-së, por në vijimin e vijës politike institucionale tanimë, sepse ky formacion paraushtarak ishte demobilizuar nga misioni ndërkombëtar ***"Korrja e domosdoshme".*** Lideri i kësaj partie, Ali Ahmeti, rigrupoi afër vetes ish- strukturat e mëparshme qeveritare të PPD-së, të cilët nuk kishin qenë kurrë në vijën e tij apo kauzën e tij. Arsyeja ngelet edhe më enigmatike, por edhe më interesante, sepse në Kosovë nuk fituan strukturat vijuese të ish- UÇK-së, por ato më liberale të udhëheqësit të moderuar, Ibrahim Rugova, përderisa në Maqedoni kishim një situatë krejtësisht tjetër, fitoi partia shqiptare ***"vijuese" e ish –UÇK-së".*** Koalicioni do të vazhdonte ku aktori Branko Cërvenkovski, do të ***"pendohej"*** për aktin e turpshëm në Gostivar dhe Tetovë më 1997, dhe do të "lante" borxhin ndaj shqiptarëve. BDI do të promovonte idenë e funksionalitetit të shteteve multikulturore, ndërsa PDSH dhe lideri i saj, Arben Xhaferi, do të dilnin në moratorium, me arsyetimin se shteti multikulturor ishte jofunksional dhe se ishte minuar Marrëveshja e Ohrit. Aksionet policore nuk do të ndaleshin. Ato do të vijonin edhe më tej në Rakovec dhe Brezë, ku prapë do të vriteshin shqiptarë civilë dhe do të burgoseshin ca të tjerë. Ndërkaq, formacioni i quajtur AKSH do të kërcënohej prapë me luftë, por përmes komunikatave në internet. Në ndërkohë pretendohej se ishin arritur të drejtat e avancuara të shqiptarëve, u legalizua apo u bë legalizimi gjysmak i UT-së, respektivisht u themelua USHT-ja, por problemet nuk u zgjidhën AD-HOC. Ngjarjet do të vazhdonin me votimin e Ligjit për përdorimin e flamurit në pjesët ku shqiptarët janë shumicë, respektivisht më tepër se 27 %, dhe me sjelljen e Ligjit për ndarje territoriale, ku do të haste ky ligj në fortifikatë nga ana e partisë opozitare, VMRO-DPMNE, e cila sapo kishte dalë nga rifreskimi i radhëve të saja me ndryshimet rrënjësore me kuadro të reja të udhëhequra nga Nikolla Gruevski. Partia shqiptare në pozitë do të përjetonte fiaskon me ndarje në disa degë për shkak të mospajtimeve mes dy taborëve atyre radikale dhe liberale. Në mënyrë suksesive ngjarjet do të pasojnë me pranimin e Maqedonisë si anëtare kandidate e UE-së. Edhe pse u përcoll me eufori nga pushtetarët, kjo ishte më tepër si stimul i UE-së në avancim të çështjeve të tjera të cilët kishin ngecur. Por, korrupsioni nuk kishte të ndalur. Përderisa mjetet

keqpërdoreshin në njërën anë, në tjetrën anë nuk u bë risocializimi i ish luftëtarëve të UCK-së dhe vazhdohej me politikën denigruese regresive ndaj tyre. Bile për pak sa nuk filloi një krizë tjetër në fshatin Vaksincë, e cila fatmirësisht u qetësua për shkak të ndërhyrjes së deputetit të asaj ane, Hysni Shaqirit. Siç thamë edhe më lart u formuan disa parti politike të reja shqiptare, që synonin avansim të mëtutjeshëm të statusit shqiptar. Ngjarja do të vazhdonte me kontinuitet ku do të mbaheshin zgjedhjet parlamentare 2006 të përcjella nga një eufori dhe luftë e madhe për pushtet. Ngadhënjimtarë do të dilnin VMRO-DPMNE nga spektri politik maqedonas dhe BDI me shumicë të votave nga spektri politik shqiptar. Por, mandatari për formimin e Qeverisë do të merrte në Qeveri partinë, e cila realisht mori më pak vota nga komuniteti shqiptar, PDSH-në aleatin e mëparshëm dhe ish-participientin qeveritar. Aty do të fillonte të shfaqej kriza. BDI pretendonte se ajo duhet të ishte në pushtet, përderisa PDSH ritheksonte se BDI nuk ishte parti nacionale, por parti qytetare, me anëtarësi edhe të komuniteteve tjera joshqiptare, si dhe me anëtarësi edhe në Maqedoninë Lindore, dhe se kishte fituar votat në koalicion me PPD-në. Sidoqoftë, PDSH u bë pjesë e garniturës shqiptare. Por, këtu filloi edhe tatëpjeta e shumë çështjeve tjera me interes shtetëror dhe kolektiv. U stopua dialogu mes qeveritarëve dhe opozitarëve. Shpresa e qytetarëve për anëtarësim të shpejtë në UE filloi të valëvitej si ania TITANIK. Përpjekjet titanike të VMRO-DPMNE- së të fshehin se kinse nuk kishin firmosur marrëveshje me BDI- në për çështjet që kishin të bënin me ç`bllokimin e shumë gjërave që kishin të bënin me shqiptarët, acaroi marrëdhëniet me partnerët qeveritarë që të rishqyrtonin pjesëmarrjen në Qeveri. Por pas disa takimeve u qetësua gjendja dhe situata mes tyre ku u zgjodh alternativa e përfshirjes së PPD së në qeveri me qëllim të sigurimit të Badenterit. Por nuk përfundoi gjithçka mirë. Pas ndryshimit të kodit zgjedhor nga qeveritarët dhe mohimit të marrëveshjes së nënshkruar ***"gojore"*** nga VMRO-DPMNE dhe BDI, në prani të faktorëve të jashtëm, nga ana e kryeqeveritarit Gruevski, ngjarja u acarua edhe më shumë me ç'rast ndodhi edhe zënka mes deputetëve shqiptarë të pozitës dhe opozitës. Deri në ato momente marrëdhëniet ishin më shumë të acaruara në këndin pozitë–opozitë, sesa në mes të dy komuniteteve, atij shqiptar dhe maqedonas. Situata mandej ndryshoi kur u hasën përplasjet e para mes kryetarit të zgjedhur të ri të PDSH-së, Menduh Thaçit, dhe kryetarit të Komisionit për hetimin e ngjarjeve të shtatorit në Parlament, Stojan Andov, ku u cenuan të drejtat e gazetarëve me rrahjen e disave prej tyre dhe me rrahjen mes deputetëve. Aty ishte vërtetuar edhe njëherë se kjo ***"Oazë e paqes"*** ishte në fakt oazë e konfuzioneve dhe regresit. Por, fill pas vdekjes së yllit të muzikës maqedonase, Toshe Proevskit, partitë shqiptare dhe organizatat e tjera apolitike dhe politike dërguan telegrame ngushëlluese familjes së Toshes, ku dëshmuan edhe njëherë se janë tolerantë, altruistë dhe respektojnë alterizmin. Përderisa, një gjë e tillë nuk është hasur ndonjëherë nga ndonjë parti maqedonase, qoftë në pozitë apo opozitë, me rastin e vdekjes së ndonjërit prej këngëtarëve shqiptarë. Vlen të përmendet rasti i këngëtarit shqiptar, Burhan Halili, i cili njësoj vdiq disa vite më herët, në aksident automobilistik dhe nuk u dërgua asnjë telegram ngushëllimi. Por, sidoqoftë, ajo që do të sfidojë ndoshta më shumë marrëdhëniet ndëretnike ishte akti i sjelljes së Ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese, apo heqja e disa neneve tek Ligji i përdorimit të flamurit kombëtar shqiptar i cili do të ketë impakt në marrëdhëniet ndëretnike shqiptaro-maqedonase edhe më tej nëse nuk rishikohet apo abrogohet. Ndaj aktit të sjelljes së këtij vendimi reaguan si partitë shqiptare në pozitë, ashtu edhe ato në opozitë. BDI u kërcënua se nuk do e përfillin këtë vendim të Gjykatës

Kushtetuese. Poashtu edhe kryetarët e komunave nga radhët e saja u kërcënuan se do të ripërsëritet 2001-shi nëse nuk abrogohet ky ligj, përderisa PDSH e cila akuzoi për këtë vendim strukturat opozitare të LSDM-së dhe BDI-së, se tentojnë të destabilizojnë shtetin apo situatën edhe ashtu të brishtë në këtë shtet, i cili aktualisht në lidhje me emrin, ka probleme me shtetin fqinj, me Greqinë. Kjo akuzë ka të ngjarë të ketë diçka të vërtetë se njëkohësisht kishte përpjekje nga ana e strukturave radikale prosllave të përkeqësohet situata dhe të përshkallëzohet dhuna. Fakt më i qartë ishte paraqitja e Gardës së Car Llazarit edhe në Maqedoni si dhe kërcënimet e hapura të tyre se kanë struktura edhe në Maqedoni, përpos në Kosovë dhe Luginën e Preshevës, vrasja e komandantit të policisë në Vaksincë, ***Fatmir Halilit,*** si dhe vrasja e ***Skender Halilit*** në rrethana misterioze, vrasja e policit maqedonas në Tanushë dhe plagosja e dy të tjerëve, përshpejtimi i ndërtimit të bazës më të madhe ushtarake 20 km larg kufirit me Kosovën nga ana e ushtrisë serbe, konkretisht në largësi 2 km nga Bujanoci, në mënyrë që të nxisë elementet radikale dhe të pakënaqura shqiptare që të reagojnë. Ky akt ishte i përcjellë edhe me thirrjen e politikanëve dhe shtetarëve serb për bojkotim të zgjedhjeve në Kosovë dhe me kërcënimet për destabilizim të situatës në rajon. Andaj është hipotetike që të mos them e sigurtë, të mendohet se kishte diçka të vërtetë në këtë, se një gjë e tillë gatuhej apo tentohej të gatuhej edhe në Maqedoni me ligjin e sjellë nga Gjykata Kushtetuese e cila provokonte haptas marrëdhëniet (jo) të mira ndëretnike.Kësaj të fundit ia shtojmë edhe aksionin policor në Brodec të Tetovës, e cila dëmtoi rëndë imazhin e këtij shteti edhe ashtu të brishtë, sepse nuk mund të pretendohet për marrëdhënie të mira ndëretnike kur sulmohet xhamia e me këtë cenohet toleranca ndërfetare, kur burgosen njerëz të pafajshëm, kur vriten njerëz të pafajshëm dhe civil, kur simulohen aksione kinse për shpërndarjen e grupeve ***"kriminale"*** e me këtë aludohet vetëm tek grupet shqiptare, përderisa Garda e Car Llazarit mobilizonte pjesëtarët e vet në mënyrë publike, ndërsa shteti rrinte duarkryq dhe nuk ndërmerrte asgjë. Pas disa muajsh kemi edhe shpalljen e pavarësisë së Kosovës, akt ky i pritur me padurim dhe pas shume vitesh nga shqiptarët. Më në fund ëndërra shqiptare u realizua. U shpall Kosova shtet i pavarur, u krijuan institucionet kosovare, flamuri, himni kosovar etj. Por Maqedonia vonoi deri në pafundësi pranimin e shtetësisë së Kosovës. Pas disa muajsh në këtë shtet do të shpalleshin zgjedhje të parakohshme për shkak të mosfunksionimit të Parlamentit dhe bllokimit të saj nga opozita. Zgjedhjet e përcjella me dhunë në taborin politik shqiptar, të përcjella me vrasje të një shqiptari, plagosje të shumë shqiptarëve tjerë, do të tregonte se shqiptarët ishin ende të etshëm vetëm për pushtet fiktiv e jo për shtet të tyre. Ata dëshmuan se nuk kishin pjekuri politike, me ç`rast nuk do të mungonin kritikat e udhëheqësve kosovarë dhe shqiptarë, si dhe ndërkombëtarëve për dhunën gjatë zgjedhjeve. Pas shumë episodeve tmerruese dhe titanike do të fitonin zgjedhjet partitë nacionaliste VMRO-DPMNE dhe BDI, me ç`rast kemi koalicionin e parë mes dy partive, të cilët ishin "armiq" për vdekje ndaj njëra-tjetrës. Por u dëshmua e kundërta. Gruevski i qetësoi dhe i servilizoi shqiptarët e BDI-së, të cilët u ngutën pas pushtetit dhe harruan kërkesat shqiptare. Ata u bënë pjesë e Qeverisë Gruevski pa kurrfarë platforme duk e e përkrahur ***"PRERODBËN "*** e Gruevskit.[3] Por, duk e e harruar rregullimin e statusit të luftëtarëve shqiptarë, duke harruar lirimin e të burgosurve të Brodecit për të cilët çirreshin kur ishin në opozitë, sollën Ligjin diskriminues për përdorimin e gjuhës shqipe për shumë pak minuta duke e nënçmuar shqipen, rrënuan Institutin e Trashëgimisë

[3] http://forums.vmacedonia.com/f11/padni-stani-prerodba-na-nikola-gruevski-22869/

Shqiptare, i cili u krijua me mund gjatë qeverisjes së PDSH-së, hapën dosjet e Hagës, apo pranuan hapjen e dosjeve të Hagës, hapën procedurë gjyqësore ndaj deputetëve të saj, prej të cilëve njëri dënohet me burgim. Pra, shtrohet pyetja se kur Ali Ahmeti nuk mbrojti deputetët e vet, si mund të mbroj nga ndjekja dhe gjykimi një ushtarë të thjeshtë apo një shqiptar. Kjo flet për shndërrimin e BDI-së në parti kukull në Qeveri. Dhe vërteton se edhe pse fitoi shumicën e votave shqiptare, ajo nuk është e denjë të mbrojë shqiptarët nga trajtimi nënçmues i maqedonasve dhe i nacionalistëve të VMRO-së. Më pas kemi edhe zvarritjen e njohjes së Kosovës. Njohja e saj do të bëhej e mundur vetëm pas shumë përpjekjeve diplomatike dhe presioneve ndërkombëtare ndaj kryeministrit kryeneç, Nikolla Gruevskit. Ishin konkretisht këto presione të amerikanëve dhe evropianëve, ndërsa presionet e partive politike shqiptare as nuk i lëkundnin syrin Gruevskit. Në anën tjetër ngjarjet do të pasonin me mospranimin e Maqedonisë në NATO, pas vetos greke për shkak te kontestit me emrin. Ishte dhe është edhe sot e kësaj dite befasues fakti se pse nuk u përfshinë në debatin për emrin edhe shqiptarët, apo pse u anashkaluan kur dihet se ky komunitet përbën 30 % në Maqedoni. Qëndrimi kokëfortë i shtetarëve maqedonas për mosndryshim të emrit do të vononte Maqedoninë krahas Shqipërisë dhe Kroacisë, për aderim në NATO dhe UE. Ndërsa politikanët maqedonas do të vazhdonin me të njëjtin qëndrim, e ndërsa aktualisht vazhdojnë edhe sot duke e injoruar vokacionin shqiptar për inkuadrim sa më të shpejtë në UE dhe NATO. Aktualisht kemi problemin ende të emrit të këtij shteti, i cili mbahet peng, moszgjidhjen ende të statusit të ish- luftëtarëve shqiptarë, cungimin e gjuhës shqipe, prolongimin e bashkimit të komunës së Kërçovës, problemet me arsimin e mesëm ku për një nxënës në territoret maqedonase hapen shkolla dhe punësohen arsimtarë, ndërsa në territoret shqiptare pothuajse në secilin qytet kemi probleme me shkollat e mesme. Kësaj ia shtojmë edhe ligjin diskriminues për stimulimin e lindjeve vetëm në qytetet maqedonase e jo në ato shqiptare. Ndërsa faktori politik shqiptar në qeveri bën sehir dhe bën konferenca për shtyp, ku ministrat shqiptarë anashkalohen nga zëdhënëset dhe prapë trumbetohet se gjithçka është në rregull. Poashtu ministrat shqiptarë anashkalohen edhe nga kryeministri, kemi rastin konkret të anashkalimit të ministrit shqiptar, z. Musa Xhaferi. Ndërsa prapë BDI është në qeveri dhe çapitet të deklarojë se ka realizuar 95 % të Marrëveshjes së Ohrit. Kjo e vërteton edhe njëherë thënien: ***"Jepuni gjithçka shqiptarëve si individ, mos u jepni asgjë shqiptarëve si komb".*** Andaj gjërat e lartpërmendura dhe një mori faktesh tjera e vënë në pikëpyetje të madhe ardhmërinë e këtij shteti, raportet ndëretnike edhe ashtu të brishta si dhe ***"oazën e paqes dhe sozhitelstvon (bashkëjetesën)"*** e shtetarëve maqedonas. Por, ***"Tempus omnia revelevat" (Koha i zbulon të gjitha)***. Si dhe një porosi tjetër për qeveritarët aktual ***"E ardhmja mbetet e hapur".***

Kumanovë, 12 qershor 2009

(BALLKANI)

DINAMIKA E ZHVILLIMEVE POLITIKE NË BALLKAN

Ballkani, ky rajon, i cili në vete ngërthen jo vetëm konceptin gjeografik me një pozitë të volitshme gjeografike, me pozitën e tij të përshtatshme në paralelen e 40, me 270 ditë me diell, gadishull me ujë, me klimë alpine-kontinentale dhe mesdhetare, por edhe konceptin tjetër, atë të miteve, legjendave, idoleve, autoktonisë dhe origjinalitetit, burimores, historisë, traditës, virtyteve, vlerave, filozofive të ndryshme, bastion i mburrjeve dhe i krenarive të tepruara.[4] Mburrjet dhe krenaritë e tepruara ballkanike përpos që kanë zënë një vend të rëndësishëm në analet botërore, kanë sensibilizuar udhëheqës të mëdhenj, perandorë, mbretër, gjeneralë……., që të ndërmarrin hapa të nevojshëm dhe të domosdoshëm për të ndaluar impaktet e kësaj mburrjeje të tepruar dhe krenarie të ekzagjeruar edhe në pjesë të ndryshme të globit. Kjo pjesë e globit e përbërë nga një territor jo edhe i vogël, i populluar me një popullsi heterogjene, me vlera të ndryshme, me zakone të ndryshme, etni të ndryshme dhe heterogjene, gjatë periudhave të ndryshme epokale ka gjeneruar dhe reflektuar më shumë luftë se sa paqe, më shumë kontradikta se sa unitet, më shumë vuajtje se sa lumturi, më shumë procese reterograde se sa progresive, më shumë regres se zhvillim dhe progres, më shumë izolim dhe vetizolim se sa integrim. Rajon i populluar me popullsi autoktone dhe ardhacakë i vënë përballë sfidave të ndryshme kohore, ky rajon do të ishte fillimisht një rajon i populluar me popullsi autoktone helene, ilire, romake. Por gjithçka do të ndryshojë, fill pas dyndjes dhe ardhjes së fiseve të ndryshme sllave, të cilët do të ndryshonin konfiguracionin e kësaj pjese të globit. Në këtë rajon përpos sllavëve, si ardhacakë konsiderohen edhe rumunët, hungarezët, romët. Problemet dhe luftërat do të fillonin saora, sepse ky rajon nuk do të mund të "duronte" aq etni të ndryshme dhe të dendur në territorin e vet, aq shumë kultura, vlera e antivlera, antagonizma dhe kontradikta. Ngjarjet në këtë rajon do të zhvilloheshim me shumë luftëra, me shumë kryengritje, kriza komplekse, me shumë batica dhe zbatica, të cilët nëpër periudha të ndryshme historike do të kishin impakte të ndryshme si rajonale ashtu edhe botërore. Ky rajon problematik do të sillte 3 luftëra ballkanike si dhe do të ishte tejet aktiv në dy Luftërat Botërore duke qenë njëkohësisht edhe arenë e përplasjes së interesave të Fuqive të Mëdha. Meqenëse popujt e Ballkanit ishin direkt të përfshirë në sferat e ndryshme të interesit të Fuqive të Mëdha, ato njëkohësisht edhe u përplasën njëri me tjetrin, secili duke pretenduar të gllabërojë diçka nga territori i shtetit fqinj, herë pas here edhe duke formuar aleanca dhe blloqe me synime aneksimi territoresh. Fill pas lëvizjeve të shumta për pavarësi dhe luftërave të ndryshme për çlirim nga sundimi pesë shekullor osman, popujt ballkanik filluan pas pavarësimit të tyre jo të zhvillohen ekonomikisht, politikisht dhe të zhvillonin frymën e solidaritetit, por frymën garuese në aspekt negativ ato filluan që ta derdhin ndaj popujve që ishin më të pafuqishëm dhe më të pambrojtur. Ai që pësoi më shumë nga këto oscilacione dhe vibracione ishte populli shqiptar, popull vijues i ilirëve, i pranuar ndërkombëtarisht edhe nga studiues të ndryshëm të antikitetit si ***Eduard Hosh, Antonina Zheljaskova, Artur Vajgëll*** etj. si popull autokton dhe pasues i ilirëve.[5] Ky popull i cili kishte reflektuar me vite vlera të mëdha, kishte nxjerrë në dritë ***Papa Klementin XI,*** perandorë, shkrimtarë,

[4] http://fr.wikipedia.org/wiki/Balkans

[5] Bashkurti, Lisen, Diplomacia shqiptare, Vëllimi 1, Geer, Tiranë 2005, fq. 19

shtetarë të mëdhenj dhe princër si ***Gjergj Kastrioti-Skënderbeu*** që iu kishin kundërvënë edhe perandorive më të mëdha të botës dhe globit, do të bëhej pre e interesave të ndryshme greke dhe sllave, edhe pse këta të fundit, pra sllavët ishin ardhacak dhe ishin të "civilizuar" nga ana e shqiptarëve në kishat e atëhershme të asaj kohe. Populli shqiptar edhe pse ishte islamizuar gjatë sundimit turk, nuk kishte humbur aspak identitetin e tij, përkundrazi ai ishte ende stoik. Populli shqiptar edhe pse me vonesë u pavarësua dhe u njoh ndërkombëtarisht, prapë se prapë qëndroi kryelartë dhe dinjitoz. I ndarë në shumë shtete, ky popull nuk do të ndërpriste luftërat për pavarësi dhe bashkim. Gjatë dy luftërave botërore ky popull do të merrte pjesë aktivisht duke kërkuar në vazhdimësi dhe në mënyrë permanente hisen e vet, që e kishte humbur nga lëçitja e Fuqive të Mëdha, apo siç shprehet shkrimtari i njohur francez, Serge Metais, nga zgjimi i vonshëm i vetëdijes kombëtare dhe unifikimi i vonshëm i faktorëve relevant shqiptarë. I përcaktuar fuqishëm në identitetin e tij evropian ashtu siç thekson edhe Ismail Kadare, shkrimtar shqiptar i njohur ndërkombëtarisht, ky popull do të përjetonte fiaskon pas LDB-së, sepse në njërën anë do të izolohej dhe vetizolohej tmerrësisht nga regjimi komunist në Shqipëri, e në tjetrën anë ende do të fragmentarizohej në më shumë shtete fqinje, dhe atë që nuk mundi ta arrijë në Berlin, Londër, Versajë, Jaltë, Postdam, nuk do ta arrinte dot edhe pas rënies së bllokut sovjetik dhe shpërbërjes së Jugosllavisë. Bile do të shkonte edhe më keq. Shqiptarët e Kosovës do t`u hiqeshin edhe ato pak të drejta që i kishin. Ndërsa popujt tjerë, si ai slloven, siç thekson edhe ***Jasha Zllobec,*** studiues dhe shkrimtar slloven, do të pavarësohej shpejt, do të njihej ndërkombëtarisht dhe për disa vite do të bëhet pjesë e Unionit Evropian. Ndërsa shtetet tjera, edhe pse fituan pavarësinë, ende nuk janë edhe sot e kësaj dite pjesë e UE-së, në përjashtim të Greqisë, e cila ishte e pranuar shumë vite më herët më 1981, si dhe të Bullgarisë, e cila u pranua këto vitet e fundit, sipas disa supozimeve për shkaqe politike dhe gjeostrategjike më shumë, e jo për shkak të plotësimit komplet të kushteve dhe kritereve të domosdoshme për anëtarësim në strukturat e UE-së. Ndërsa populli shqiptar në Shqipëri leje që nuk ishte pjesë e integrimeve evropiane, por ishte edhe disa hapa shumë larg. Ishte larg një stabiliteti të qëndrueshëm. Shqipëria për 50 vite u largua nga demokracia perëndimore. Poashtu ajo shkoi edhe buzë katastrofës, rrezikoi për të qenë si shtet gjatë krizës piramidale dhe luftës qytetare të 1997-ës. Ndërsa në Kosovë, populli shqiptar ishte i eksponuar përballë politikës së etnocidit dhe gjenocidit serb të udhëhequr nga kryekrimineli Millosheviç dhe doktrinarët tjerë serb të veshur me petkun e nacionalizmit dhe ksenofobisë ndaj shqiptarëve. Ajo që është edhe më tragjike, është ajo se populli serb në vend që të dënojë politikën e shtetarëve të saj me përmbajtje raciste dhe shfarosëse e provuar pak në Slloveni, e më shumë në Kroaci, në Bosnjë e Hercegovinë dhe në Kosovë, përkundrazi e pranoi shumë normalisht këtë politikë dhe në vend që të tërhiqet, ai e votoi këtë politikë shfarosëse duke ia dhënë verdiktin Sllobodan Millosheviçit dhe të tjerëve kriminelë që edhe sot e kësaj dite dënohen për krime lufte në gjyqin ndërkombëtar në Hagë. Në Maqedoni populli shqiptar i kriminalizuar dhe i terrorizuar nga aparatura e vjetër shtetërore edhe më tej ishte larg realizimit të të drejtave natyrore, e ato janë të drejtat e njeriut, që janë pjesë e çdo institucioni ndërkombëtar e që janë të institucionalizuar në konventa, protokolle apo në mekanizma tjerë juridik dhe janë pjesë e UE-së, OSBE-së, OKB-së etj. Pas stabilizimit të Shqipërisë, pas luftës dhe largimit të forcave serbe nga Kosova, shpresat filluan të ringjallen. Diplomacia amerikane dhe ajo perëndimore do të bëjë përpjekjet maksimale për vendosjen e vlerave demokratike edhe në këtë pjesë të

globit, i cili kishte kaluar nëpër sfida tejet të rënda dhe luftëra të tmerrshme. Megjithë përpjekjet maksimale për vendosje të rendit, qetësisë dhe demokracisë në Ballkan, përmes fushatave të ndryshme dhe mekanizmave të ndryshëm një gjë e tillë ishte tejet e vështirë, sepse ky rajon për më se gjysmë shekulli kishte qenë jashtë gjithçkaje demokratike dhe ishte mishëruar me një sistem të bazuar në centralizëm. Në Kosovë, pas luftës në mënyrë rapide u sensibilizua bota perëndimore në vendosjen e koncepteve të shtetit ligjor dhe demokratik. Në Bosnjë e Hercegovinë poashtu, në Maqedoni fill pas konfliktit të vitit 2001 dhe pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit e garantuar nga ndërmjetësues ndërkombëtar perëndimor, tentohej vazhdimisht në vendosje të rregullit, ligjit dhe rendit. Në Shqipëri poashtu vërehej një sensibilizim i kënaqshëm. Pra, diplomacia perëndimore nuk do lejonte që në Ballkan të përsëriteshin gabimet e së kaluarës, të cilët gjeneruan kriza dhe lufta të mëdha me shumë dëme materiale dhe njerëzore. Një gjë e tillë është duke u provuar edhe në Kosovë me vendosjen së shpejti të misionit civil të UE-së, me pranimin e pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës, me mbikqyrjen dhe kritikat e njëpasnjëshme që u jep shteteve që kanë nënshkruar marrëveshjen e stabilizim-asocimit, me korrigjimet dhe vërejtjet që i bënë shtetit të Maqedonisë, shtet ky kandidat potencial për anëtarësim në UE, me vërejtjet dhe asistencën e njëpasnjëshme që i bën Shqipërisë, Malit të Zi. Pra, vendet e Ballkanit, pra ato që janë jashtë strukturave të NATO-s dhe UE-së nuk kanë tjera alternativa përpos që duhet të pranojnë kushtet dhe kriteret që u detyrohen për përmbushje me qëllim të vendosjes së rregullit dhe rendit demokratik. Edhe pse shtete të caktuara si Serbia deklarojnë se nuk duan të bëhen pjesë e strukturave demokratike për shkak të pavarësisë së Kosovës, me sa duket edhe aty rryma të caktuara po e shohin realitetin se nuk munden të vazhdojnë me politikën e vjetër të izolimit dhe vetëndëshkimit. Pra, me sa duket edhe në Ballkan fryma demokratike po troket në derë dhe është në pragun e derës. Mirëpo, duhet edhe shumë për t`u bërë në këtë drejtim. Pra, po shihet se nocioni i kufijve shtetërorë në Ballkanin e sotshëm nuk e ka më atë kuptim që e kishte dje. Pra po shihet se vetëm kjo pjesë dikur e "nxehtë" e Ballkanit ka mbetur akoma një rajon i fundit gjeopolitik ku mentaliteti i ri dhe kohët e reja ende s`kanë depërtuar krejtësisht, por që ka shpresa falë pranisë, asistencës dhe ndërhyrjes së diplomatëve perëndimorë dhe amerikanë. Për ne shqiptarët është mrekullia e Zotit që jemi përcaktuar aq fort dhe kemi përqafuar shtrëngueshëm evropianizmin dhe kemi përkrah SHBA-të dhe shtetet perëndimore, dhe ky është një shans historik që të realizojmë atë që nuk kemi ditur që ta realizojmë më përpara, për shkak të mosunitetit, për shkak të zgjimit të vonshëm të vetëdijes dhe për shkak të mungesës së një aleati të fortë dhe të duhur. Poashtu edhe shtetet tjera duhet të kuptojnë se është një fat dhe shans historik që të përcaktohen për integrim apo për vetizolim dhe kësisoj shkatërrim, për zhvillim dhe progres apo ngecje dhe regres. Këtë leksion duhet kuptuar mirë, sepse nuk mjafton që të mendojmë shumë. Mjafton që të vizitojmë shtetet si: Sllovenia, Austria, Franca, Italia, Britania e Madhe, Belgjika, Gjermania....., dhe gjithçka do të jetë e qartë për ne. Prandaj, modeli i integrimit të shteteve evropiane duhet të jetë si paradigmë edhe për shtetet e Ballkanit. Që edhe Ballkani të jetë si Evropa apo të bëhet pjesë e Evropës, djepit të civilizimit dhe demokracisë duhet të ndryshohen shumë gjëra. Në Ballkan si pikë e parë duhet të kuptohet se nuk ka të drejta minoritare, nacionale, mazhoritare e ku ta di unë, por ka të drejta njerëzore, apo të drejtat e njeriut dhe ato duhet zbatuar pa hamendje. Shoqëria ballkanike dhe shtetarët ballkanikë duhet kuptuar se koha e politikanëve tribun,

politikanëve "oratorë" që nuk shkulen nga mikrofoni, njerëzve të mitingjeve, njerëzve të rrëmbyer që kanë shkaktuar probleme dhe do të shkaktojnë nëse janë politikisht aktiv, të njerëzve që nuk dinë se çka flasin, të njerëzve euforikë që manipulojnë me ndjenjat e popullit dhe të veshur me petkun e nacionalizmit dhe patriotizmit mundohen të fshehin aferat e tyre të ndryshme korruptive, kriminale, ka marrë fund apo nëse nuk ka marrë fund duhet të marrë fund patjetër. Në Ballkan duhet të vijnë politikanë jo të rrëmbyer dhe të prirë nga fjala, por nga veprimi. Në Ballkan duhet të vijnë liderë që do të dinë të udhëheqin në ekip. Në Ballkan nuk duhet të shfrytëzohen, të shpërndahen dhe të abuzohen të drejtat, por duhet të konservohen dhe të ruhen, por edhe të konsolidohen vazhdimisht, sepse shoqëritë përparimtare janë të ndryshueshme dhe fleksibile , sepse çdo gjë duhet të ndryshojë njëherë përndryshe do të zhvillohej një shoqëri statike. Udhëheqësit politikë në Ballkan duhet të kenë vijimësi politike, duhet të kenë transparencë dhe të jenë të kujdesshëm. Përderisa anglezët mburren me Rold Roys, gjermanët me Mercedesin, francezët me TGV-në ne ballkanasit me çka duhet të mburremi? Me luftëra, me konflikte dhe grindje. Jo assesi. Ballkani duhet që të prodhojë udhëheqës që do të dijnë të largohen në kohën e duhur, në vendin e duhur dhe të lëjnë trashëgimi politike të suksesshme, e jo të kemi udhëheqës që do të prodhojnë vetëm kriza. Të kesh vijimësi domethënë të jesh i suksesshëm dhe i vijueshëm nga të tjerët, model për të tjerët, ndërsa në Ballkan udhëheqësit i kemi të sforcuar, respektivisht të prirë nga militantizmi dhe revanshi. Në Ballkan pushteti që fitohet me votat e popullit abuzohet, sepse politikanët ballkanas pushtetin legjitim në mënyrë të shkëlqyer e shndërrojnë në pushtet me ndëshkim, respektivisht ndëshkojnë opozitën, e kjo e fundit luan me politikën e dubël standardeve dhe politikën e një fëmije të vogël, i cili tenton të ketë për vete çfarë të shoh para vetes së tij. Në Ballkan duhet të ndërtohen patjetër politikanë dhe shtetarë që do promovojnë të drejtat e njeriut, demokracinë parlamentare dhe sundimin e ligjit, respektivisht standardizimin e institucioneve. Në Ballkan shtetet duhet të kenë kohezion social, sepse mungesa e kohezionit social prodhon revolucione, destabilitete, luftëra qytetare dhe kriza permanente. Në Ballkan shtetet dhe popujt duhet të promovojnë politika integruese, miqësore e jo nacionalizma. Edhe pse kjo e fundit është e parapëlqyer nga shtetarët ballkanas, duhet kuptuar se nacionalizmat prodhojnë luftëra. Duhet bërë dallim mes të qenit patriot dhe të qenit nacionalist. Shpeshherë në Ballkan nuk mund të vendosen pika dalluese mes këtyre dy gjërave. Në një rast një burrështetas i famshëm francez deklaron: ***"Nationalisme c`est la guerre, patriotisme c`est l`honeur"*** [6](Nacionalizmi është luftë, patriotizmi është nder). Ky mesazh duhet të shërbejë si leksion për gjithë shtetarët ballkanas, por edhe për popujt ballkanik. Në Ballkan duhet të jetë parësore urbanizimi i vendeve rurale, e jo ruralizimi i vendeve urbane. Përderisa Kanada 90 % është e urbanizuar, 80 % e Evropës është e urbanizuar dhe e modernizuar, edhe ne duhet që të synojmë një gjë të tillë. Në Ballkan duhet lënë hapësirë më të madhe lirisë së shërbimit, të mallrave, kapitalit dhe njerëzve e jo të kufizohen lëvizjet dhe të vendosen pengesa burokratike retrograde. Në Ballkan duhet të kenë rëndësi dhe prioritet qytetërimi, kultura dhe mjedisi. Nuk duhet të shkohet ashtu si pretendohet në varfërimin e të pasurve, por në pasurimin e të varfërve, sepse defekti i marksizmit ishte pikërisht kjo që u tha më lartë. Në Ballkan duhet kuptuar se koha e liderëve historik ka mbaruar, tani ka ardhur koha e lidershipit. Poashtu nuk duhet harruar nga popujt ballkanas se kultura prodhon mjedisin, ndërsa kultura primitive han mjedisin

[6] http://epautistes.coolbb.net/debats-f15/nationalisme-ou-patriotisme-t1946.htm

dhe shkatërron atë. Atë e parasheh edhe konventa e Gjenevës, pra të pasurit ujë, ajër dhe tokë të pastër është parësore. Nëse nuk mund të paktën t`i ruajmë këto, më mirë mos t`i prekim që t`i deformojmë. Pra, krejt në fund mund të themi se dinamika e zhvillimeve politike në Ballkan që të jetë si duhet, duhet të kemi institucione demokratike, të kemi lirinë e lëvizjes së shërbimit, mallrave, kapitalit, njerëzve dhe shërbimeve, duhet që të ndërtohet një opinion publik aktiv, t`i krijohet vend dhe hapësirë institucioneve civile, shoqërisë civile, opinionit publik dhe të zgjidhen udhëheqës jo të prirë nga ndjenja e revanshit, por nga ndjenja e përafrimit dhe lidershipit, të vijnë udhëheqës që do të promovojnë kohezion social, bashkëpunim, garë pozitive dhe me vlera të standardizuara e jo me hakmarrje, me nacionalizëm dhe me patriotizëm të rrejshëm, të vijnë udhëheqës që do të punojnë për popull, sepse mirë thotë Mahatma Gandi. Citoj këtë në frëngjisht: ***"Ce qui est fait sans nous est contre nous"***[7] ***(Ajo që është bërë pa ne, është kundër neve).*** Andaj, duhet të dëgjohet zëri i popullit, opinioni publik dhe qytetar, sepse Ballkani në gjithë këto fusha që i përmenda më lartë ka ngecje dhe lëshime. Duhet që t`i tejkalojë këto që edhe ne si rajon të jemi pjesë e familjes së kombeve evropiane, kombeve me vlera demokratike, kombe tek të cilët mbisundon ndjenja e të qenit i lirë, aktiv, i suksesshëm dhe kompetent. Krejt në fund përmbyll me një thënie timen: "Larg duart nga deformimi i idealit demokratik, sepse ky deformim do të shkaktojë tragjedi, vdekje dhe regres". Andaj, preferoj që të përcaktohemi për progres, shoqëri aktive, për ideale demokratike të formuara mirë që edhe ne të performojmë krah për krah me popujt tjerë dhe me kombet tjera, si dhe të jemi pjesë e Evropës së kombeve të lira.

Tetovë, 15 mars 2008

[7] http://fr.wikisource.org/wiki/Mahatma_Gandhi_(Revue_de_Paris)

(FRANCË, BALLKAN, TURQI)

POLITIKA E FRANCËS NDAJ BALLKANIT DHE TURQISË KTHESA E SARKOZIT

Franca, me kulturën dhe gjuhën e saj mund të themi se ishte e pranishme në Ballkan për shumë vite me radhë. Prania e saj mund të vërehej përmes gjuhës frënge, e cila mësohej në arsimin fillor dhe të mesëm në mënyrë aktive. Gati se nuk kishte shkollë e cila nuk kishte si gjuhë të huaj frëngjishten. Por, ndikimi i gjuhës frënge filloi tatëpjetën pas rënies së ndarjes bipolare. Gjermania, si fuqi tejet e fortë ekonomike u mobilizua shumë shpejt pas bashkimit dhe u bë fuqi. Ndërsa, Franca kishte rezerva për bashkimin e Gjermanisë, sepse territori gjerman do të rritej dhe Franca ia kishte drojën Gjermanisë për shkaqe historike, sepse dy herë ishte shlyer nga harta e Evropës, pikërisht nga Gjermania, fillimisht pas bashkimit të Gjermanisë më 1871 dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore 1940/1945.

Mirëpo, megjithë venitjen e gjuhës frënge dhe dominimin e gjuhës angleze dhe asaj gjermane këto vitet e fundit në planin politik dhe diplomatik, Franca nuk qëndroi duarkryq sa i përket Ballkanit. Ajo përmes ekspertit të saj të së drejtës kushtetuese, Robert Badenter, i cili rregulloi me komision të posaçëm problemet dhe solli pakon e ligjeve që kishin të bënin për pakicat, zhvilloi dhe mbajti pozicionin e vet në Ballkanin Perëndimor. Por, poashtu edhe Partneriteti për Paqe i propozuar nga Aleanca Veriatlantike në janar 1994, ishte e admiruar dhe e favorizuar nga politika dhe diplomacia franceze. Ndërsa, në planin ushtarak Franca riafirmonte se siguria në Ballkanin Perëndimor ishte prioritet i saj. Ndaj edhe pjesëmarrja e saj në misione të ndryshme paqëruajtëse, në kuadër të shumë organizmave ndërkombëtarë ishte tejet e pranishme. P.sh. UNPROFOR, helmetkaltërtit etj. Por, ajo që la më shumë dilema të hapura ishte çështja e rolit të Francës në luftën e Bosnjës. Pikërisht, gjatë vizitës së presidentit francez të asaj kohe, Fransoa Miterran, qytetit të Sarajevës nuk u kuptua fare se pse presidenti shkoi të negocionte me luftëtarët myslimanë që mbanin aeroportin nën kontroll, si i bindi që ta braktisin aeroportin dhe ta dorëzonin atë, me ç'rast në këtë mënyrë u ndihmuan forcat serbe të hynin në aeroport dhe të bënin kërdi në Sarajevë. Kjo dilemë ende s`është sqaruar tërësisht, edhe pse ka dyshime se politika franceze përkrahte politikën serbe për shkak të aleancave të vjetra dhe si një kundërpeshë ndaj Austrisë dhe Gjermanisë, të cilët përkrahën kroatët gjatë luftës serbo-kroate. Ndërsa, në rolin e saj në Kosovë ende ekziston dilema se si ishte e mundur që zëvendësi i misionit të OSBE-së, Gabriel Keler, zëvendës i Uilliam Vokerit, francez, i cili me rastin e kryerjes së Masakrës së Reçakut nga forcat serbe më 1999, deklaroi se kjo vepër ishte e kryer nga shqiptarët e jo nga serbët.[8] Kjo deklaratë erdhi menjëherë pas denoncimit që i bëri Uilliam Uoker aktit barbar serb mbi civilët e pafajshëm të Reçakut. Njëkohësisht "gabimet" e pilotëve francezë të NATO-s gjatë sulmeve mbi Serbinë dhe forcat serbe në Kosovë lypsen të studiohen më tepër, sepse "gabimet" e tyre gjatë sulmeve në Kosovë kushtuan shtrenjtë jetën e shumë civilëve shqiptarë të pafajshëm. Për këtë, sipas mendimit tonë, ekzistojnë dy alternativa: njëra që forcat serbe t`i kenë shfrytëzuar civilët shqiptarë si mburojë krahas sulmeve të NATO-s, e tjetra që pilotë të caktuar francez me instruksione të caktuara të kenë "gabuar". Një gjë e tillë nuk është studiuar ende, por lypset të studiohet patjetër. Poashtu, edhe roli pasiv i ushtarëve francezë në Mitrovicë, kur rojat e

[8] Deklaratë e dhënë për media, 16 janar 1999, TVSH,

urës serbe vrisnin dhe keqtrajtonin shqiptarë të pafajshëm duhet të studiohet me kujdes, sikurse edhe procesi i ndarjes së qytetit të Mitrovicës. Ndërsa në anën tjetër, roli i dy francezëve mediatorë të UE-së në krizën e vitit 2001 në Maqedoni, respektivisht të Fransoa Leotard dhe Alen Leroa, kontribuoi tepër në kthimin e stabilitetit të Maqedonisë dhe kësisoj qetësimin e rajonit, i cili rrezikohej të shpërthente, nëse nuk parandalohej, si dhe për nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Me këtë akt bëhet fjalë për një diplomaci të suksesshme në mënjanimin e një krize, e cila do të shndërrohej lehtë në luftë civile dhe mund të përkeqësohej në përmasa rajonale. Por falë diplomacisë evropiane të udhëhequr nga dy mediatorët francezë u parandalua më e keqja. Ndërsa, gjatë periudhës 2000-2006, UE me asistencën franceze dhe gjermane në koordinim me partnerët amerikanë ka ndarë 4,5 miliard euro ndihmë për rikonstruimin dhe zhvillimin e Ballkanit në kuadër të programit ***CARDS.*** [9]

(FRANCË)
FRANCA DHE POLITIKA E SAJ NËN OMBRELLËN E SARKOZIT

Në rrafshin global, për herë të parë kemi ndryshimin e politikës apo të gjeopolitikës franceze. Ajo tashmë është pozicionuar përkrah SHBA-së, duke vënë në pikëpyetje proevropianizmin e ideatorëve të saj. Për herë të parë nuk ka divergjenca mes këtyre dy shteteve, të cilët kishin aq shumë antagonizma deri në kohën e Shirakut, e që datonin që nga De Goli. Për herë të parë Sarkozi, Kushner etj, japin deklarata që janë konform deklaratave të shtetarëve amerikanë, në lidhje me krizën e Iranit, Irakut, Afganistanit, përderisa qeveria e Shirakut dhe Shiraku kritikonin rolin e SHBA-ve në nivel global, e veçanërisht në luftën e Irakut. Poashtu, si kurrë më parë janë ashpërsuar kundërshtimet franceze ndaj pranimit të Turqisë në BE.

Kemi deklaratën e parlamentarit të njohur francez, Pierre Lequiller, kryetar i Komisionit të Asamblesë Nacionale Franceze për Evropën, i cili deklarohet publikisht për mosanëtarësimin e Turqisë në BE. Njëkohësisht, ai shpreh dëshirën për një Evropë të fortë politikisht, të gatshme për të folur me një zë të vetëm në botë, por me Turqinë jashtë saj. [10] Ndërsa, gjatë vizitës së tij në Ankara, këshilltarit kryesor diplomatik i Presidentit Francez Sarkozi, Zhan David Levit, ish-ambasador i Francës në SHBA, në Ankara ai deklaroi se Franca dhe presidenti Sarkozi nuk pranojnë Turqinë pjesë të UE-së. Ndërsa, kryeministri turk, Rexhep Taip Erdogan, sugjeroi shtyrjen e një debati mbi anëtarësimin e Turqisë në UE, pasi sipas tij procesi negociues pritet të zgjasë edhe më tej, ose së paku 10 vjet. Sarkozi duket se nuk lëshon pe. Ai riafirmoi se kundërshton praninë e Turqisë në UE. Këtë e citoi edhe në Konferencën e shtypit që e mbajti në Bruksel, në Konferencën e organizuar nga presidenti i Komisionit Evropian, Hoze Manuel Barroso. Sarkozi i ofron Turqisë partneritet të veçantë brenda një Unioni mesdhetar që do të përfshinte vendet përgjatë Mesdheut në Evropë, në Lindjen e Mesme dhe në Afrikën e Veriut. Ndaj këtij qëndrimi kulmoi deklarata e ambasadorit turk në Paris, Sonmel Koksal, i cili kritikoi politikat e ashpra franceze ndaj të huajve dhe emigrantëve. Ai shtoi se nuk ka përjashtime dhe koncesione në lidhje me pranimin e Turqisë në BE.[11] Sa i përket kësaj, mendojmë se

[9] http://europa.eu/legislation_summaries/enlargement/western_balkans/r18002_fr.htm
[10] Pierre Lequiller, *Head-to-Head, Turkey and the EU,* BBC News, 10/3/2005

[11] http://gazetajava.com/ortman/publish/printer_821/.shtml

Franca do ta mbrojë edhe më tej këtë qëndrim, sepse me pranimin eventual të Turqisë në UE, Franca si kreatore e UE- së, do e humbiste rolin e saj apo pozicionin e fortë të saj në UE, sepse automatikisht Turqia që ka një popullsi më të madhe se Franca, do të merrte primatin, duke rritur përfaqësimin. Sarkozi është koshient për këtë dhe duket se nuk do të bëjë koncesion, sepse sipas tij, gjithçka e ndërtuar për 50 vjet nga Franca do të ishte pa vlerë. Kështu deklaron edhe diplomacia franceze. Ata theksojnë dhe mbrojnë idenë se UE nuk mund të zgjerohet në kufijtë kritik të Irakut. Sipas shtetarëve francezë dihet se deri ku është Evropa. Sipas tyre nuk mund të shtrihet Evropa në një territor aziatik. Kjo është edhe arsyeja që ata mbrojnë, duke thënë se Turqia pjesën më të madhe të saj e ka në Azi. Me pranimin eventual të Turqisë në UE, Unioni atëherë do të kufizohej me shtete që shfaqin kriza vazhdimisht dhe që kanë destabilitet permanent, siç janë: Iraku, Irani, Siria etj. Këtij refuzimi i shtohet edhe arsyeja konspirative apo perfide që nuk shpaloset: Turqia është shtet me popullsi myslimane dhe si e tillë nuk mund të imagjinohet një shtet mysliman në mesin e konjukturave të shteteve perëndimore të Evropës së Bashkuar, ide kjo në fillim e shpalosur si ide e Evropës së krishterë. Ministri i jashtëm francez, Bernard Kushner, përsërit vazhdimisht se kërkohet partneritet me Turqinë, ndërsa Ministri i Jashtëm turk, Ali Babaçan, thekson vendosmërinë e anëtarësimit të Turqisë në BE. Pjesë e mosmarrëveshjeve mes këtyre shteteve është poashtu edhe debati lidhur me një ligj francez të miratuar vitin e kaluar, që e cilësonte si krim mohimin e gjenocidit otoman kundër armenëve. Sipas studiuesve perëndimorë, mbi një milion e gjysmë armenë humbën jetën gjatë fushatës së forcave otomane për t`i dëbuar armenët nga rajonet e Turqisë Lindore më 1915. Turqia deklaron se një numër i madh armenësh të krishterë dhe turq myslimanë u vranë në luftimet etnike gjatë rënies së Perandorisë Otomane në Luftën e Parë Botërore.

Sidoqoftë, para se të kërkojë me ngulm anëtarësimin në UE, Turqia duhet t`i nënshtrohet një sërë reformash të patjetërsueshme dhe të domosdoshme, ndërsa Franca duhet të jetë më fleksibile dhe të ofrojë të paktën diçka më konkrete për të zgjidhur këtë lëmsh. Fundja, le të diskutohet anëtarësimi i mundshëm i Turqisë "evropiane".

Kumanovë, 01 maj 2009

(BALLKAN- EVROPË)

EDHE BALLKANI DUHET NË UE, POR...

Ballkani, ky rajon me një pozitë të volitshme gjeografike, me pozitën e tij të përshtatshme në paralelen e 40, me 270 ditë me diell,[12] gadishull me ujë, me klimë alpine-kontinentale dhe mesdhetare, por edhe me konceptin e miteve, legjendave, idoleve, autoktonisë dhe origjinalitetit, historisë, traditës, virtyteve, vlerave, filozofive të ndryshme, bastion i mburrjeve dhe i krenarive të tepruara. Mburrjet dhe krenaritë e tepruara ballkanike përpos që kanë zënë një vend të rëndësishëm në analet botërore, kanë sensibilizuar udhëheqës të mëdhenj, perandorë, mbretër, gjeneralë… që të ndërmarrin hapa të nevojshëm dhe domosdoshëm për të ndaluar impaktet e kësaj mburrjeje të tepruar dhe krenarie të ekzagjeruar edhe në pjesë të ndryshme të globit. Ky rajon i cili cilësohet si rajon problematik, për shkak të luftërave dhe konflikteve permanente në të kaluarën e deri në fund të shekullit të kaluar, ka sfiduar Evropën e vjetër, të qytetëruar dhe të civilizuar. Ndonëse popujt e Ballkanit janë tejet solidarë, ata njëkohësisht janë edhe tejet impulsiv dhe nuk mund ta durojnë njëri-tjetrin, respektivisht prezencën e njëri-tjetrit. Kjo ka qenë si shkak i fillimit të shumë luftërave dhe konflikteve, të cilat kanë pasur edhe impakte botërore. Me të drejtë është konkluduar se Ballkani (s`)është prodhuesi më i mirë i historisë, e shumë pak konsumues i saj, sepse ai edhe pse ka prodhuar shumë histori, nacionalizmat e shfaqura në aspekte negative dhe në dëm të popujve të tjerë, shpesh në performimin e shovinizmit kanë krijuar vetëm probleme. Është koha që ky rajon të lërë pas të kaluarën e bujshme dhe problematike, e të fokusohet në aktualitetin dhe në futurologjinë e tij. Edhe pse Bizmarku thoshte vazhdimisht: ***"Mos u merrni me popujt e Ballkanit, se ata janë grindavec dhe konfliktuoz"***[13] ndërsa, realiteti dëshmoi të kundërtën. Duke mos u marr me Ballkanin, Evropa shpesh ndodhej në pikat kulminante të rrezikshmërisë të të qenit si Evropë. Kjo u dëshmua edhe në luftërat e fundit në rajon. Ajo duke mos u marr sa duhet me këtë rajon, lejoi luftërat e përgjakshme, cilët nuk ishin parë që nga lufta e dytë botërore. Andaj besojmë se tani Evropa e ka kuptuar rëndësinë e madhe të Ballkanit dhe të moslëçitjes së tij. Por, Evropa nuk mund të fajësohet për lëçitjen që ja bëjmë ne vetvetes sonë si ballkanas, sepse viteve të fundit Evropa është sensibilizuar mjaft për ta futur edhe këtë rajon në familjen e madhe evropiane. Kjo dëshmohet me marrëveshjet e shumta të UE-së me shtetet e Ballkanit, me marrëveshjen për stabilizim dhe asocim, ndërmjetësimi për ndërprerjen dhe parandalimin e konflikteve në Ballkan, e së fundi edhe me heqjen e vizave, respektivisht me lehtësimin për lëvizshmëri të qytetarëve të disa shteteve të Ballkanit, nëpër Evropë. Ballkani si rajon duhet të jetë koshient, se nuk duhet të pritet asgjë nga Evropa, pa mos u vetëdijesuar dhe ndërmarrë diçka pozitive nga vetë Ballkani. Ai duhet të ketë të qartë se sa kohë që vonohet për integrim në Evropë, aq më shumë qytetarët e vetë irritohen dhe aq më shumë probleme do të ketë. Për këtë shtetet e Ballkanit duhet të kenë parasysh se integrimi në UE është investim, respektivisht demonstrim i kapaciteteve dhe një lloj gare. Shtetet ballkanike nuk duhet absolutisht të harrojnë Kriteret e Kopenhagës të vitit 1993: kriteret politike, ekonomike dhe juridike si dhe ato të Madridit të 1995-së, si shtojcë apo

[12] Op. cit.
[13] http://www.mesazhi.com/author_article_print.php?id=814

suplement, kriteret e kapaciteteve administrative të shtetit.[14] Që Ballkani të jetë pjesë e UE-së dhe të integrohet, ose në formë të grup-shteteve, ose secili shtet veç e veç, (kjo nuk ka rëndësi) më me rëndësi është që të kultivohen raporte të mira ndërfqinjësore, të respektohen të drejtat e njeriut e shumë gjëra të tjera. Si kritere politike llogariten këtu: ***stabiliteti politik***, i cili mungon në Ballkan me gjithë përparimet prej breshke, ***demokracia,*** si koncept më i përdorur teorik nga goja e ballkanasve dhe nga politikanët ballkanas, me ç`rast është dëshmuar se ende Ballkani është larg demokratizimit të duhur, ***sundimi i ligjit***, ku dihet se kjo është pika më problematike për Ballkanin apo për shtetet e Ballkanit. Ballkanasit janë të parët që sjellin ligje, që stërzgjatin procedurat parlamentare, që i zgjasin fjalimet nëpër foltoret e parlamenteve, që sjellin vazhdimisht ligje, por që nuk implementojnë praktikisht shumicën e atyre ligjeve që sjellin, ***të drejtat e njeriut,*** që janë me rëndësi të madhe dhe të patjetërsueshme e dihet dhe shihet se ky kusht apo parim është më i keqpërdoruri në Ballkan, sepse ende ka shtete ballkanike si Serbia që refuzon denacifikimin, nuk kërkon falje për krimet e bëra ndaj shteteve fqinje, pengon zhvillimin normal dhe konsolidimin e institucioneve kosovare, nuk dorëzon kriminelët e luftës, etj. Si kritere ekonomike llogariten ***ekonomia e lirë e tregut,*** e cila duhet të jetë konkurruese me ekonomitë e shteteve të UE-së, e dihet se ekonomitë e shteteve ballkanike janë në letargji, ende janë larg të qenit në shkallën e duhur, ende prodhimet bujqësore nuk dihet se a shiten a jo, ende bujqit janë kategoria shumë e ngjashme me shoqërinë skllavopronare, ende shtetet ballkanike nuk kanë vizione dhe parashikime për të ardhmen e as për të tashmen, por merren me të kaluarën, ende krijohen debate dhe polemika mbi identitetin e kombeve në Ballkan, ende ndërtohen statuja për të dëshmuar lashtësinë, e harrohet ardhmëria, ende statujat monstra dhe përmendoret gjigante, kishat dhe kryqet provokojnë dhe sfidojnë ekonomitë e shteteve ballkanike, sepse paratë harxhohen në gjëra absurde dhe alogjike, e jo në gjëra profitabile. Parimet juridike që kanë të bëjnë me ***përshtatjen e legjislacionit kombëtar me atë të UE-së*** ende janë larg të qenit objektive dhe të implementuara praktikisht, sepse nacionalizmi negativ ka zënë peng shtetet ballkanike, ende nuk është bërë katarza e Serbisë, e nuk mund të ketë përshtatje me legjislacionin e UE-së, kur prezentë në legjislacione kombëtare janë projekte shfarosëse dhe antinjerëzore të Nacertanies e kështu me radhë. Dhe së fundi, kriteret administrative të shtetit kanë të bëjnë me ***kapacitetin dhe gatishmërinë e shteteve për të implementuar politikat dhe të drejtën e UE-së***. Shtetet ballkanike në vend të perfeksionimit të administratës shtetërore, ata partizojnë administratën shtetërore dhe monopolizojnë atë. Ata në vend të standardizimit të institucioneve dhe afirmimit të kuadrit cilësor, afirmojnë kuadro jocilësore, analfabetë me diploma të blera dhe të kontestuara, militantë partiak dhe pse jo edhe komandantë që diplomat i kanë marrë me forcë apo në forma tjera koercitive, korrupsioni dhe nepotizmi janë pjesë e pandashme e administratave shtetërore të shteteve ballkanike. Pra, marr në përgjithësi, mund të konkludohet në mënyrë afirmative se vendi i Ballkanit dhe i shteteve ballkanike është padyshim në UE, por ka rrugë të gjatë për t`u realizuar kjo. Nëse dëshirohet të shihet dhe dihet se çfarë rruge, duhet të merret rruga për ekskursion drejt shtetit të Sllovenisë, e mandej vetëm të vazhdohet më tutje gjetiu dhe do të jetë gjithçka e qartë. Edhe pse mëtohet nga shtetet ballkanike se janë plotësuar kushtet për integrim në UE, ajo është vetëm një ëndërr. Sepse suksesi nuk arrihet me bërtitje, por me urtësi, punë dhe dituri. Me fjalë të bukura dhe të ëmbla, pa punë nuk arrihet asgjë. Papunësia është

[14] http://europa.eu/scadplus/glossary/accession_criteria_copenhague_fr.htm

nënë e të gjitha të këqijave, e puna është babai i çdo gjëje të mire. Në Ballkan varfëria është mburrje. Varfëria ekonomike është më e keqe se skllavëria. Evropa, edhe pse në dukje është vegjetariane, ajo nuk han bar. E ne nuk mund ta mashtrojmë atë. Sepse gjithçka që bëjmë ndikon në të ardhmen tonë. Lulet e ardhmërisë gjenden në farën e së tashmes.

Kumanovë, 17 gusht 2009

(DIPLOMACI DHE MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE)

MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE – NJOHURI GJENERALE

E tërë bota moderne ka historinë e vet, pasi po të mos të ishte kjo shkalla e lartë e civilizimit që jetohet sot, nuk do të ishte e mundur. Të nisësh një marrëdhënie nuk është e vështirë, por të çosh atë brez pas brezi, dinasti pas dinastie, shtet pas shteti, individ pas individi është tej mase e vështirë. Sekreti i kësaj marrëdhënie është se nuk ka sekret. Komplikimet dhe mosmarrëveshjet në një marrëdhënie mes shtetesh janë rezultat i punëve të dobëta të kryera nga njerëzimi në shekuj. Është e folur dhe shkruar shumë lidhur me teoritë rreth marrëdhënieve ndërkombëtare, por për praktikat ndërkombëtare është shkruar fare pak. Forca e arsyes dhe koshiencës në marrëdhëniet ndërkombëtare është thelbësore për të forcuar dhe zgjeruar bashkëpunimin pa të cilin në kohët moderne nuk arrihet triumfi. Marrëdhëniet ndërkombëtare në kohën tonë kanë marrë një zhvillim të paparashikuar dhe të hovshëm. Kjo nuk lidhet aq shumë me dëshirën e njerëzimit për të ecur përpara, sesa për nevojën egoiste për të pasur çdo moment përmirësimin e kushteve të jetës dhe vetëkontrollin për të trajtuar qeniet njerëzore të varura nga nevoja për t`u përmirësuar. Mos të harrojmë se çdo shtet i madh apo i vogël, në çdo vend të botës, ku padyshim që hyjnë edhe Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe shtete tjera në tranzicion, me gjithë dëshirën e madhe për të bërë sa më shumë, madje më shumë nga sa i kanë mundësitë, duhet të bashkëpunojnë me shtetet tjera me demokraci të konsoliduar dhe me peshë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Sigurisht që është më tepër e lehtë për t'u thënë sesa për t`u bërë. Dhe kjo për një arsye shumë të thjeshtë. Çdo komb, çdo popull dhe çdo shtet ka mentalitetin e vet dhe qëllimet e veta. Shumë herë ndodhin raste kur dy njerëz nuk merren vesh njëri me tjetrin, imagjinoni se ç'mund të bëjnë dy shtete me miliona banorë. Kur dy veta mezi merren vesh pasi kanë interesa të kundërta, po shtetet si mund të merren vesh? A ka mekanizma lidhur me këtë çështje? Përgjigja e këtyre dy pyetjeve janë marrëdhëniet ndërkombëtare. Kaq të nevojshme janë? Në fillim shtetet lindën si shtete sovrane, madje janë gjakosur për këtë sovranitet. Por tani a mund të thuhet e njëjta gjë? Sigurisht që një marrëdhënie kërkon aktorë që ta mbajnë gjallë lidhjen dhe aktorët e marrëdhënieve ndërkombëtare janë qeveritë e shteteve të botës. Është organizmi i tyre që mban marrëdhënien gjallë. Po si mbahet marrëdhënia gjallë? Nëpërmjet interesave. Sistemi modern ndërkombëtar ka filluar prej më shumë se 500 vjetësh. Arsyeja dhe dija mbizotëroi mbi injorancën dhe paditurinë. Mjerë injoranca, por mbi të gjitha mjerë njerëzimi nga një arsye djallëzore mbizotëruese. Shtetin e bëjnë shtresat. Që politika e një shteti t'i nënshtrohet idesë së një shtrese, atëherë është e nevojshme që kjo shtresë të marrë pushtetin politik. Në marrëdhëniet ndërkombëtare është e nevojshme të kihet parasysh se pushteti, vjen si rrjedhojë e ndryshimeve të interesave që përfaqësojnë këto ndryshime. Ndryshimi asnjëherë nuk mendohet, por imponohet. Ai vjen si rrjedhojë e një pakënaqësie ndaj një gjendjeje të caktuar. Ekuilibri në marrëdhëniet ndërkombëtare është një tjetër hallkë që meriton vëmendje. Kjo nuk ka lidhje aq shumë me barazinë mes njerëzve, se sa ka të bëjë me barazinë ndërmjet rangjeve politike. Shtetet nuk janë kurrë të barabartë. Ka shtete të vegjël, të varfër, të mëdhenj e të pasur. Po rangjet dhe gradat janë njëlloj. Prandaj kur pritet një delegacion zyrtar, forca e shtetit mikpritës tregohet tek gjenialiteti për të respektuar sipas rangut

anëtarët e tjerë që kanë ardhur. Përshtatja në evolucionin e rangut ka të bëjë jashtëzakonisht shumë në marrëdhëniet ndërkombëtare për një arsye shumë të thjeshtë. Jepi tjetrit të kuptojë se jeni të barabartë në mënyrë që të mos bëjë aleancë me dikë tjetër për të dezekuilibruar sistemin e supremacisë dhe dominimit që ekziston mes jush. Marrëdhëniet ndërkombëtare varen shumë nga forca e individëve. Nuk janë të pakta rastet kur në diplomaci forca dhe gjenialiteti i njerëzve të caktuar kanë imponuar marrëdhëniet ndërkombëtare. Gjithnjë dobësia në këtë lloj ***"lufte"*** paguhet me çmim tepër të rëndë që kërkon breza të tërë ndryshimesh. [15]

Aq e fuqishme është forca e imponimit të individëve të veçantë në marrëdhëniet ndërkombëtare, saqë është thuajse e pamundur ta ndalosh për një kohë të caktuar. Sigurisht që individë të cilët drejtojnë shtete nuk mund të mos bëjnë gabime në sistemet ndërkombëtare të cilat ata i krijojnë vetë. Të krijosh një sistem ndërkombëtar me ndikim të madh e të jashtëzakonshëm, nuk është vepër e të gjithë njerëzimit, por vepër e njerëzve të veçantë të ushqyer nga të metat dhe aftësitë e njerëzimit. Njerëzimi është një njësi e manipulueshme për një farë kohe. Ky manipulim mund të ndalet vetëm nëse dikush që është kundërshtar i idesë së "manipulatorit" aktual, "shpif" një formë tjetër më të besueshme të manipulimit publik vendas apo ndërkombëtar. Diplomacia është mekanizmi më i përkryer i manipulimit në marrëdhëniet ndërkombëtare. Sigurisht, diplomatët janë njerëz të një kulture tepër të lartë. Shumë mendojnë se kultura në diplomaci dhe në politikë është mekanizmi për të fshehur imazhin e vërtetë të asaj çfarë duket për të arritur një synim të caktuar. Që në kohën kur sistemet ndërkombëtare filluan të marrin formë, rëndësia që i kushtohej interlokutorëve dhe negociuesve ishte e madhe. Klasa të caktuara politike që morën pushtetin në vende të ndryshme të Evropës, pasi ky kontinent është baza e modernizmit të marrëdhënieve ndërkombëtare, vendosën diktatin e tyre në botë. Një shtresë e caktuar është gjithnjë në përplasje me një shtresë tjetër për supremaci dhe dominim, fillimisht brenda vendit të origjinës. Krijimi i shteteve kombe i dha jetë edhe supremacisë së një vendi ndaj vendeve të tjera. Por është më tepër sesa e gabuar të mendosh se supremacia në marrëdhëniet ndërkombëtare është e përjetshme. Të shumtë kanë qenë burrat e shtetit që i janë përkulur përjetësisë dhe shkatërrimit të asaj çka ndërtuan. Fjalët e famshme të Cezarit : "Më mirë do të preferoja të isha i parë në një fshat barbarësh, sesa i dyti në Romë" janë tepër domethënëse për mendimin tim. Mendoj kështu, se etja për pushtet dhe supremaci të pamatë janë fillimisht çelësi i suksesit dhe më pas rrënimi i tij. Cezari ishte tepër ambicioz dhe rënia e tij mund të merret si shembulli më tipik i asaj që nuk gëzoi; EMRIN. Ai mbeti viktimë e ambicies së emrit të tij. Emri iu trashëgua nga të gjithë ata që "kopjuan" mënyrën e tij të të bërit politikë, pa bërë gabimet e tij dhe u quajtën Cezar nga e gjithë bota. Kemi liderë të tjerë të tipit të njëjtë të Cezarit, Kanibalin, vijnë në mënyrë suksesive udhëheqës të tjerë si : Lenini, Hajzeri, Hitleri, Musolini, Stalini, Enver Hoxha, Mao ce Duni e deri në ditët e sotshme. Të gjithë mund të mësojmë se si përfitohet nga gabimet e një njeriu të madh. Tragjikja i mbetet atij, që "shkon". Pasuesi është i vëmendshëm ndaj jetës së atij që ka qenë i parë. Por të gjithë, edhe pasuesi vet bën gabime për të ja lënë vendin një tjetri që do jetë më i aftë ose jo, për t'i çuar më përpara marrëdhëniet njerëzore apo për t'i rrënuar dhe prishur ato. Niveli i lartë i sotshëm në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe në diplomaci është vepër e njerëzve të aftë të dalë nga shekujt e historisë. Sistemet ndërkombëtare me të mirat dhe të metat e tyre kanë qenë dhe do të mbeten edhe sot e kësaj dite objekt studimi dhe reflektimi.

[15] Boriçi, Gjon, Mardhëniet ndërkombëtare, GEER, Tiranë 2006, fq. 21

Vetëm Zoti është i përsosur, të gjitha gjërat e krijuar nga njerëzit nuk janë dhe nuk do të jenë asnjëherë. Për këtë arsye dalin në skenë ide të njëpasnjëshme dhe ato që i rezistojnë kohërave më shumë se paraardhëset mund t'i afrohen asaj që quhet ideale apo siç ka tendenca të perceptohet dhe synohet të arrihet si e tillë. Sistemet ndërkombëtare të krijuar nga njerëz me vizione të qarta kanë mbetur si fanarë të një mësimi të madh në diplomaci dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare: "Vendet, iniciativat, të mirat, krimet, mashtrimet mund të ndryshojnë përmasat e tyre por idetë në kohëra të caktuara jo. Sepse ato krijohen nga njerëzit në kohë të caktuara dhe kthehen në institucione në kohë të caktuara". Sepse siç thoshte ish - presidenti amerikan, Xhon Kenedi, "***Njerëzit lindin dhe vdesin, kombet ngrihen dhe bien, por idetë janë të pavdekshme. Ato nuk vdesin kurrë.***" [16]Kjo është edhe misioni i njerëzve që dëshirojnë të mbesin çdoherë në histori dhe të përsëriten vazhdimisht emrat e tyre për të mirë.

Kumanovë, 30 janar 2009

[16] http://www.infoarkiv.com/media/artikull/iden/123756/titulli/Xhon-F.-Kenedi-dhe-vizioni-i-tij-i-ri-per-Ameriken

(KOSOVË, SHQIPËRI DHE MAQEDONI)

"SËRISH VJEN MARSI"!

Nëse e pranojmë tezën se, nëntori është muaji i krenarisë shqiptare, atëherë çfarë mundë të themi për muajin mars, ku dihet mirëfilli se po në këtë muaj filluan sulmet barbare të befasishme ndaj familjes Jashari në Drenicë, po në këtë muaj filloi lufta mes kryengritësve shqiptare dhe atyre maqedonas, po në këtë muaj filluan përgatitjet e kryengritësve shqiptarë kundër pushtuesve sllavë, po në këtë muaj filluan trazirat në Kosovë, të ashtuquajturat trazirat e marsit, si dhe në çdo vit para këtij muaji, këngëtari i shquar nga Kosova, Ilir Shaqiri, na paralajmëronte me këngën e tij, "Sërish vjen marsi" për ndonjë konflikt të mundshëm, por edhe për një muaj, i cili për neve shqiptarëve na paralajmëronte që t'i hapim sytë katër e veshët tetë. Kësisoj, ne shqiptarët kudo që gjendeshim, me ardhjen e këtij muaji nuk ndjeheshim mirë, na pushtonte një ndjejnë pesimizmi, përkundër që në mes të muajit mars fillon pranvera, lulet fillojnë të na kënaqin me aromën e tyre, zëri i bilbilit na rehabiliton trurin tonë të ngarkuar nga stresi i stinëve tjera, si dhe shumëçka tjetër në dobi të shëndetit dhe jetës sonë. Por ne shqiptarët jo gjithherë kemi mundur t'i shijojmë begatitë e pranverës, ngase në vend të aromave të luleve, e kemi nuhatur aromën e barotit, në vend të zërit të këndshëm të bilbilit i kemi dëgjuar zhurmat trishtuese të tankseve, topave dhe fjalëve ndjellakeqe të njerëzve, si dhe shumëçka tjetër në dëm të shëndetit dhe jetës sonë. Por, ne si popull shqiptarë, nuk jemi edhe aq të prirë të besojmë në bestytni. Me këtë titull nuk dëshirojmë të ndjellim kob ndër njerëzit, sikurse me ardhjen e muajit nëntor që nuk dëshiruam të ndjellim kënaqësi dhe shpresë për të ardhmen dhe fatin tonë. Por ne besojmë dhe mbështetemi në rrjedhat e kaluara dhe të tashme të popullit shqiptarë dhe, tek pastaj mundë të vijmë në përfundim për muajt progresiv apo regresiv në vijim. ***Sepse popujt përtacë, si arsyetim të neglizhencës së tyre janë të prirë për nga natyra të besojnë më shumë në besëtytni, sesa në rezultatet nga puna reale e tyre.*** Askush nuk mund ta arsyetojë dështimin e zgjedhjeve me 22 mars (dashtë Zoti të mos dështojnë), vetëm se ky muaj, kinse për shqiptarët qenka "muaj ogurzi". Të mos harrojmë, zgjedhje fatale patëm në muajin qershor, pra ky nuk ishte ndonjë muaj karakteristik për shqiptarët, edhe pse për nga ndodhitë nuk mund të themi se nuk ishte i tillë.

Pra, zgjedhjet do të vijnë, do të vjen sërish pranvera, por vallë bashkë me fillimin e pranverës, a do të fillojnë të lulëzojnë edhe të drejtat tona natyrore? Në këtë ditë vallë do të votojmë nën tytën e njësitit special **"Alfa"** dhe, pastaj të flasim për zgjedhje korrekte, demokratike dhe të lira! Athua vallë pas këtyre zgjedhjeve do të kemi zgjidhje, apo kjo do të jetë vetëm një rutinë votimesh sikur çdoherë! Padyshim që do të jetë një rutinë e radhës, sepse në spektrin politik shqiptar luhet e njëjta lojë, me të njëjtët lojtarë, për dallim prej herëve tjera disa lojtarë në mozaikun politik i kanë ndërruar numrat dhe petkat, por loja luhet prapë në të njëjtin stadium. Nëpër ndeje të odave (sepse ende zyrtarisht nuk ka filluar fushata) na paraqiten njerëz, të cilët me vite të tëra u pasuruan në maksimum, me vite të tëra mashtruan popullin, si dhe me vite të tëra vetëm llomotitën duke mos punuar asgjë. Por, paradoksi tjetër i radhës qëndron tek intelektualët, të cilët para këtyre njerëzve qëndrojnë gatitu dhe ende pa e mbaruar fjalën të vetëquajturit intelektualë, ia konfirmojnë dhe afirmojnë fjalinë, si të saktë. Sigurisht që edhe psikologu i shquar botëror, Frojdi, këtë psikologji oportuniste nuk do të mundte ta deshifronte. Si

është e mundur, nga viti në vit mashtrohemi, zhgënjehemi, dhe prapë para këtyre qëndrojmë gatitu, gojë mbyllur, verbërisht i besojmë, dhe mendojmë se me të vërtet në këtë mandat do të ketë zgjidhje të problemeve. Zgjedhjet janë një rast i mirë për popullin që përfaqësuesve të tyre t'ia thonë atë që duhet t'i thuhet. Epërsinë diplomatike të vetme politikanët tanë, e kanë mashtrimin e popullit para zgjedhjeve, dhe pas zgjedhjeve fillon shfaqja e epërsisë së dytë diplomatike, me mbulimin dhe arsyetimin e fjalëve dhe frazave të premtuara para fushatës zgjedhore. Pra, në mënyrë të tërthortë na thonë; "se në atë kohë kur na premtuan ishte një erë mjaftë e fortë, dhe të gjitha premtimet çka i kishin dhënë i kishte marrë era". Mos të harrojmë se edhe populli ynë e posedon një epërsi profesionale të vlerësimit, por e meta qëndron në atë se, këtë epërsi profesionale populli ynë e vë në funksion në kohë të gabuar. Ndjenjën e vlerësimit të drejtë e posedon menjëherë pas zgjedhjeve, por i gjori popull posa të përfundoj mandati i të zgjedhurit, ndjenja e vlerësimit të drejtë disi i fillon t'i zbehet, pra ndjenja dhe ndërgjegjja e këtij populli mjaft të ndërgjegjshëm, por naiv manifestohet në kohëra të gabuara, vlerësimi bëhet, atëherë kur nuk ka vlerë, dhe atëherë kur duhet me të vërtet të bëhet vlerësimi një gjë të tillë populli ynë nuk e bënë. Ky popull ende, fatkeqësisht, po vuan nga sindroma e kontradiktores! Juve politikanë, ju "lumtë" për mashtrimin afatgjatë të popullit me mendime afatshkurtra, ju bëftë mirë nektari i pranverës, sepse për juve edhe nëse nuk do kemi zgjedhje demokratike, edhe nëse bie viktimë ndokush e ai ndokush si çdoherë është shqiptar, edhe nëse nga shkaku i parregullsive zgjedhore nuk do të mundim të aderojmë për në UE, për ju mjafton që keni pasaporta diplomatike dhe të shkoni e shëtiteni sa herë që doni në Evropë, Amerike e gjetiu, për ju nuk është me rëndësi sa a do të kemi zgjedhje të drejta, e të lira, sepse ju nuk do të pësoni, por ne populli me traditë viktimizuese do të viktimizohemi në vazhdimësi. Këtë shkrim po e përmbyllim me tre thënie të urta (njëra profetike):

"***Çdo popull duhet të ketë fuqinë dhe mençurinë, nëse i ka të dyja lum për atë popull, nëse e ka vetëm njërën, jeton disi, nëse nuk e ka asnjërën, mjerë për atë popull" (popullore).***

"Politika është shkathtësi, të merren nga të pasurit paratë, e nga të varfrit votat, me motiv se do t'i mbrosh nga njëri-tjetri" (Perpiti).

"Dy kategori njerëzish, nëse janë të mirë, edhe populli do të jetë i mirë, por nëse janë të degjeneruar edhe populli do të jetë i tillë. Ata janë dijetarët dhe pushtetarët".(profeti Muhammed)

(Këtë ese, e kemi punuar së bashku me kolegun dhe mikun tim, Iljasa Salihu)

Kumanovë, 2 mars 2009

PJESËMARRJA E TË RINJVE NË JETËN POLITIKE

(Tekst i botuar dhe i prezantuar në sesionin III të Parlamentit Frankofon të të rinjve në Bruksel në kuadër të Komisionit të çështjeve parlamentare në vitin 2005 ku autori ka qenë në cilësinë e deputetit)

Njëra prej kategorive universale dhe proceseve më komplekse e sfiduese të shoqërisë është edhe politika dhe proceset politike. Fjala politikë sipas disave d.m.th. dije apo njohuri e përgjithshme me anë të së cilës njerëzit e mençur drejtojnë dhe udhëheqin popujt e tyre në mënyrë që ato të jenë të kënaqur dhe të ndihen të rehatshëm. Gjatë periudhës antike në Greqi, filozofët ishin politikanë që drejtonin shtetin. Para 2500 vjetësh ata sajuan në mes tjerësh edhe fjalën "demokraci" e që domethënë "sundim i popullit". Kur të kombinohen këta të dyja, do të kemi drejtimin dhe udhëheqjen e popullit nga vetë populli. Ashtu si është thënë edhe nga Abraham Linkoln se demokracia është qeverisje e popullit, nga vet populli, për popullin.[17] Ndërsa, sot të dish se kush është president i Republikës, kush kryeson me Këshillin Evropian, çfarë është Komisioni Evropian, të dish kush është George W. Bush....., të lexosh shtypin, ku vendin kryesor e zë politika, nuk është e njëjta gjë sikurse edhe të merresh me politikë, por mendoj se është një nevojë aktuale, në fakt është të jesh në rrjedha të ngjarjeve dhe të njohësh gjërat që na rrethojnë çdo ditë kur zgjohemi. Ndërsa sipas meje, këtu tek ne në Maqedoni dhe në përgjithësi në Ballkanin Perëndimor, kuptimi modern i "politikës" do të thotë të jesh anëtar i ndonjë partie politike dhe të merresh me aktivitete politike, që domethënë të jesh aktivist dhe militant partiak. Por e gjithë ajo që ndodh rreth nesh, ndikon mbi ne dhe ardhmërinë tonë dhe pasi jemi të rinjë, ne duhet të jemi çdoherë në rrjedha dhe kësisoj të ndërtojmë edhe ne kapacitete dhe përmes atyre kapaciteteve të kritikojmë gjërat në shtet, por jo vetëm në kontekst negativ, sepse fjala "kritikë" d.m.th. të formosh një vlerësim, qoftë pozitiv apo negativ rreth një çështje të caktuar. Pra, duhet sensibilizuar nga ana e rinisë formimi i kapaciteteve kritike dhe opinionit kritik të rinisë me qëllim të vlerësimit të gjërave të ndryshme për shtetin, për shoqërinë. Sipas meje, që të ndërtojmë këto kapacitete, duhet të ndërtojmë bindje të caktuara dhe si parakusht për këtë është informimi, edukimi, puna dhe ambiciet, të cilat duhen të jenë të justifikuara. Personalisht përkrah çdo tendencë e cila do të na shpjerë në këtë qëllim e ndoshta edhe disa hapa para, mendoj në pjesëmarrjen e të rinjve në jetën politike. Andaj sigurisht se shtrohen një mori argumentesh për të justifikuar këtë që e them, pra se pse duhet të merr pjesë në mënyrë aktive edhe rinia. Dihet se gjatë evoluimit të historisë botërore, në përgjithësi të rinjtë janë shfaqur si një motor i shoqërisë i cili ka vënë në lëvizje dhe funksionim shoqërinë. Në përgjithësi të rinjtë janë shfaqur si protagonistë kryesorë të ndryshimeve me ide progresive dhe me vizione të qarta. Rinia është pjesa më vitale dhe më revolucionare e secilës shoqëri në çdo shtet dhe vend. Të rinjtë i kanë thënë çdoherë PO gjërave progresive dhe JO vasalitetit, tiranisë dhe okupimit. Shumica e luftërave çlirimtare dhe revolucioneve janë kryer nga të rinjtë dhe të cilat si epilog kanë pasur çlirim, ndryshim sistemi, ndryshim ideologjie, fillim i një fryme të re. Kësaj i shtoj një kronologji me disa shembuj dhe fakte justifikuese të cilat na afirmojnë këtë që e them dhe e pohoj. Për shembull Revolucioni Gjon turk, i kryer nga të rinjtë turq solli rezultate të lakmueshme me ç'rast ndryshoi sistemin e vjetër të asaj kohe dhe solli disa të drejta në atë kohë.

[17] http://showcase.netins.net/web/creative/lincoln/speeches/gettysburg.htm

Mandej Revolucioni i Majit 1968 në Francë solli zëvendësimin e sistemit patriarkal të familjes me sistem modern të familjes të bazuar në "negociation" ***(negociata)*** me ç'rast roli i fëmijëve i cili deri në atë kohë ishte i minuar, doli nga labirinthet e vjetra dhe demoduara dhe avancoi statusin e tyre drejt një pavarësimi më të madh. Shembullin tjetër e kemi rastin e protestave të të rinjve shqiptarë në vitet e fundit të komunizmit në Shqipëri, që solli zëvendësimin e sistemit komunist izolues me sistemin liberal demokrat. Si një ngjarje poashtu eklatante që solli largimin e një diktatori famëkeq kemi rastin e protestave të të rinjve serbë kundër regjimit të Milosheviçit me ç'rast sistemi centralist u shkatërrua nga rinia e atij vendi. Rasti tjetër është protesta e të rinjve kinezë në Peking dhe dalja e një të riu kinez përballë tankut me ç'rast ky akt solli ndërprerjen e derdhjes së mëtutjeshme të gjakut. Mandej Revolucioni Hipik i kryesuar nga të rinjtë në SHBA ndikoi shumë në informimin e opinionit publik amerikanë rreth luftës në Vietnam me ç'rast tre ditë u protestua radhazi me devizën "Bëni paqe e dashuri, e jo luftë". Në këtë protestë treditëshe morën pjesë shumë të rinj amerikan të cilët kritikonin rolin e politikës dhe diplomacisë amerikane në luftën e Vietnamit. Ndërsa, edhe më herët të rinjtë francezë protestonin vazhdimisht kundër luftës së Francës në Indokinë, me ç'rast u formua edhe një grup muzikor i quajtur ***"Le Groupe Indochine" (Grupi Indokinë)*** të cilët kritikoheshin shumë nga të vjetrit e asaj kohe, por ky grup dhe ato që i lartëpërmenda kishin në vete ide liberale dhe progresive që kërkonin diçka të shenjtë, ndalimin e luftës dhe vendosjen e menjëhershme të paqes. Mandej është e paharrueshme edhe kënga e grupit të ri ***"Scorpions"*** e njohur me emrin "Wind of change" e që kërkonte ndryshimin e rendit botëror si dhe rënien e perdes së hekurt, Murit të Berlinit, dëshirë dhe vokacion kjo e cila do të realizohej shumë shpejtë, me ç'rast të rinjtë përmes disidencës do të shkonin fillimisht si turistë në Hungari, mandej në Austri e mandej në Gjermani ku do të ndikonin në prishjen e ***Murit të Berlinit*** dhe rënien e perdes së hekurt. Kësaj do t`i asistonin poashtu edhe protestat e të rinjve nëpër vendet e ndryshme të Evropës Lindore që do të kërkonin prishjen e sistemit komunist dhe vendosjen e rendit demokratik. Këto ishin disa prej pakufi shembujve në të cilën rinia na paraqitet si një motor i ndryshimeve dhe një faktor relevant dhe tejet i rëndësishëm i shoqërisë. Pra shihet se si pa rininë nuk mund të imagjinohej rendi i atëhershëm, i sotshëm, por edhe i ardhshëm botëror. Pjesëmarrja e të rinjve në jetën politike është tejet e rëndësishme, sepse ajo freskon elitën politike, i jep asaj një vitalitet sensibilizues i karakterizuar me një dinamizëm të paparë dhe tejet pozitiv. Andaj duhet marr parasysh se nëse një vendim politik nuk përket me dëshirën dhe vokacionin e rinisë, ajo mandej mund të rebelohet dhe pasojat janë fatale.

Shtetet perëndimore i kanë parasysh gjithë këto gjëra. Andaj në botën perëndimore rinia merret parasysh tepër, ajo ka një akçes të lakmueshëm në jetën shoqërore, politike, kulturore dhe sociale, përderisa në vendet ish-komuniste rinia merret pak parasysh ose merret parasysh, mirëpo vetëm për interesat e më të mëdhenjve. Mirëpo falë kontakteve të ndryshme me rininë evropiane, falë edukimit dhe arsimimit edhe rinia e vendeve ish-komuniste ka filluar të sensibilizohet, vetëdijesohet dhe t`i dëgjohet zëri. Meqenëse gjatë socializmit rinia ishte e indoktrinuar vetëm për interesa ideologjike, ajo shpërtheu, atëherë kur e pa se është e nevojshme dhe kur pa se kushtet janë pjekur për një gjë të tillë. Të rinjtë megjithë kontrollin e rreptë nuk harruan veprimin disident në atë kohë, sepse të veprosh publikisht në atë kohë ishte tejet rrezik. Ato shpërthyen në momentin e duhur dhe rebelimi i tyre ishte i suksesshëm. Por prapë se prapë, parimi recidiv komunist nuk u çrrënjos krejtësisht, sepse siç do të thoshte shkrimtari i famshëm

shqiptar, Dritëro Agolli: ***"Ata që nëpër sheshe gjëmuan nuk janë as në lista, ata që prapa grilave përgjuan u gdhinë ministra".***[18]

Sa i përket Maqedonisë, tranzicioni është i vështirë megjithë përpjekjet për rivendosje të koncepteve të vjetra me koncepte të reja duke tentuar në marrjen parasysh edhe të kërkesave të rinisë. Por ka edhe shumë vështirësi tjera që duhen tejkaluar. Rinia në Maqedoni i ka ndjerë, i ndjen dhe do t`i ndjejë edhe më tej këto konsekuenca, sepse ne jemi trashëguesit e defekteve, të lojërave dhe interesave të ngushta afatshkurta të të vjetërve të asaj kohe. Kësisoj pjesëmarrja e të rinjve në jetën politike nuk është edhe aq e theksuar, sepse këtë nuk e mundëson edhe niveli politik ekonomik, edukativ, kulturor.....Ndërsa një gjë e tillë nuk mund të haset në Slloveni. Sllovenia dhe qeveria sllovene në përbërjen e saj kishte edhe këshillin qeverisës për çështje studentore. Ky këshill ka kontribuar shumë në futjen e sistemit të Bolonjës në sistemin edukativo-arsimor, respektivisht ka ndihmuar tepër në kyçjen aktive të të rinjve në jetën politike në Slloveni. Një gjë e tillë tek ne nuk është ende e pranishme. E vetmja gjë që është e pranishme tek ne është pjesëmarrja e të rinjve në jetën partiake si militantë partiakë. Kjo i bien thënë troç si instrumente, si robotë, apo si marioneta e posaçërisht gjatë periudhës para zgjedhjeve, sepse ato obligohen për shkak të elanit dhe vitalitetit që kanë në bërjen e fushatës propaganduese politike të partive politike. Ky organizim organizohet në mënyrë ***"perfekte"*** nga ana e forumeve të partive politike me ç'rast trajnohen të rinjtë që të punojnë çdoherë si marioneta dhe të varur nga të mëdhenjtë, e kurrsesi nuk vjen në shprehje vitaliteti dhe kreativiteti i rinisë për të qenë autonom dhe për të kontribuar sadopak për një përmirësim në drejtim pozitiv. Andaj, si të zgjidhet ky problem?

Sipas mendimit tim, të rinjtë në Maqedoni duhet të angazhohen t`i vendosin dhe forcojnë kontaktet me të rinjtë e botës perëndimore, përmes intensifikimit të raporteve, angazhimeve të ndryshme nëpër seminare rinore, forume rinore, konferenca të ndryshme dhe çdoherë duke iu shmangur oportunizmit dhe abuzimit nga të tjerët. Kësisoj do t`i shmangemi në të ardhmen rolit të të qenit figurë apo lider historik dhe do të sigurojmë vijimësi dhe do të jemi model për gjeneratat që do të vijnë pas. Përmes një angazhimi të mirëfilltë dhe produktiv në të ardhmen do të shërbejmë si kuadro të formuara mirë me gjasë që të shfaqemi me sukses aty ku do të na kërkohet dhe ku duhet të jemi. Besoj se edhe tek ne nocioni "politikë" do të kuptohet si një proces për të favorizuar shoqërinë, e jo për të gjetur një vend pune dhe për të pohuar dhe u pajtuar me çdo vendim politik që merret nga lartë, qoftë ai pozitiv, apo negativ. Pjesëmarrja e të rinjve në jetën politike, shoqërore, kulturore, sociale...., do të shmangte kontaktin e të rinjve me drogën dhe me dukuritë dhe fenomenet tjera negative. Rinia duhet të kuptojë se shumë lehtë mund të bëhen pre e kurtheve të të rriturve dhe kësisoj të instrumentalizohen. Për këtë arsye sot na duhet një rini e kompletuar si duhet, e formuar, e shkolluar, krahas trendëve epokale-botërore. Andaj, të mos bëhemi pre e abuzimeve të ndryshme. Të kyçemi edhe ne në jetën politike, sepse duhet të kuptojmë se pa ne bota nuk ka perspektivë dhe të ardhme. Jemi pjesë e shoqërisë së dijes, shoqërisë postmoderne, postpozitiviste. Jemi lehtë të adaptueshëm ndaj ndryshimeve, jemi vetë protagonistë të ndryshimeve, të cilët nuk mund të bëhen pa pjesëmarrjen tonë. Kësisoj roli i ynë në shoqëri dhe në vendimet e ndryshme të nivelit lokal, rajonal, nacional dhe internacional do të ishte tejet i rëndësishëm, e posaçërisht në krijimin e parlamenteve reprezentative të të rinjve. Përfaqësojmë 30- 35 % të popullatës së përgjithshme botërore. Duke i pasur parasysh dy gjëra kryesore, atë që

[18] Danaj, Koço, 50 Vjet histori e pahumbur, Zëri i Kosovës, Zvicër, 2005, fq. 124

jemi në numër të shumtë si dhe jemi forcë ndryshuese me perspektivë, mendoj se ia vlen që të mos qëndrojmë duarkryq, por të mobilizohemi dhe të lëvizim.

Që rinia të marrë pjesë aktivisht në jetën politike të një vendi duhet që qeveritë e ndryshme, por edhe kjo e jona të:

1. **promovojnë aktivisht pjesëmarrjen e të rinjve drejt krijimit të parlamenteve reprezentative të të rinjve në nivele të ndryshme lokale, rajonale, nacionale dhe ndërkombëtare**
2. **njohin dhe pranojnë rolin e rëndësishëm të asociacioneve dhe organizatave të të rinjve në promovimin e pjesëmarrjes së të rinjve në segmente të ndryshme të jetës shoqërore**
3. **favorizojnë mundësitë e kooperimit dhe pjesëmarrjes së hapur të të gjithë të rinjve përmes asociacioneve, organizmave dhe shoqatave të ndryshme rinore**
4. **t`i bëjnë të rinjtë të kujdesshëm dhe të vëmendshëm përballë proceseve politike, por gjithashtu edhe t`i transmetojnë idetë e të rinjve në politikën e përditshme, si dhe të ameliorojnë (përmirësojnë) dialogun në mes brezave (gjeneratave).**

Tetovë, 03 mars 2005

(MAQEDONI)

MAQEDONIA- FEMËR E VESHUR DERI NË FYT, POR ME POLITIKË AVENTURIERE

Edhe sot e kësaj dite është befasues fakti se si ky shtet i vogël, i cili kontestohet edhe sot e kësaj dite në të gjitha aspektet, të vazhdojë të mos e përfillë faktin se Kosova është shtet i pavarur. Është edhe më befasuese qëndrimi i saj anashkalues ndaj faktorit shqiptar në Maqedoni, duke e neglizhuar atë dhe duke mos u vënë veshin partive politike shqiptare për njohje sa më të shpejtë të pavarësisë së Kosovës. Por, ajo që më shqetëson më së shumti është tentativa e kryeministrit aktual dhe e shtetarëve aktual të cilët tentojnë të paraqiten si faktorë tejet të rëndësishëm në Ballkan dhe vazhdimisht prolongojnë njohjen e shtetësisë së Kosovës me lloj-lloj arsyetime se gjoja këtë e bëjnë duke u nisur nga fakti i interesave shtetërore dhe kombëtare. *Si mund të shpjegohet kjo gjë?* ***Aspekti i parë:*** Politikanët e sotshëm maqedonas dhe shtetarët aktual vazhdimisht trumbetojnë se interes shtetëror dhe kombëtar kanë futjen e Maqedonisë në familjen e demokracive të konsoliduar, ndërsa e harrojnë faktin se thuajse të gjitha ato shtete që disponojnë me një demokraci të tillë dhe të qëndrueshme, kanë pranuar pavarësinë e Kosovës, ndërsa Maqedonia ka ngecur në raport me to. Pra, janë gjepura përpjekjet maqedonase për t`u bërë pjesë e shteteve me një demokraci të qëndrueshme dhe të konsoliduar, sepse pikërisht është po ky shtet, i cili injoron faktin se shtetet demokratike kanë pranuar moti shtetësinë e Kosovës dhe kanë vendosur kontakte diplomatike me Kosovën. ***Aspekti i dytë:*** Njëra prej parimeve për tu bërë pjesë e strukturave euro-atlantike është edhe ndërtimi i raporteve të mira ndërfqinjësore. Dilema rreth asaj se sa Maqedonia ndërton raporte të mira me fqinjët është tejet e qartë. Në fakt nuk ka edhe dilemë. Ajo shihet. Ndërtimi i raporteve të mira me fqinjët është ende larg, për arsye se kur ti injoron komshiun tënd, atëherë nuk mund të ndërtosh raporte të mira me të. Një fjalë e urtë thotë : ***"Nuk blej shpi, por blej komshi".*** Maqedonia leje qe nuk din se si të blejë apo si ta ruajë shtëpinë e saj, por edhe provokon fqinjët e saj vazhdimisht me mosnjohje dhe me kushtëzime absurde. Ndërsa, harron faktin se nuk ka as shtëpinë e saj. Ajo shtëpi është e improvizuar dhe e kontestuar nga të gjithë fqinjët. ***Aspekti i tretë:*** Maqedonia krekoset vazhdimisht se është bastion i demokracisë dhe i multikulturalizmit, i respektit të ndërsjellë në mes të gjithë qytetarëve të saj. Por, pikërisht ky shtet shkel fort parimin e vetëvendosjes (selfdetermination) i vendosur si parim nga ish-presidenti amerikan, Wilson, përmes mosnjohjes së shtetësisë së Kosovës. Pra, shkel rëndë një parim demokratik, i cili është tejet i rëndësishëm, për t`u bërë pjesë e shteteve me demokraci të mirëfilltë. Shkel dëshirën dhe vokacionet e qytetarëve të saj shqiptarë për një njohje sa më të shpejtë të Kosovës. Shkel vullnetin amerikan dhe evropian. ***Aspekti i katërt:*** Maqedonia nuk përfill vokacionet e shqiptarëve dhe ndërkombëtarëve. Sugjerimet permanente të ndërkombëtarëve kanë qenë dhe janë në drejtim të njohjes së pavarësisë së Kosovës. Poashtu edhe sugjerimet e faktorit politik shqiptar. Por, çfarë bën Maqedonia? Me sytë kinse kah Evropa dhe Amerika, e me mendjen prapa kah Serbia, Rusia dhe shtetet e tjera me një demokraci të brishtë, me një sistem kuazi-demokratik dhe me destabilitete të brendshme, ajo ndjek, fatkeqësisht hapat e shteteve të fundit, shteteve të cilët, mjerisht e dinë se çfarë janë, por nuk dinë se çfarë do të bëhen. Maqedonia duhet ta kujtojë të kaluarën, sepse përndryshe mund ajo e kaluar t`i përsëritet. E ajo është zhytja

në një konflikt dhe destabilitet me përmasa më të mëdha dhe më fatkeqe për këtë shtet. ***Aspekti i pestë:*** Ky shtet kontestohet nga bullgarët për shkak të gjuhës, kontestohet nga serbët për shkak të kishës, kontestohet edhe më shumë dhe me të drejtë nga grekët për shkak të emrit, ishte i vetmi shtet i cili u pranua dhe u njoh ndër të parat nga Shqipëria dhe nga Kosova, fill pas pavarësimit. Maqedonia "e ka harruar" këtë fakt. Shtetarët maqedonas duhet të jenë koshient për thënien ***:"Nuk mund të jetosh me të ardhmen normalisht, nëse e kaluara të bëhet mjegull, nuk merr vesh se ku ke qenë".*** Ajo duhet ta dijë se shqiptarët ishin të parët që u ngutën ta pranojnë këtë shtet të kontestuar vazhdimisht. ***Aspekti i gjashtë:*** Maqedonasit dhe shtetarët maqedonas deklarojnë vazhdimisht se janë pasardhësit e Aleksandërit të Madh, apo siç citojnë ata *"Aleksandër Veliki",* a as unë, as askush prej shqiptarëve nuk arritëm të kuptojmë se përse përdoret mbiemri "Veliki" (mbiemër serb), ndërsa pohojnë se janë popullsi sllave. Po si mund të kesh lidhje me Aleksandërin e Madh, ndërsa të jesh popullsi sllave, kur dihet se sllavët janë shpërngulur prej Karpateve dhe kanë ardhur në Ballkan në shek. VI-VII e.r., ndërsa epoka e Aleksandërit të Madh është shumë shekuj para shpërnguljes së tyre në Ballkan apo ardhjes së tyre në Ballkan! Me gjithë këto aspekte të numëruara dhe shumë tjera, Maqedonia më duket padyshim se ngjason në atë femrën e cila edhe pse e veshur deri në fyt, ka shikimet e një prostitute, sepse ushtron në vazhdimësi politikë aventuriere, është e veshur mjaft me gjepura, kinse synon të bëhet pjesë e familjeve evropiane dhe amerikane, e në tjetrën anë shikimet e një prostitute tipike i ka të drejtuara drejt popujve vëllezër rus dhe serb. Maqedonia siç citohet një filozof duke tentuar kinse të pastrojë të kaluarën, turbullon çdoherë e më shumë të ardhmen e saj. Ky shtet duhet të kuptojë njëherë e përgjithmonë se varet nga shqiptarët e Maqedonisë, të cilët kanë pasur me shekuj dëshirën e zjarrtë për pavarësi të Kosovës. Andaj, nuk mund të bëhet kinse e shurdhër ndaj kërkesave për njohje të Kosovës nga shqiptarët, sepse nuk mund ta gëzojë këtë privilegj. Ekzistenca e këtij shteti varet pikërisht nga dëshira dhe vullneti i shqiptarëve. Ajo është e rrethuar në tri anë me shqiptarë. Me Kosovën, me Shqipërinë dhe me shqiptarët e Luginës së Preshevës. Përpos kësaj ka përbrenda vet faktorin shqiptar, i cili është mjaft relevant dhe faktorizues. Pra, varet skajshmërisht nga shqiptarët. Nëse do të mbijetojë si shtet, duhet të ketë vizion. Sepse vizioni është fuqia më e madhe që mund ta posedojë ndokush. Ai jep fuqi dhe kontinuitet zhvillimit gjatë shekujve, mundëson shikimin në ardhmëri dhe i jep formë të panjohurës. Përndryshe pa vizion bëhesh kollaj i (e) panjohur. Për në fund një porosi për kryeministrin: ***"z. Gruevski dhe shtetarë maqedonë mund të keni shoqe fantazinë, por si udhëheqëse duhet të keni arsyen. Ajo është më e fortë se shpata. Por, mos justifikoni dhe përdorni "arsyen" e juaj shtetërore për zvarritje të njohjes së Kosovës, sepse është mjaft tmerruese të jesh i arsyeshëm atje ku arsyeja është absurde, e pakapshme, e pakuptimtë, ose nuk ekziston si e tillë".***

Kumanovë, 2 tetor 2008

Pjesa e dytë

(FRANCË)

SISTEMI I VERSAJËS

Shekulli XX është quajtur si shekulli i vdekjeve të mëdha në historinë e njerëzimit.[19] Asnjëherë më parë nuk ishin parë shkatërrime të përmasave të tilla. Në të gjithë shekullin XX, e veçanërisht në gjysmën e parë të tij, vdekjet masive të njerëzve i dhanë këtij shekulli nofkën famëkeqe "shekulli i vdekjeve, apo vdekjeve të mëdha". Aq e vërtetë është kjo, saqë shumë studiues, politikanë dhe diplomatë të njohur janë shprehur se po ta kishin ditur se çfarë kishte për të ndodhur në shekullin XX, do të kishin preferuar të mos kishin lindur fare. Kontinenti evropian është një kontinent i njohur për luftëra dhe shkatërrime. Gjatë gjithë historisë politike të Evropës, luftërat kanë qenë buka e përditshme e politikanëve dhe ushtarakëve deri në gjysmën e dytë të shekullit XX. Lufta më e madhe që kishte njohur Evropa kishte qenë Lufta 30-vjeçare që kishte çuar në Sistemin e Vestfalisë të krijuar nga Risheljeja, më pas kishin qenë luftërat napoleoniane që kishin çuar në krijimin e ***Koncertit të Evropës të krijuar nga Meterniku,*** dhe tani një tjetër sistem do të lindte në Evropë për të marrë fund si dy të parët, por me pasoja shumë më tepër sesa dramatike, ***Sistemi i Versajës.*** Rruga për të ardhur deri tek sistemi i Versajës ishte e gjatë dhe e dhunshme. Rruga që çoi në atë sistem ishte pasoja e bashkimit të Gjermanisë në një shtet të vetëm për herë të parë në historinë e Kombit Gjerman. Por edhe pse bashkimi i Gjermanisë ishte një ngjarje historike për popullin gjerman, rezultoi se nuk do të ishte e tillë për popujt e Evropës. Dhe kjo për një arsye shumë të thjeshtë. Gjermania që në ditën e krijimit të saj si shtet nuk kishte eksperiencën shtet-formuese që kishin Britania e Madhe, Franca, Rusia dhe shtetet e tjera të Evropës. Aq e vërtetë është kjo, saqë shumë politikanë dhe diplomatë gjermanë do të shpreheshin pas paqes së Versajës, se "ne krijuam diçka të patrashëguar më parë, duke mos ditur se çfarë po krijonim". E drejta për vetëvendosje është një e drejtë që e kanë dhe duhet ta kenë të gjithë popujt e botës. Do të ishte krejtësisht e pafalshme për kombet e Evropës që të vazhdonin të pengonin bashkimin e Gjermanisë në fund të shekullit të XIX. Puna është se tani politikat e vjetra evropiane po ia linin vendin filozofive dhe doktrinave të reja. Dhe filozofia e re në të cilën u mbështet shteti i ri gjerman ishte filozofia e forcës. Shumë shtete të Evropës në të kaluarën ishin mbështetur tek kjo filozofi, por shekulli XX ishte një shekull kur shtetet e vjetra të Evropës i kishin kaluar provat e tyre të hekurit dhe të zjarrit, për t'ju nënshtruar arsyes dhe vetëpërmbajtjes. Sigurisht që shtetet e Evropës me eksperiencën e tyre politike dhe diplomatike kërkonin që t'i impononinbotës idetë e vetëpërmbajtjes, edhe pse më parë u kishin imponuar idetë e forcës. Por llogaritë nuk ishin kryer ashtu siç duhet. Bashkimi i Gjermanisë do të sillte prishjen e ekuilibrit në Evropë të ndërtuar dhe të mbajtur me aq kujdes nga shtetarët evropianë. Gjermania e re nuk mund ta pranonte që të kishte popullsi më shumë se çdo shtet evropian dhe të ishte e parëndësishme në arenën ndërkombëtare. Ethet e saj për pushtime, Gjermania i shprehu qysh në fillim të shekullit XX duke lënë pas dore aleancat tradicionale evropiane, të cilat do t'i kushtonin shumë shtrenjtë asaj dhe Evropës. Gara shfrenuar për armatim, futja e teknologjive të reja ushtarake dhe mbi të gjitha ambicia gjermane për dominim, do të

[19] Boriçi, Gjon, Op.cit.fq. 85

ishin faktorët bazë që çuan në shpërthimin e Luftës I Botërore. Dhe lufta do të ishte shembja e të gjitha ëndrrave për të arritur lavdinë në fushën e betejës. Koalicioni që kancelari Bismark në çastin e bashkimit të Gjermanisë kishte arritur me mjeshtëri ta mbante të izoluar, kancelarët e tjerë gjermanë arritën ta kthenin kundër tyre për t`u bërë pjesë e sulmeve të pamëshirshme që ofron një izolim i tillë dhe një armiqësi nga të katra anët. Demokracitë evropiane dhe botërore (SHBA) arritën të fitojnë dhe të mundin me vështirësi të madhe në Luftën I një Gjermani të fuqishme që thuajse e vetme i kishte bërë ballë koalicionit të ngritur kundër saj dhe arritën të fitojnë, por pa e dobësuar atë. Dhe aq e vërtetë është kjo, saqë fituesit e Luftës i lejuan vetes të bënin gabimin që as Rishëlje dhe as Meterniku nuk do ta kishin bërë, për të fituar mbi një kundërshtar dhe pastaj ta fyenin atë. Pikërisht këtë bënë fuqitë fituese të luftës. Ata e mundën Gjermaninë dhe më pas i diktuan një paqe të turpshme që vetëm sa shtynte për njëzet vjet katastrofën më të madhe të njerëzimit në historinë e tij.

Sistemi (paqja) i (e) Versajës nuk ishte asgjë më shumë sesa një farsë diplomatike e krijuar sipas një stili tejet të varfër politik. Gjermania kurrsesi nuk mund të pranonte të kthehej edhe një herë në një fushëbetejë evropiane dhe kjo kishte arsyet e veta. Gjatë gjithë historisë së luftërave në Evropë, Gjermania ishte as më shumë e as më pak sesa një fushë-betejë ku rivalizonin monarkitë më të njohura të Evropës. Ndjenja për t`u bërë pjesë e pazareve evropiane çoi në bashkimin e Gjermanisë dhe në prishjen e ekuilibrit evropian. Evropa gjatë gjithë gjysmës së parë të shekullit XX nuk do të ishte e sigurt dhe shkatërrime të pamasa do të shpinin kontinentin e vjetër të kulturës dhe të civilizimit modern drejt një katastrofe të përgjithshme. Sistemi i Versajës nuk bëri asgjë për të parandaluar katastrofën e Luftës II, por arriti të mbante paqen e Evropës për 20 vjet. Por çfarë bëri për shqiptarët? Vulosi ndarjen e tyre në pesë shtete, fragmentarizëm të paparë, mbolli urrejtje në mes kombeve në Ballkan, solli vendime fatkeqe në disvafor të kombit shqiptar dhe pasojat edhe sot e kësaj dite po i vuajmë. Andaj, ky Sistem duhet të rishikohet dhe të revidohet dhe në shprehje të vjen sistemi i shteteve kombe sipas territoreve etnike si dhe sipas së drejtës për vetëvendosje ***(selfdetermination),*** principi më i pranuar dhe më i duhuri për zgjidhjen e problemeve në Ballkanin e trazuar prej nacionalizmave dhe ksenofobive.

Kumanovë, 28 shkurt 2009

FRANCA PROMOTORE E INTERESAVE TË SAJA KOMBËTARE DHE EVROPIANIZIMIT

Franca, ky shtet me 63,7 milionë banorë,[20] shtet i kulturës dhe i traditës, i aristokracisë, revolucioneve, ndryshimeve, progresit, padyshim se ka impakte të veçanta në historinë e rrugëtimit evropian, por edhe në atë botëror. Shtet me një politikë dhe diplomaci të fuqishme, me strategji të suksesshme në marrëdhëniet ndërkombëtare, mbetet i vetmi shtet në botë që arriti të imponohet apo të pozicionohet në arenën ndërkombëtare përmes kulturës. Edhe sot e kësaj dite ndarja e buxhetit në Francë bëhet në atë mënyrë që vendin parësor e zë kultura, e cila arriti ta nxjerrë në sipërfaqe këtë shtet në arenën ndërkombëtare. Tentativa e saj për pozicionim në marrëdhëniet ndërkombëtare kishte filluar shumë më herët, por ajo kulmoi me Paqen e Vestfalisë. Gjithçka për Francën fillon aty. Në rrafshin ndërkombëtar ajo do të reflektojë përmes kësaj paqe. E aq më shumë në rrafshin evropian. Franca, si asnjë shtet tjetër evropian është shquar dhe dalluar për zgjuarsi dhe vigjilencë. Përkrahëse e politikës proevropiane ajo do të forcohej dhe pozicionohej gjithnjë e më tepër, falë kokave të mençura, që e drejtuan atë. Ishin pikërisht ***Zhan Mone dhe Robert Shuman*** që paraqitën idenë e tyre proevropianiste me synim pozicionimin e Francës në Evropë dhe vendosjen e saj përsëri në qendër të vëmendjes. Pikërisht, synimi proevropianist i Francës me objektivin konspirativ "***La Grande Nation" (Kombi i Madh),*** ëndërr ***e Rishëljes, Napoleonit, Robespierit, Dantonit, Marës, De Taleranit*** e shumë e shumë burrështetasve të tjerë, do të mishërohej me sukses, por kuptohet në formë të integrimit dhe në trajtë të ekspozimit panintegrues me shtetin me të cilin kishte qenë çdoherë në mosmarrëveshje me Gjermaninë. Pikërisht më 9 maj 1950, ministri i famshëm francez i Punëve të Jashtme, ***Robert Shuman***, do t`i ofrojë Evropës alternativën e bashkimit, unifikimit apo më mirë të themi të integrimit. Thënë troç Shuman do të ishte realizuesi, apo zbatuesi i asaj ëndrre të vjetër shekullore evropiane për bashkim ose integrim, Evropën e Bashkuar, ëndërr kjo e ***Kalergit, Viktor Hygosë, Dybuasë, Prudonit, Briandit, Monesë.*** Pra, ishte diplomacia franceze ajo që nxiti Evropën për bashkim dhe lënien anash të ksenofobive raciste, doktrinave famëkeqe shfarosëse. Në prill të vitit 1951 u nënshkrua Traktati i Parisit, ku politikat antagoniste do të fundoseshin përfundimisht. Dy kombet, tmerrësisht të armiqësuar me njëri-tjetrin, do të fillonin intensifikimin e marrëdhënieve dypalëshe, fillimisht me integrim ekonomik, përmes krijimit të Komunitetit Evropian për Thëngjill dhe Çelik. Pra, ishte politika franceze ajo që nxiti dhe promovoi Evropën e Bashkuar, ide kjo e ***Zhan Monesë, ish-sekretar i Lidhjes së Kombeve*** dhe e realizuar nga Robert Shuman, ministër i Jashtëm francez. Pra, edhe këtu doli në pah prirja institucionale franceze. Pozicionimi i shkëlqyer i Francës dhe promovimi i politikës proevropianiste do të ishte thelbi i suksesit për lënien e ndasive anash. Mjeshtëria e rrallë e diplomacisë franceze u duk kur pikërisht Franca i zgjati dorën për pajtim popullit gjerman nga ana e Shumanit drejtuar kancelarit gjerman, Konrad Adenauer. Me këtë u dëshmua edhe njëherë se Franca dhe francezët ishin mjeshtër të kalkulimit dhe futuristë brilant të politikave, si dhe njëkohësisht nismëtarë të shkëlqyer, me prirje jashtëzakonisht institucionale. Politika franceze, e cila mund të konsiderohet nga shumëkush si dhelparake, është mjaft e sofistikuar, por njëkohësisht edhe tejet e suksesshme. E mbështetur çdoherë në idealet e Deklaratës të së Drejtave të Njeriut që nga koha e

[20] http://fr.wikipedia.org/wiki/Chiffres_de_population_en_France

Revolucionit Francez, në fuqinë e vjetër koloniale, Franca ka treguar dhe ka pasur çdoherë ndikim në çështjet e ndryshme botërore. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut më 1948, bazën burimore dhe orientuese e ka nga ***Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarëve*** e promovuar gjatë ***Revolucionit Borgjez Francez.*** Pra, shihet se si një deklaratë mjaft e rëndësishme e merr trajtën nga Deklarata Franceze e lansuar shumë kohë më parë. Franca duke kuptuar dhe ruajtur njëkohësisht principet e mëdha republikane të lirisë, barazisë dhe vëllazërisë ***(Liberté, Egalité et Fraternité)***[21] do të kishte ndikimin e saj tek çdo organizatë tjetër, që do të formohej dhe do të luante njëkohësisht edhe rol parësor në to. Ideja e iniciuar nga ***Mone dhe Shuman*** ishte rrugë mjaft e suksesshme në politikën e jashtme e më konkretisht në Komunitetin Evropian të asaj kohe, të cilit i ishin bashkëngjitur përveç Gjermanisë edhe 10 shtete të tjera. Por, funksioni i BE-së së sotme që në atë kohë emërtohej ndryshe u bllokua në shumë raste nga burrështetasi francez, siç ishte rasti me Charles de Gaulle, edhe atë me arsyetimin për interesa kombëtare. Rasti i njëjtë është edhe sot me refuzimin e Turqisë për kyçje në UE. Por, sidoqoftë, Franca me politikën e saj u shpall si triumfaliste, sepse me zgjatjen e dorës për pajtim Gjermanisë së Adenauerit do të bëhej boshti i interesave komplekse evropiane. E promovuar njëkohësisht si nismëtare e proevropianizmit, ajo do të përqasej gjatë periudhës goliste ndaj një politike antiamerikane dhe antiangleze. Luajtja e politikës me dy teha nga pala franceze në konfiguracionin e Evropës së atëhershme do të pengonte shumë Britaninë e Madhe të hynte në familjen e vjetër evropiane. De Gol përmes thënies perfide ***"Le chef c`est moi"*** duke e luajtur me një mjeshtëri të rrallë lojën përmes karriges boshe e njohur kjo në fjalorin evropian, që simbolizonte karrigen boshe të Britanisë së Madhe për në UE, do ta radhiste Francën në grupin e shteteve vendimtare për fatet e mëdha, sepse të bllokohej Britania në atë kohë ishte me të vërtetë diçka e madhe, kur dihet se impakti amerikan dhe britanez ishte tejet i theksuar në Evropë. De Gol e dinte shumë mirë që me hyrjen e Britanisë së Madhe në Komunitetin e Bashkuar Evropian, roli i Francës do të venitej tej mase, dhe se ndarja e përgjegjësive me Britaninë nuk i shkonte për shtati Francës. Ajo kërkonte të luante ende rolin dominues. Dhe e luajti me sukses. Mund të themi se Franca ka pasur ndikim të madh dhe impakte të veçanta në marrëdhëniet evropiane dhe ndërkombëtare duke qenë çdoherë në fokus, si dhe është konsoliduar me sukses përmes pozicionimeve të saja proevropianiste. Konstruksioni evropian gjatë asaj kohe sillej ende rreth politikës së jashtme franceze, që prej fillimit, e gjer më 1973. Mirëpo, konstruksioni evropian nuk do të ngelej i tillë. Ai do të ndryshojë më 1973, kur në familjen evropiane do të pranohej Britania e Madhe, Irlanda, Danimarka. Dhe pse mos ta themi, një gjë e tillë u bë e mundur vetëm kur Franca e pranoi këtë hap. Sepse deri në atë kohë vetoja e gjeneralit de Gol nuk i kishte lejuar akçes tre shteteve të lartpërmendura. Stili autoritar golist pretendonte si çdoherë vazhdim të ëndrrës së vjetër franceze të Napoleonit me Francën në qendër të Evropës përmes devizës ***"Honneur et patrie, voici la France" (Nder dhe atdhe, kjo është Franca).***[22] Gjatë epokës goliane Franca pengonte ndikimin anglez dhe në këtë mënyrë edhe atë amerikan në Komunitetin Evropian për disa arsye, por ajo që mund të hetohet lehtë është arsyeja që De Gol i jep presidentit amerikan, Nikson, gjatë takimit të tyre tête-à-tête kur i thotë : ***"Nuk jam një antiamerikan, por një profrancez, ndaj shfrytëzoj të drejtën time për të kontestuar, sepse nëse nuk kontestoj unë, nuk jam aleat, por protektorat."*** Gjithë këtë elaborat e

[21] Deviza e shtetit francez e promovuar gjatë Revolucionit Borgjez Francez, shën. i autorit
[22] http://www.legiondhonneur.fr/

bëra me një qëllim të vetëm: Për interesat kombëtare duhet të kontestohen shpesh herë edhe interesat që në dukje mund të duken ndërkombëtare.

Kumanovë, 13 prill 2009

FRANKOFONIA DHE UDHËTIMI I SAJ NËPËR KOHË

Është më se e qartë se çelësi i suksesit të një kombi është konvertimi i gjuhës kombëtare në gjuhë ndërkombëtare. Pse? Sepse atëherë kur arrihet kjo, një komb i tillë ka arritur të përçojë vlera, të jetë i vijueshëm dhe të reflektojë në botën shumëlaterale. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për kombin francez dhe gjuhën frënge. Ky komb i madh, me ideale të pavdekshme demokratike, revolucionare, arriti që të konvertojë përmes udhëheqësve të mëdhenj gjuhën kombëtare në gjuhë ndërkombëtare. Pikërisht, kjo gjë u arrit më Paqen e Wesfalisë së vitit 1648, atëherë kur gjuha frënge u bë gjuhë e diplomacisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, si dhe kulmoi me Frankofoninë. Po shtrohet pyetje se ç`është Frankofonia? Për të deshifruar këtë term, nisemi nga shkoqitja e termit frankofon. Frankofon quhet një person i cili flet frëngjisht. Kjo vjen nga frëngjishtja, ***franco-français, phonie-entendre/ecouter.*** Pra, të kuptosh frëngjisht, të dëgjosh, si dhe njëkohësisht të flasësh frëngjisht. Ndërsa **frankofonia** si term më i gjerë përfshin të gjithë frëngjishtfolësit, të cilët nuk e kanë gjuhë amtare gjuhën frënge ose nuk janë francezë nativ, por që flasin gjuhën frënge dhe ndajnë vlerat e kulturës franceze. Termi "Frankofoni" për së pari herë haset më 1880, edhe atë për të përshkruar hapësirën gjeografike ku flitej kjo gjuhë. Është përdorur për së pari herë nga gjeografi i famshëm francez, ***Onezim Rekly, (Onesime Reclus).***[23] Ndërsa sot termi "**frankofoni"** simbolizon popujt ose grupet e folësve të cilët përdorin pjesërisht ose krejtësisht gjuhën frënge në jetën e tyre të përditshme ose në komunikim. Frankofonia përfaqëson njashtu edhe qeveritë, vendet ose instancat zyrtare, të cilët përdorin gjuhën frënge. Pra, flitet për dy realitete, sipas asaj që ne shkruajmë frankofoni (popujt ose folësit) dhe Frankofoni (qeveritë dhe shtetet). Këtij realiteti do t`i ndihmonte më tutje edhe thënia e famshme e Rivarolit mbi universalitetin e gjuhës frënge të vitit 1884, sipas të cilit: "Ajo që nuk ishte e qartë, me siguri nuk mund të ishte franceze. Me këtë Rivarol poashtu tentoi që të përshkruaj gjuhën frënge si gjuhë sublime ndërkombëtare me peshë jashtëzakonisht të madhe, dhe lëshoi një mesazh të fortë, i cili lexohet përmes rreshtave për një shpërndarje sa më të madhe të gjuhës frënge në nivel ndërkombëtar. Pas një pushimi të gjatë, termi Frankofoni do të kthehej përsëri për të mos vdekur kurrë më vitin 1962. Kësaj i paraprijnë një sërë aktivitetesh gjithëpërfshirëse për të sensibilizuar dhe mobilizuar institucionet e ndryshme, dhe shtetet e ndryshme për nevojën e formimit të një Organizate e cila do të rigruponte shtetet dhe popujt frëngjishtfolës. Kësisoj, duke u bazuar në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, të vitit 1948, Deklaratë kjo e cila e ka bazamentin në Deklaratën për të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarët e vitit 1789, si dhe buron nga Revolucioni i famshëm Borgjez Francez, u formua një ***Asociacion Ndërkombëtar i Gazetarëve Francez më 1952.*** Ky asociacion ishte si uverturë e asaj qe më vonë do të institucionalizohej në Organizatë Ndërkombëtare të Frankofonisë. Kësaj të fundit i parapriu poashtu, edhe krijimi i unionit francez më 1946, me ç'rast vendet që

[23] http://www.ladocumentationfrancaise.fr/dossiers/francophonie/onesime-reclus.shtml

ishin koloni franceze fituan autonomi. Nismat nuk u ndalën me kaq. ***Më 1954 krijohet Unioni Kulturor Francez i krijuar nga ana e kanadezëve frankofon. Pra, përmasat e gjuhës frënge ishin tejkontinentale. Më 1958 kemi dy ngjarje të rëndësishme, krijimin e Komunitetit Francez, si dhe krijimin e Asociacionit të sociologëve francezë, poashtu në Kanada. Ky sensibilizim nga ana e kanadezëve frëngjishtfolës, i krijoi hapësirë Parisit që të angazhohet për krijimin e Asociacionit Ndërkombëtar për Kulturë Franceze për shtetet e jashtme, gjë e cila u bë realitet më 1960. Më 1961, nga ana e kanadezëve krijohet Asociacioni i Universiteteve Frëngjishtfolëse (AUPELF),*** e cila shërbeu si një ***revindikacion*** për vazhdimin e mëtutjeshëm të institucionalizimit të gjuhës frënge. Njëkohësisht në këtë kohë me insistim të Parisit zyrtar krijohet edhe Ministria e Kooperimit, e cila do të angazhohej për një bashkëpunim me shtetet që do të ndanin vlerat e gjuhës frënge gjetiu. Në këtë vit në kontinentin afrikan, poashtu kemi aktivitete të ndryshme, siç mund të përmendet këtu krijimi i; ***Unionit afrikan dhe Malgash,*** i cili më 1966 do të transformohej në Organizatën e përbashkët Afrikane dhe Malgashe. Ndërsa më 1970 krijohet Agjencia e Kooperimit Kulturor dhe Teknik, krijohet TV5 Evropa, më vonë TV5 Monde (Bota), e deri më 1997 me ç'rast zgjidhet për së pari herë sekretari gjeneral i kësaj Organizate, z. Butros Butros Gali. Ky ishte pra, si hap i fundit i sensibilizimit dhe krijimi të asaj që quhet sot Organizatë Ndërkombëtare Frankofone, e cila përbëhet nga 53 shtete frëngjishtfolëse, nga 3 anëtarë të asocuar dhe katër anëtarë vëzhgues, si dhe me një numër gjigant prej 200 milionë frëngjishtfolësve. Më 1998 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara i jep të drejtën apo statusin e vëzhguesit OIF (Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë). Kjo Organizatë me një buxhet vjetor prej 180 milion eurosh, me një organigramë tejet të konsoliduar, ka 600 persona që punojnë për të. Kjo Organizatë ka poashtu katër përfaqësues permanent të OKB-së në Gjenevë, ka përfaqësues në Unionin Evropian në Bruksel, dhe në disa sërë organizatash tjera rajonale. Shtetet frankofone në përgjithësi kanë një të kaluar të përbashkët me Francën, por ata gjithashtu kanë edhe objektiva të përbashkëta për të ardhmen siç janë: zhvillimi i demokracisë, përkrahja e të drejtave të njeriut, dialogimi mes kulturave dhe civilizimeve, zhvillimi ekonomik. Këto shtete kanë lidhje të veçanta me Francën përmes organizmave zyrtarë siç janë Agjencia Ndërqeveritare e Frankofonisë, përmes manifestimeve të ndryshme siç janë Samitet e Frankofonisë, Dita Ndërkombëtare e Frankofonisë, si dhe shumë iniciativa tjera në nivel lokal. Sot termi "frankofoni" ka shumë kuptime, por mbi të gjitha ka kuptimin linguistik (ai që flet frëngjisht), kuptimin gjeografik (shtete apo popujt që flasin gjuhën frënge si gjuhë zyrtare, amtare, përditshmërisë, administrative), kuptimin spiritual (ndjenja për të qenë me një komunitet dhe një solidaritet për të ndarë vlera të përbashkëta), si dhe kuptimi institucional (një komunitet i organizuar institucionalisht me një bashkëpunim të madh). Kooperimi i këtillë i mundësoi gjuhës frënge që të flitet në pesë kontinente, si dhe të ketë statusin e ***gjuhës amtare (Francë, Belgjikë, Zvicër, Luksemburg, Monako, Andorrë dhe Kebek), gjuhë zyrtare (Benin, Burkina Faso, Kongo, Bregu i Fildishtë, Gabon, Guine, Mali, Nigeri, Senegal, Togo, Kanada, Burundi, Kamerun, ishujt Komore, Xhibuti, Madagaskar, Marok, Mauritani, Ruandë, Seshel, Tunis, Republika Demokratike e Kongos), gjuhë e mësimdhënies dhe sistemit edukativ*** (***Algjeri, gadishullin e Indokinës, Amerikën e Jugut).*** Statusi i gjuhës frënge është i kënaqshëm edhe në Maqedoni, ku kjo gjuhë mësohet në mësimdhënie, shkolla fillore, të mesme, universitete dhe kjo është mjaft mirë. Andaj për në fund, pikërisht, për shkak se muaji mars është muaji i

Frankofonisë, muaj ku nuk mungojnë aktivitetet dhe angazhimet e ndryshme, shfrytëzoj rastin t`i uroj të gjithë frëngjishtfolësve, dashamirëve të gjuhës frënge si dhe përfaqësuesve të shtetit francez dhe korit diplomatik në Maqedoni, festën e Frankofonisë, festë kjo e solidaritetit, altruizmit dhe e respektit të ndërsjellë.

Tetovë, 27 mars 2009

(AREALI EVOLUTIV GJINOR)

MULTIKULTURALIZMI DHE TË DREJTAT GJINORE

I. *MULTIKULTURALIZMI DHE TË DREJTAT GJINORE*

Multikulturalizmi paraqet një shoqëri heterogjene apo prezencën e shumë kulturave në një hapësirë të njëjtë. Njëra prej çështjeve fundamentale që e karakterizon multikulturalizmin është dallueshmëria. Dallueshmëria sociologjike dhe demografike, por gjithashtu edhe dallueshmëria si kategori filozofike. Multikulturalizmi parashtron pyetjen primare që ka të bëjë me kapacitetin e një sistemi social të integrojë një dallueshmëri autentike.[24]

Ndërkaq, në anën tjetër me të drejta gjinore nënkuptohet respektimi i sekseve të ndryshme. Dihet se gjatë historisë njerëzore gjinia që më së shumti i është ekspozuar një diskriminimi është gjinia femërore, edhe atë nga gjinia mashkullore. Kur mendojmë për të drejtat gjinore, këtu kemi parasysh edhe njohjen e të drejtave të gruas dhe ndalimin e dhunës ndaj saj. Dihet se femrat u janë nënshtruar një diskriminimi, rrahjeje apo edhe ekzekutimi nga ana e meshkujve. Më se 2 milionë femra u janë ekspozuar zanatit katastrofalë të quajtur "prostitucion" ku trupi i tyre shitet si mall në treg. Në disa vende kemi aborte të mëdha që vijnë si pasojë e kontrollimeve gjinore para lindjes përmes ultrazërit apo amniosintezës. Për çdo vit vdesin 1.5 milionë fëmijë për shkak të përkatësisë së tyre gjinore. Vajzat dhe gratë dhunohen seksualisht çdo ditë. 75% e dhunimeve kryhen nga dorasit e rrethit të afërt social.. Vetëm 10 -30% dhunimeve paraqiten në polici. Në shumë vende femrat s'guxojnë të vetëvendosin për trupin e tyre. 150 milion femrave u janë dëmtuar dhe gjymtuar organet gjenitale. Dhe në përgjithësi femrat shpërfillen në çdo aspekt në shumë vende të botës.[25]

II. MULTIKULTURALIZMI, TË DREJTAT GJINORE DHE SFIDAT

Modeli multikulturalist është i patjetërsueshëm, sepse ky model respekton dhe pranon çdo identitet kulturor, bashkëjetesën në mes të grupeve të ndryshme etnike e gjithashtu edhe kooperimin dhe bashkëpunimin mes tyre. Nëse duam të krijojmë një barazi të vërtetë, duhet t`i pranojmë diferencat, dallueshmëritë dhe identitetet individuale dhe duhet marr si model universal vlerat e gjitha grupeve etnike. Abdallah-Preitcelle thekson: "Multikulturalizmi merret me njohjen e pluralitetit të grupeve dhe tenton të evitojë dhe mënjanojë thyerjen apo eklatimin e unitetit kolektiv". [26]

Edhe pse sot në shumë vende të ndryshme të botës ky kodeks nuk pranohet fare, duhet që secili shtet dhe secila shoqëri të tentojë të afirmojnë multikulturalizmin. Sot në botë kemi shumë vende, të cilët kanë probleme me mosnjohjen e multikulturalizmit apo në dilemat ndaj kësaj çështje tejet grandioze. Disa njerëz, të shqetësuar nga emigracioni, getot etnike dhe ekstremizmi i brendshëm, bëjnë thirrje që multikulturalizmi të hiqet. Një zyrtar britanik me emrin Trevor Phillips, për gazetën "The Times" deklaroi: "Multikulturalizmi më nuk është i dobishëm, sepse ka nënkuptuar gjëra të gabueshme, andaj unë sugjeroj ndarje. Proklamoj prej këtij momenti shtetet e integruara me vlera të përbashkëta si: demokracinë, sundimin e ligjit dhe gjuhën amtare të atij shteti"-tha zyrtari Phillips. Ai më tej shtoi: " Banorëve që janë të huaj në shtetin ku ata jetojnë, duhet

---

[24] Semprini, A.(1997) Le Multiculturalisme, Paris, fq. 124
[25] www.google.com.les droits des femmes dans le monde entière 20%html.fr
[26] De Carla, M., (1999) Le Multiculturalisme et l`interculturel, Paris, fq. 40

vazhdimisht t`u thuhet se s`janë ata që janë derisa ata të pranojnë " shtoi me tej Phillips. Ndërkaq, Charles Jenkins, nga Njësiti i Inteligjencës për Ekonominë në Londër thotë : "Multikulturalizmi i mban të bashkuar qytetarët e çdo shteti". Nga ana tjetër Charles Jenkins deklaron më tej : " Multikulturalizmi është forcë e madhe pozitive. Andaj, asnjë vend nuk duhet pranuar politikën e asimilimit, përkundër vështirësive me emigracionin dhe sigurinë". Ai më tej kërkon adaptimin e elementeve të lojalitetit. Nga ana tjetër Daniele Joly, ligjërues në Universitetin Warwick thotë: " Nuk mendoj se multikulturalizmi është diçka e keqe, nëse e shihni si përzierje të kulturave të ndryshme në një vend të veçantë. Në shumë shtete problemi që ekziston është vënia në praktikë e multikulturalizmit. Mirëpo, në disa vende si Franca, ku ka politikë asimiluese, rezultatet janë edhe më katastrofike. Prandaj, duhet gjetur rrugën që mundëson njohjen e vlerave dhe kulturave të ndryshme dhe njëkohësisht rrugën që ofron mundësi të barabarta" thotë Joly duke iu adresuar kësisoj çdo shteti që posedon fenomenin e ashtuquajtur multikulturalizëm. Ndërkaq, sa i përket të drejtave gjinore, duhet cekur se që nga viti 1980 filloi vetëdijesimi publik për respektimin e të drejtave gjinore, konkretisht, respektimin e të drejtave të gjinisë femërore si dhe dënimin e dhunës ndaj kësaj gjinie. Filloi një mobilizim i hatashëm i lëvizjeve feministe. Fill pas Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut (1948), u miratua dokumenti qendror si Konventa mbi zhdukjen e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave ***(CEDAW)*** apo ***Konventa e Grave,*** që u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1979. Kjo Konventë saktëson : " Diskriminimi ndaj grave shkel parimet e barazisë së të drejtave dhe të respektit të dinjitetit njerëzor". Kjo solli në njohjen e të drejtave të gruas si të drejta të njeriut në vitin 1993 në ***Konferencën Botërore të KB për të Drejtat e Njeriut në Vjenë.***[27] Këto gjëra sollën suksese, meqë sot dënohen penalisht të ashtuquajturit "turistë të seksit" të cilët keqpërdorin seksualisht vajza jashtë vendit. Poashtu dhuna në bashkëshortësi është e dënueshme. Sot kemi poashtu një akces më të madh të femrave në aspekte të ndryshme shoqërore. Ajo që kontribuoi më shumë në këtë drejtim është aktiviteti i organizatës ***TERRE DES FEMMES***, organizatë franceze, që synonte mosdorëzimin para peshës së pseudoargumenteve, që thirren në emër të vlerave pseudokulturore dhe pseudofetare dhe përmirësimin e të drejtave të femrës.[28] Por njerëz të ndryshëm kritikuan avancimin e të drejtave gjinore, e në shumë shtete siç përmenda edhe më lartë, situata me respektimin e të drejtave gjinore ishte katastrofike duke mos iu lejuar femrave liria për vetëvendosje dhe duke mos iu lejuar akces në çdo aspekt. Mirëpo, lëvizjet e ndryshme feministe e posaçërisht organizata ***TERRE DES FEMMES*** në bashkëpunim me lëvizje të ndryshme feministe arriti që të favorizojë mjaft të drejtat e gjinisë femërore. Sot nëpër botë kemi shumë femra që kryejnë funksione të ndryshme diplomatike, politike, ekonomike etj. Poashtu sot femrat janë më të privilegjuara dhe jo rastësisht kjo gjini feston edhe ditën e saj si festë ndërkombëtare, 8 Marsin.

III. ÇFARË HAPASH DUHEN TË NDËRMIRREN PËR NJOHJEN E MULTIKULTURALIZMIT DHE TË DREJTAVE GJINORE

[27] Beqir, (2004) Hyrje në sociologjinë juridike, Prishtinë, fq. 63-64.
[28] *www. google. com. fr. TERRE DES FEMMES. org. fr*

Edhe pse shoqëria ende nuk ka pasur sukses të sjell solucione përfundimtare për fenomenin e ashtuquajtur "***multikulturalizëm",*** ajo prapë se prapë propozon mosfavorizimin e dy tendencave të rrezikshme:

1. **Nga njëra anë, homogjenizimin e ideve dhe formave të jetës në emrin e një universalizmi abstrakt**
2. **Nga ana tjetër mbrojtjen e partikularizmave (pjesëzimeve) rezistuese, mosnjohjen e tjetrit dhe mosnjohjen e dallimeve.**

Nëse evitohen këto 2 tendenca të rrezikshme, mund t`i qasemi më afër njohjes së fenomenit ***multikulturalizëm***, pra njohjes së kulturave, etnive të ndryshme dhe njohjes së shumëllojshmërisë së botës dhe popujve. Ndërkaq, që t`i qasemi më afër fenomenit ***"të drejta gjinore",*** nuk duhet pranuar aspak dhe duhet dënuar dhunën çmendurake ndaj femrave, mbylljen e tyre në labirinthe të zeza dhe keqpërdorimin e tyre. Duhet pranuar nga të gjitha palët raportin reciprok dhe të ndërsjellë, me tolerancë dhe mirëkuptim mes të dy gjinive të Zotit. Gratë dhe vajzat e botës duhet të përgatiten dhe ta ngrinin vetëdijen e tyre dhe njohjen e ndërsjellë për angazhimin dhe respektin për format e ndryshme të rezistencës, njashtu që të çlirohen edhe nga udhëzimet e tepërta pseudofetare-tradicionale dhe ato të tepërta civilizuese (kulturore), kinse në emër të njëfarë civilizimi dhe emancipimi.

Sipas mendimit tim, multikulturalizmi është tejet i vështirë, por jo edhe i pamundur për tu zbatuar. Sot në botë, gjithnjë sipas mendimit tim, mungon një dëshirë dhe vullnet për pranimin e multikulturalizmit. Rastin e tillë e kemi në Maqedoni, ku mungon dëshira e popullit maqedonas të pranojë ekzistencën e popullit shqiptar këtu, si dhe të pakicave tjera. Mendoj se është e vështirë të pranohet prania e multikulturalizmit, sepse secili komunitet mendon të ruaj atë të veten dhe të mos pranojë të huajën. Për të dëshmuar se shumëetniciteti është i vështirë për të funksionuar, unë jap si shembull Perandorinë Osmane, e cila me gjithë tentativën për mbajtjen e shumë popujve së bashku dështoi, mandej kemi Perandorinë Bizantine, të njëjtin rast e kemi me ish-BRSS-në, me ish-Jugosllavinë etj. Mendoj që duhet shkuar sipas parimit popull-komb të kardinalit Rishelje, por vetëm nëse dështon përpjekja për ta mbajtur gjallë fenomenin e quajtur "multikulturalizëm", apo përpjekja e njohjes së tjetrit ashtu siç është. Dështimi i mundësisë së njohjes së tjetrit solli në konflikte të ndryshme në botë, e unë e marr si shembull konkret Bosnjën dhe Hercegovinën, Kroacinë, Kosovën, Maqedoninë etj. Andaj thash më parë se nëse dështon përpjekja e funksionimit të multikulturalizmit, duhet të shkohet në ndarje, respektivisht ne shtete-kombe. Ndërkaq, sa i përket të drejtave gjinore, unë mendoj se ato janë kyçi i funksionimit të një shoqërie demokratike, të një shoqërie pa dominime, pa presione dhe shtypje, pa cenzura. Jam kundër thënieve të disa psikopatëve seksualë se femra duhet të shfrytëzohet si mjet dëfrimi, apo si mall tregu. Apo kundër disa dijetarëve "fetarë" se kinse femra është "djall" dhe se ajo si e tillë është e dedikuar vetëm për rritjen dhe kujdesin e fëmijëve dhe për punët në amvisëri. Pra, proklamoj se si e tillë femra duhet të respektohet me respekt të ndërsjellë, kuptohet edhe ndaj burrit, pa cenzura dhe me mundësi të barabarta se të dyja gjinitë nuk janë të pilotuara prej lartë rastësisht, por janë të sjellë *"to make the world better" (për të bërë botën më të mirë)* me mundësi dhe avantazhe të barabarta.

Kumanovë, 13 mars 2009

(INSTITUCIONE NDËRKOMBËTARE)

OKB: SFIDAT, RREZIQET DHE KËRCËNIMET E SIGURISË

OKB-ja, është një prej organizatave më universale, e cila në mënyrë të shkëlqyeshme është përballuar me pothuajse të gjitha aspektet e problemeve, duke filluar që nga definimi i rreziqeve, përballimi i tyre, menaxhimi i atyre problemeve dhe rreziqeve etj. Është organizata e cila u lansua si ide gjatë Luftës së Dytë Botërore, por u mishërua fill pas mbarimit të saj, ku njëkohësisht e mbajti botën për 53 vjet pa luftë, respektivisht pa lufta botërore.[29] Mirëpo, megjithë sukseset e saja, ajo përballet me një mori sfidash dhe problemesh kritike, e posaçërisht përballet me mosrealizimin e qëllimit të saj të fiksuar në Kartën e San Franciskos, e cila ka të bëjë me sigurimin e sigurisë për të gjithë. Pra, kjo është starti i cili e sfidon komplet këtë organizatë ndërkombëtare. Cilat janë ato gjëra që ndikojnë në venitjen e rolit të kësaj organizate dhe në mossuksesin e realizimit të qëllimit të saj primar, ashti siç mëton të realizojë kjo organizatë.

Sipas mendimit tim, në rend të parë do të theksoja mospajtimet e shumta mes shteteve anëtare, të cilat kanë të bëjnë si me natyrën e definimit të krizave, ashtu edhe me metodat e përballimit të po të njëjtave kriza. Pra, në vetë gjirin e shteteve të OKB-së ka përqasje të ndryshme në lidhje me atë se sa dhe si institucionet përkatëse të kësaj organizate, si dhe sa dhe si politika e kësaj të fundit ka arritur që t`i bëjë ballë sfidave dhe rreziqeve të shumta të natyrave të ndryshme, të cilat e kanë sfiduar, si dhe e sfidojnë ende këtë organizatë. Pra, sikurse edhe e cekëm pak më lartë, sfida e parë ka të bëjë me sigurinë, si koncept tejet domethënës. Siç është e njohur, tanimë konfliktet ideologjike kanë mbetur vetëm në analet e historisë. Vendin e tyre tanimë e kanë zënë konfliktet, të cilat janë rajonale, konfliktet mbrendashtetërore, mungesa e kohezionit social, e cila prodhon destabilitete të brendshme, problemi i varfërisë, sëmundjet infektuese, degradimi i ambientit jetësor, luftëra dhe dhunë në shtete të ndryshme, pajisja me armë bërthamore, nukleare dhe biologjike, terrorizmi dhe krimi i organizuar. Pra, tash skemat ideologjike të luftërave me antagonizma ideore kanë rënë prej top listës. Aktualisht Organizata është e sfiduar nga rreziqet dhe sfidat të cilat i lartëpërmenda më herët.

SIGURIA KOLEKTIVE DHE RREZIQET E REJA

Si sfidë qendrore e funksionimit të OKB-së në mileniumin më të ri paraqitet arritja e një konsensusi në lidhje me kuptimin dhe domethënien e sigurisë kolektive, e cila sipas mendimit tim, mbështetet në tre shtylla kryesore.

1. **Kërcënimet bashkëkohore ngrihen jo vetëm ndaj shteteve nacionale, por me të drejtë ato duhet të konsiderohen dhe të trajtohen duke u zgjidhur si duhet jo vetëm në nivel lokal, por edhe në atë rajonal dhe ndërkombëtar.**
2. **Asnjë shtet i vetëm në arenën ndërkombëtare, pavarësisht prej fuqisë, nuk është më në gjendje të mbrohet, ose të jetë i paprekshëm nga efektet e kërcënimeve bashkëkohore. Andaj, sipas meje është në interes të të gjithë shteteve që të kooperojnë dhe bashkëveprojnë në drejtim të përballimit sa**

[29] Bashkurti, Lisen, Mbi të drejtën ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtare, GEER, Tiranë 2006, fq. 100

më efikas me problemet dhe kërcënimet eventuale. Kësisoj, do të mundësohej një bashkëveprim reciprok drejt përballimit sa më të lehtë me rreziqet apo kërcënimet aktuale sikurse janë: terrorizmi, krimi i organizuar, larja e parave, tregtia me drogë dhe me njerëz, korrupsioni, varfëria, sëmundjet e ndryshme etj

3. **Pavarësisht prej asaj se përgjegjësia kryesore për të mbrojtur qytetarët ngelet tek qeveritë nacionale, nuk mund të paramendohet dhe të theksohet se çdoherë shtetet janë në gjendje ta bëjnë një gjë të tillë, pa mos rrezikuar ndonjë shtet tjetër.** Pra, interes dhe përgjegjësi primare e qeverive nacionale është mbrojtja e qytetarëve përkatës të tyre, si dhe përmbushja e detyrimeve ndaj bashkësisë ndërkombëtare. Ajo që ka të bëjë me sigurinë kolektive është një vlerë e përbashkët dhe e pashmangshme e cila duhet të trajtohet si e tillë, pa paragjykime, nga secili shtet. Nëse shtetet e ndryshme mbrojnë qytetarët e vet, si dhe përkujdesen edhe për shtetet e tjera, duke i ndihmuar atyre, si dhe duke bashkëvepruar mes veti, atëherë shumë më lehtë do të vinte deri tek një respektim i plotë dhe funksionim i duhur i të drejtave, vlerave (worth) dhe sigurisë së njerëzve. Pra, duhet zhvilluar ndjenja se ***ne të gjithë ndajmë përgjegjësinë për sigurinë e secilit prej nesh.*** Ndërsa, mendoj se siguria ndërkombëtare dhe OKB-të, gjenden përballë disa grupeve të rreziqeve dhe kërcënimeve të cilët do t`i klasifikoja kësisoj:

- ***kërcënime dhe rreziqe sociale dhe ekonomike, të cilët përfshijnë varfërinë, sëmundjet infektuese dhe degradimin e ambientit jetësor***
- ***konflikte ndërkombëtare që përfshijnë konfliktet e brendshme, luftërat civile, gjenocidin, etnocidin dhe forma tjera të shfaqjes së dhunës***
- ***armët biologjike, kimike, radioaktive dhe nukleare***
- ***krimi i organizuar transnacional.***
- Qëllimet drejt të cilave duhet shkuar OKB-ja, është përballimi me këto lloje rreziqesh dhe sfidash, të cilat mund të jenë me përmasa katastrofike dhe shqetësuese për pjesë të ndryshme të globit, por edhe për vetë OKB-në. OKB për t`i parandaluar këto trajta të rreziqeve duhet të përdorë veprime parandaluese, e cila kërkon udhëheqje në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.

VARFËRIA, SËMUNDJET INFEKTUESE DHE DEGRADIMI I AMBIENTIT JETËSOR

Sipas të dhënave të ndryshme me të cilat disponojnë organizatat e ndryshme, varfëria paraqet një problem themelor për një të tretën e shteteve të botës dhe qytetarëve të këtyre shteteve. Prej vitit 1990, numri i njerëzve të varfër rritet në mënyrë rapide, për të arritur në disa rajone të botës deri në shifrën 100 milionëshe. Kontinenti që është më i goditur prej varfërisë është Afrika, ku në disa shtete jeta mesatare është zvogëluar prej 50 në 46 vjet, dhe ku një prej 10 fëmijëve vdes para se të mbush dhjetë vjet.[30] Kësisoj, pra, varfëria është njëra prej arsyeve dhe shkaqeve të paraqitjes së pabarazisë shoqërore. Kur problemit të varfërisë i shtohet edhe pabarazia etnike ose fetare, respektivisht, urbanizimi dhe papunësia, paraqitet formula kryesore dhe të gjitha premisat e shfaqjes së luftërave

[30] Clausener, Magali -Petit, Marine Lath-Jeunesse, Les défis en Europe et dans le monde entière, Paris 1999, fq. 95.

civile. Pra, e keqja përhapet në mënyrë suksesive-zingjirore. Kësisoj, OKB-të duhet menaxhuar më mirë të mirat natyrore, sepse 20 % e njerëzve të botës shfrytëzojnë 80 % të të mirave materiale, andaj shtrohet pyetja se çfarë duhet bërë për 80 % e njerëzve të tjerë që nuk kanë akces tek këto të mira. Pra, duhet shlyer pabarazinë klasore dhe shoqërore. Përpos varfërisë, shtetet në zhvillim, e posaçërisht ato të pazhvilluara, ndeshen edhe me një varg sëmundjesh kancerogjene dhe sëmundjesh infektuese me përmasa dhe efekte shkatërruese. Kësisoj më vitin 2000, Këshilli i Sigurimit, si organ kryesor i OKB-së, e analizoi problemin e HIV/SIDA si njërin prej problemeve më shkatërrimtare për sigurinë ndërkombëtare, ndërsa më 2003 u formua Fondi Global për Luftimin e SIDA-s, tuberkulozes dhe malaries. Më 1987, gjashtë vjet pas identifikimit të parë të infektimit me virusin e SIDA-s, u fillua me një sensibilizim dhe iniciativë në luftën kundër kësaj të keqe vdekjeprurëse duke bërë fushata të ndryshme drejt vetëdijesimit të banorëve, që jetonin në shtetet ku ky virus vdekjeprurës kishte bërë kërdinë. Pas 9 vjetëve janë regjistruar 25 milionë të infektuar nga SIDA, ndërsa deri më 2003 më shumë se 11 milionë fëmijë në Afrikë janë përfshirë nga ky virus. Ndërsa, 2 milionë njerëz vdesin në vit prej tuberkulozes. Sipas një prognoze të Organizatës Botërore të Shëndetësisë më 2020 kjo shifër do të rritet në 36 milionë.[31]

Me sa shihet, këto janë një mori sfidash të mëdha për këtë organizatë, të cilat duhet të trajtohen si duhet seriozisht, dhe të cilat sfidojnë këtë organizatë dhe tërë njerëzimin. Lypset ndërmarrë aktivitete konkrete në parandalimin e zgjerimi të këtyre rreziqeve.

KONFLIKTET NË DHE MES SHTETEVE

Edhe pse konfliktet ndërkombëtare ishin ato që ndikuan në formimin dhe ngritjen e sigurisë kolektive, pas viteve të 90 rreziku u zëvendësua me konfliktet në dhe rreth shteteve. Këto konflikte sfiduan dhe po sfidojnë ende organizatën, sepse dëmet janë shumëlaterale dhe shumëfish më të mëdha në krahasim me luftërat botërore. Edhe pse konfliktet mes shteteve janë zvogëluar për 9 %, prapë se prapë ekziston një rrezik i përhapjes së tyre. Por, ajo që sfidon organizatën më shumë janë konfliktet brenda shtetërore, të cilat vijnë si pasojë e mungesës së kohezionit social. Poashtu, konfliktet janë bërë shumë lehtë të transmetueshme në shtete tjera përmes refugjatëve, kriminelëve etj. Edhe pas disa vjetëve të krijimit të Agjendës për Paqe, konstatoj se sfida shumë e rëndësishme për Organizatën është ajo se si të shkohet drejt një mobilizimi potencial kolektiv të sistemit të Kombeve të Bashkuara me më shumë koherencë dhe fokus në parandalimin e konflikteve. Kjo mundet të arrihet përmes bashkëpunimit intershtetëror, intensifikimit të fushës diplomatike, politike, humanitare, institucionale etj drejt zgjerimit dhe avancimit të të drejtave të njeriut dhe drejt parandalimit të konflikteve.

ARMËT BIOLOGJIKE RADIOAKTIVE DHE KIMIKE BIOLOGJIKE

Ky rrezik mund të shihet fare lehtë, përmes shkeljes së Marrëveshjes për mospërhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, e bile edhe deri tek frika për prishjen e kësaj Marrëveshje. Pothuajse 60 shtete në botë prodhojnë fuqi nukleare, ose kanë reaktorë kërkues, përderisa 40 shtete tjera kanë infrastrukturë shkencore për prodhim të armëve nukleare. Andaj, rreziku i përhapjes së këtyre armëve është shumë real dhe i

[31] Le rapport de l`Organisation mondiale de la santé, 2003, page 26

mundshëm, nëse nuk respektohet regjimi i mospërhapjes së armëve nukleare, i parashikuar përmes marrëveshjes nga Agjencioni Ndërkombëtar i Energjisë Atomike ***(MAAE).*** Konventa e shkatërrimit të armëve në masë parasheh shkatërrim të armëve në masë gjer më 2012. Poashtu edhe armët biologjike paraqesin një kërcënim serioz, e mbi të gjitha me zhvillimin e bioteknologjisë bashkëkohore. Edhe pse janë arritur disa hapa të rëndësishëm në mjekimin e disa sëmundjeve, prapë se prapë kemi paraqitjen edhe të disa sëmundjeve edhe më vdekjeprurëse sikurse antraksi. Andaj, OKB-ja dhe bota duhet të jenë koshient se mosmenaxhimi i duhur i këtyre armëve sjell impakte katastrofale për njerëzimin. Shembulli më i mirë për të ilustruar këtë mund të jetë rasti i Çernobilit.

TERRORIZMI

Pas ngjarjeve të 11 shtatorit dhe sulmit ndaj Kullave Binjake në New York, u pa se më asnjë shtet në botë nuk është i sigurt, e ndofta edhe ata që pretendojnë se janë më të fortë. Në kuadër të kësaj Organizate kërcënimet terroriste dhe sulmet definohen dhe paraqesin sfidat parësore. Ksenofobia e përcjellë me sulme ndaj civilëve paraqet kërcënim edhe për vlerat themelore që përbëjnë OKB-në, siç janë:

1. **respekti i të drejtave të njeriut**
2. **sundimi i ligjit**
3. **të drejtat e civilëve gjatë luftës**
4. **toleranca mes njerëzve dhe popujve**
5. **dhe zgjedhja paqësore e konflikteve**

Kësisoj OKB duhet të ketë parasysh se sfida e terrorizmit vjen për shumë arsye, të cilat sipas mendimit tim janë:

1. ***Mungesa e shpresës me të cilën ballafaqohen shumë njerëz dhe varfëria***
2. ***pabarazia politike***
3. ***mungesa e respektit***
4. ***ekstremizmi dhe cenimi i të drejtave të njeriut***
5. ***konfliktet rajonale***
6. ***kapaciteti i pamjaftueshëm i shteteve të vendosin rend dhe drejtësi, etj.***

Andaj, OKB duhet të miratojë një strategji gjithëpërfshirëse për ndalimin e fondeve terroriste, margjinalizimin e financimit të grupeve të dyshimta të cilat përmes aksioneve gjoja se fetare, dhe nën emrin e fesë keqpërdorin me të drejtat e njerëzve duke zhytur në humnerë fate njerëzish. OKB-ja duhet të përmirësojë instrumentet e luftës kundër terrorizmit edhe atë përmes nënshkrimit të 12 konventave të luftës kundër terrorit dhe miratimit të tetë rekomandimeve specifike të Organizatës për Zhvillim dhe Kooperim Ekonomik ***(OECD),*** që kanë të bëjnë me financimin e terrorizmit. Mendoj se OKB-ja përballë kësaj sfide monstër duhet të asistojë më tepër shtetet në luftimin e terrorizmit, edhe atë përmes zgjerimit të kompetencave të drejtorive përkatëse të cilat angazhohen në luftën kundër terrorizmit. Edhe pse OKB ka nxjerrë rezolutën me numrin 1566, për ndalimin e financimit të veprimtarive terroriste më vitin 2004, ajo duhet që të riangazhohet më tepër në respektimin apo detyrimin e respektimit nga shtete përkatëse të Konventës së Gjenevës dhe protokolleve të saja.

KRIMI I ORGANIZUAR NDËRKOMBËTAR

Edhe kjo llogaritet si kërcënim e cila cenon të drejtat dhe liritë njerëzore. Është sfidë e madhe për OKB-në. Mundemi të paramendojmë. Sipas një analize të bërë nga disa studiues francezë, grupet kriminale përmes drogës përfitojnë në vit prej 300 gjer më 500 milion dollarë. [32] Kjo shumë e madhe, në disa raste është më e madhe se edhe GDP-ja e shumë shteteve dhe qeverive. Sipas mendimit tim OKB është treguar inefiçiente ndaj këtij problemi, sepse nuk ka reaguar si duhet. Kjo vjen si pasojë e :

1. ***mosbashkëpunimit apo bashkëpunimit të dobët mes shteteve***
2. ***koordinimit të dobët mes agjencive ndërkombëtare***
3. ***mosimplementimit adekuat të një bashkëpunimi kundër këtij rreziku nga shumë shtete.***

Për parandalimin e krimit të organizuar duhet vepruar menjëherë gjatë dhe pas përfundimit të konflikteve, sepse gjykoj se periudha postkonfliktuale është tejet e përshtatshme për t`u frekuentuar dhe ndodhur ky rrezik. OKB-ja për të luftuar me sukses këtë rrezik duhet të rregullojë dhe organizojë një kornizë ndërkombëtare ligjore për parandalimin e aktiviteteve kriminale. Për këtë arsye, duhet jo vetëm të nënshkruhet dhe ratifikohet, por edhe të implementohet Konventa kundër krimit të organizuar ndërkombëtar e vitit 2000 dhe tre protokollet e kësaj konvente, së bashku me Konventën për Luftën Kundër Korrupsionit. Sipas një informate, më shumë se gjysma e anëtarëve të OKB-së, nuk e kanë nënshkruar dhe nuk e kanë ratifikuar këtë konventë.[33] Në lidhje poashtu të ngushtë me krimin e organizuar ndërkombëtar dhe korrupsionin, janë edhe larja e parave me aktivitete kriminale, tregtia me njerëz dhe me gra, tregtia me fëmijë etj, të cilat paraqesin sfidë permanente për këtë Organizatë dhe për shtetet anëtare të saj. Kësisoj kontributi i OKB-së do të duhej të shkonte drejt relativizimit të këtyre problematikave të mëdha të cilat sfidojnë vazhdimisht.

PËRFUNDIM

Pra, siç mund të shihet, OKB-ja gjendet përballë shumë sfidave, kërcënimeve dhe rreziqeve permanente të cilat mund të ndikojnë negativisht nëse nuk ndërmerren veprime konkrete. Megjithë avantazhet e kësaj Organizate për mbajtjen e botës larg luftërave botërore, megjithë kontributin e saj në dekolonizimin e shumë shteteve, megjithë kontributin drejt krijimit të shteteve të reja, megjithë shumë roleve dhe kontributeve të pakontestuara drejt vendosjes së paqes në botë, OKB gjendet para shumë sfidave të cilat provokojnë dhe sfidojnë tej mase këtë organizate. Andaj, një veprim i koordinuar dhe i përbashkët i të gjithë shteteve anëtare të kësaj organizate, do të reduktonte ose minimizonte efektet negative të këtyre rreziqeve dhe kërcënimeve. Jam koshient se nuk mund të idealizohet OKB-ja, por edhe nuk mund të anashkalohet roli i saj. Nëse me të vërtetë OKB-ja dëshiron që të përmirësojë menaxhimin e saj dhe të mos sfidohet nga këto sfida dhe rreziqe permanente, ajo duhet të ndryshojë. Të ndryshojë rrënjësisht në organet e saja, në vendimmarrjen e saj, në përbërjen e saj, në institucionet e saja, dhe normalisht në efiçiencën e saj. Sepse, citoj babanë e Frankofonisë, ish-presidentin e Senegalit, Leopold Sedar Senghor, i cili me një rast citon ***"çdo gjë duhet të ndryshojë njëherë,***

---

[32] Daniel, Maja/ Jean Marie, Achard: L`état du monde junior -Encyclopédie historique et géopolitique, Paris 2002, fq.11.

[33] Georgieva, Lidija: Menaxhiranje na rizici, Shkup 2006, faqe 113.

përndryshe do të zhvillohej një shoqëri statike".[34] Kësisoj, OKB-ja sa i përket procedurave vepruese, duhet të ndryshojë rrënjësisht, nëse dëshiron të ketë suksesin e duhur të saj dhe nëse dëshiron t`u bëjë ballë këtyre sfidave, rreziqeve dhe kërcënimeve, si dhe të bëhet promotor e paqes, sigurisë dhe stabilitetit në botë.

Tetovë, 21 janar 2009

[34] Deniau, Xavier, La francophonie, Paris 2001, fq. 10

(GJUHËSI)

PSE DUHET TË PROMOVOHEN DHE TË MËSOHEN GJUHËT E HUAJA, POSAÇËRISHT GJUHA FRËNGE

Shpesh më sillen mendime vërdallë nëpër kokë për atë se si do të ishte bota, po të flitej vetëm një gjuhë. A do të ishte më mirë?A do të mundeshim të kishim më pak probleme për t`u marr vesh me të tjerët? Thjesht, si do të ishte konfiguracioni i sotshëm botëror, sikur të mos ishte dallueshmëria dhe shumëllojshmëria? Por, duke menduar më thellë prapë arrij të konkludoj dhe të pajtohem me thënien e Gandit : ***"Botën më mirë e kuptojmë, po të jemi të ndryshëm dhe po të kuptojmë këtë".*** Të ndryshëm në komunikim, në vlera, në gjuhë, në mentalitet ..... Andaj shumë mirë që është kjo shumëllojshmëri e cili na mundëson që ta kuptojmë tjetrin dhe ta respektojmë atë. Është shumë mirë që ekzistojnë shumë gjuhë e kësisoj shumë kultura. Sepse, secila gjuhë ngërthen në vete edhe aspektet kulturore dhe civilizuese. Është e njohur një thënie se me gjuhë mund të lëvrohet ndërgjegjja. Poashtu edhe ajo se shpata ka një teh, kurse gjuha ka me qindra sish. Andaj, sa më shumë gjuhë të dimë dhe mësojm,ë aq edhe vlejmë. Ose siç thotë një thënie franceze ***"Plus tu apprends des langues, plus tu es humaines"*** (***Sa më shumë që të mësojmë gjuhë, aq më human dhe njerëzor jemi).*** Andaj, le të mobilizohemi sa më shumë që të mësojmë gjuhë të huaja, por duke mos e harruar njëkohësisht gjuhën tonë. Të mësojmë anglishten, frëngjishten, gjermanishten, italishten, spanjishten, greqishten, pse jo edhe turqishten, e shumë e shumë gjuhë tjera. Sot në botë ekzistojnë afro 2796 gjuhë ortoepike (apo gjuhë që fliten), ndërsa 350 gjuhë të cilat kanë edhe sistem alfabetik apo janë gjuhë ortografike.[35] A thua është e mundur të mësohen të gjitha gjuhët?? Përgjigjja ime është se nuk mundet të mësohen të gjitha. Por, të mësohen ato të cilat na mundësojnë qasje më të mirë në botën e globalizuar. Që na mundësojnë lehtësime të ndryshme. Të mësohen ato gjuhë që kanë reflektuar dhe reflektojnë në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Gjatë bisedave të ndryshme që bëj me miq të ndryshëm disa përkrahin mendimin se gjuhët duhet të mësohen sa më shumë që është e mundur. Por, kam edhe disa prej tyre miqve të cilët kanë frikë nga gjuhët e huaja. E sidomos vërej një hezitim dhe ngurrim nga gjuha frënge. Ka edhe të atillë që kanë edhe frankofobi. Më vështirë e kam me to. Pse? Sepse, fatmirësisht, nuk janë të shumtë, por krijojnë probleme me opinionet, veprimet dhe mendimet e tyre. Ata shtrojnë pyetjen se pse duhet të mësohet frëngjishtja? Në vazhdim jap argumente suplementare se pse duhet të mësohet kjo gjuhë. Kur them kjo gjuhë, ajo nënkupton edhe gjuhët tjera, por me theks të veçantë pse duhet të mësohet frëngjishtja? ***Si pikë e parë,*** frëngjishtja është gjuhë evropiane. Evropa tani është një mozaik i shumë popujve, kulturave dhe gjuhëve. Evropa sot është një laborator i shumëllojshmërisë kulturore dhe linguistike në shkallë botërore. Dhe në këtë mozaik zë vend të posaçëm dhe mjaft domethënës gjuha frënge dhe Franca. E gjithë kjo sepse Franca ishte shteti i cili lansoi dhe inicioi krijimin e Unionit të sotshëm Evropian. Ky konfiguracion i sotshëm evropian nuk do të ishte ashtu, sikur mos të ishte Franca dhe gjuha frënge. Në Unionin e sotshëm Evropian të 27 vendeve, shteteve apo kombeve, 23 gjuhë janë zyrtare apo oficiale. Në kuadër të të gjithë këtyre gjuhëve vend primar dhe mjaft domethënës luan gjuha frënge së bashku me gjuhën angleze, kuptohet. Pse është kjo kështu, do të pyetet dikush? Përgjigjja është fare e lehtë. Sepse vetëm

[35] http://fr.wikihow.com/dire-bonjour-dans-plusieurs-langues

Franca arriti që për tre shekuj me radhë ta mbajë gjuhën frënge si gjuhë ndërkombëtare. Dhe jo rastësisht nuk thuhet "Ai popull që konverton gjuhën e vet kombëtare në gjuhë ndërkombëtare, është i suksesshëm". Dhe këtë e arriti Franca. Prej vitit 1642, që nga vdekja e personalitetit të famshëm francez, i cili arriti që ta promovoj dhe ta konvertojë gjuhën frënge si gjuhë ndërkombëtare, Armand Zhan Plasis de Rishelje i njohur thjesht si Risheljeu,[36] e deri në ditët e sotshme kjo gjuhë është gjuhë ndërkombëtare. Prej te Sistemi i Wesfalisë e deri në ditët e sotshme. Sistemi i Wesfalisë i cili krijoi modelin e shtetit-komb dhe krijoi konceptin e sovranitetit të shtetit, ishte produkt francez. Edhe UE-ja e sotshme është produkt francez. Kuptohet, së bashku me kombet tjera përparimtare. ***Së dyti,*** të mësosh vetëm një gjuhë të huaj p.sh. vetëm anglishten nuk mjafton, sepse jetojmë në një botë ku të njohësh vetëm një gjuhë të huaj nuk mjafton. Pse? Sepse personi i cili flet më shumë gjuhë të huaja, do të ketë më shumë mundësi në tregun e punës në vendin e vet, por edhe në nivel ndërkombëtar. Sepse "knowledge society" apo shoqëria e dijes kërkon më shumë impenjime ndaj gjuhëve të huaja. ***Së treti,*** gjuha frënge (së bashku me anglishten) është gjuha e vetme, e cila flitet në pesë kontinente, prej më shumë se 200 milionë personave.[37] Është gjuha më e shpërndarë për t`u mësuar në nivel botëror, pas anglishtes. Për këtë arsye ekziston edhe Organizata Ndërkombëtare Frankofone, e cila rigrupon shtetet të cilat ndajnë vlerat e gjuhës frënge, apo shtete ku mësohet gjuha frënge. Më shumë se 68 shtete bëjnë pjesë në këtë organizatë. Ndërsa në botë ekzistojnë 192 shtete gjithsej duke e llogaritur edhe Kosovën. Pra, shihet se numri i shteteve ku flitet frëngjishtja nuk është i vogël, respektivisht është i madh. ***Së katërti,*** Franca është fuqia e pestë tregtare, andaj kjo është edhe një shtysë më tepër për të mësuar këtë gjuhë. ***Së pesti,*** të mësosh frëngjishten, është një mundësi e mirë që të kesh qasje në versionet origjinale të librave të shkrimtarëve të famshëm francez të njohur edhe në nivel botëror si Molieri, Viktor Hygo, Marsel Prust, Balzak, Monteskje, Sharl Bodler, Zhak Prevert, etj. Do të kesh mundësi të njohësh dhe takosh personalitete si Zhan D`Ark, Versingetoriks, Sharlemanj, Luigji XII, XIII, XVI... Do kesh mundësi ta njohësh më mirë Revolucionin e famshëm francez me devizën e tij ***" Liberté, Egalité, Fraternité " (Liri, Barazi, Vëllazëri)***. Të takosh jakobinët, zhirondinët, etj. ***Të takosh Leopold Sedar Sengorin, Zhan Pol Sartrin, Klemonzon, Sharl de Golin, Valeri Zhiskar Destenin, Leon Blumin, Zhorzh*** Popmpidun, Miterranin, Shirakun, Kushnerin, Sarkozin. Ej ke mundësi të takosh Sarkozin, i cili gjatë një vizite në shkollë, diku në Paris, pak ditë para pavarësisë së shumëpritur të Kosovës tha: "Hiqeni atë hartë nga shkolla. Është hartë e vjetër e Evropës. Konfiguracioni evropian do të ndryshojë. Do t`i shtohet Evropës edhe një shtet". ***(E kishte fjalën për Kosovën).*** Dhe kjo u bë realitet. Falë ndihmës së miqve tanë evropianë dhe amerikanë. E kësisoj falë edhe Francës. ***Së gjashti,*** të mësosh frëngjishten është një privilegj, sepse është gjuhë e punës dhe gjuhë zyrtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, e UNESCO-s, e NATO-s, e Komitetit Ndërkombëtar Olimpik, e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dhe e shumë instancave tjera juridike ndërkombëtare. Frëngjishtja është gjuhë e tre qyteteve që janë edhe seli të institucioneve evropiane: Strasburg, Bruksel, Luksemburg. Ky i fundit është edhe qytet edhe shtet. ***Së shtati,*** frëngjishtja mundëson mësimin edhe të gjuhëve tjera, kuptohet atyre që konsiderohen si gjuhë latine

[36] Armand Zhan Dy Plesis dë Rishelje kardinal i njohur dhe prift i Francës. Ishte ministër i Luigjit të XIII – të e më vonë kryeministër. U lind në Paris më 9 shtator 1585. Ndërsa vdiq më 04 dhjetor 1642. Themelues i doktrinës Raison d`Etat.

[37] http://fr.answers.yahoo.com/question/index?qid=20080716124330AAGDgeI

(gjuha spanjolle, italiane, portugeze, rumune), por, pse jo edhe të gjuhës angleze, sepse kjo anglishtja është e furnizuar nga frëngjishtja me më shumë se 50 % të vokabularit aktual. Frëngjishtja është gjuhë e dritës. Gjuhë që të nxit të kujtosh për idetë e të Drejtave të Njeriut në botë. Përfundoj këtu, sepse nuk do të dalin as shkronjat, as fjalitë, as frazat e shkurta apo të gjata, e as faqet për të theksuar rëndësinë e kësaj gjuhe si dhe vlerat njëkohësisht. Andaj, të promovojmë këtë gjuhë. Dhe ta mësojmë njëkohësisht. E pse jo edhe tjerat gjuhë. Të promovojmë shumëllojshmërinë gjuhësore. Të evitojmë gjeneralizimin ekskluziv prej një gjuhe të vetme të botës së globalizuar. Besoj se këto janë argumente të mjaftueshme për ata që ende nuk e kanë kuptuar rëndësinë dhe peshën e kësaj gjuhe ndërkombëtare. Por, u lutem atyre personave, që pasi ta lexojnë këtë shkrim mos të turren të mësojnë vetëm këtë gjuhë. Sepse ka edhe gjuhë tjera. Të tentojmë të mësojmë sa më shumë gjuhë të huaja. Të mësojmë se ***vendi ynë nuk mësohet dot, as nuk ndriçohet, as nuk qytetërohet vetëm me gjuhën amtare, por edhe me gjuhët e huaja. E kësisoj edhe me frëngjishten***. Andaj, për në fund citoj thënien e Hajdegerit: ***"Gjuhët janë çështje tejet serioze për botën e djeshme, të sotme dhe të ardhme, saqë nuk mundet t'ua lëmë ato vetëm gjuhëtarëve".***

Kumanovë, 20 nëntor 2008

(KAPITULL I VEÇANTË)

(ARSIMIM DHE SHKENCË)

NEVOJA PËR NDRYSHIMIN E SISTEMIT ARSIMOR, DOMOSDOSHMËRI APO DËSHIRË

Shkolla paraqet një sistem pune shoqërore e organizuar qëllimisht për interesa të caktuara të shoqërisë. [38]Ajo vepron si nënsistem në gjirin e një komuniteti shoqëror. Elementet të cilët e lidhin shkollën në një komunitet të caktuar janë: prindërit e nxënësve; grupet shoqërore, politike, fetare; grupet pedagogjike; autoritetet lokale administrative; mjedisi i përgjithshëm. Këto elemente janë në lidhje të ndërsjellë. Por, lidhjet më të theksuara bashkëvepruese janë ato të relacionit: familje-nxënës-mësimdhënës e që formojnë njëkohësisht një lëvizje trekëndore. Shkolla e organizuar moderne ka mekanizma adekuate që e mbajnë në lidhje të vazhdueshme administratën, nxënësit, mësimdhënësit. Organizimin e saj e cilëson ecja me kah në zbatimin e tri funksioneve bazë: marrja e vendimeve, udhëheqja dhe administrimi, zbatimi i vendimeve të marra. Ajo arrin efektivitet, kur vë në funksionim marrëdhënie dhe bashkëveprim të përhershëm këta tre funksione bazë. Tani shtrohet pyetja se vallë, nevoja për ndryshimin e shkollës është domosdoshmëri apo dëshirë? Si pikë e parë do të ilustroj se ç`janë ndryshimet në shkollë për t`u orvatur më tutje të tregoj se vallë, a janë ato ndryshime të domosdoshme, apo janë dëshirë e ndokujt. Me ndryshime në shkollë kuptohet shndërrimi ose transformimi i shkollës p.sh.: fizionomia e shkollës, jeta dhe marrëdhëniet e reja në të, ndryshohet raporti dhe kuptimi mbi pozitën e nxënësit nga ana e shkollës etj. [39]Ndodhja e ndryshimeve në shkollë është një proces që duhet të bëhet në drejtim të krijimit të ardhmërive të reja për nxënësit, studentët, arsimtarët, në drejtim të përgatitjes së gjeneratave për një shoqëri të dijes, për një shoqëri me vizione për të ardhmen, respektivisht, vizione futuriste. Por, shtrohet pyetja tani se ndryshimet në shkollë janë një domosdoshmëri apo dëshirë? Unë mendoj se në përgjithësi ndryshimet në shkollë janë një domosdoshmëri e imponuar nga shumë faktorë si p.sh.: faktorët ekonomikë, shoqëror, social, politikë, teknologjikë, informatikë. Për shkak se sot më shumë se kurrë dijet janë fleksibile dhe të ndryshueshme, për shkak se sot në botë flet gjuha e robotëve, kompjuterëve, flet një frymë e re, që simbolizon ndryshime të përditshme dhe i imponon ato, ndërkaq nga ana tjetër dihet se "fabrika për prodhimin e trurit dhe për furnizimin me dije është shkolla", ajo duhet poashtu të jetë fleksibile konform dijeve fleksibile dhe të ndryshueshme. Sot këtu tek ne do të kisha thënë se nevoja për ndryshime në shkollë është e nevojshme shumë, pasi se edhe shkollat tona synojnë të bëhen pjesë e të ashtuquajturës ***shoqëri e dijes***, shoqëri e vlimit të informacionit dhe rrjedhshmëri e paparë e tyre. Po pse duhet ndryshuar shkolla domosdoshmërisht? Pasi se ajo me gjithë rëndësinë që e ka, është e mbyllur dhe rezistente ndaj risive dhe nuk mund t`i përshtatet risive çdoherë, mandej dominon ende stili autoritar-kërcënues që është pjesë e tradicionales, ende kemi planprograme të stërngarkuara etj. Arsyet për ndryshime në shkollë janë të domosdoshme, pasi se shkolla duhet të afrojë një arsimim cilësor-kualitativ. Në vijim shpalos edhe arsyet e tjera, se pse shkolla duhet të ndryshojë. Si pikë e parë ajo, pra shkolla duhet të shkojë në hap me kohën dhe t`u përshtatet zhvillimeve të

[38] Zajazi, Tahir, Metodologji të mësimdhënies dhe nxënies, Vinsent Graphic, Shkup 2003, fq. 594
[39] Murati, Xheladin, Ndryshimi i arsimtarit dhe i shkollës, Çabej, Tetovë 2005, fq. 9

gjithëmbarshme e që duhet këtë ta bëjë medoemos, të ndryshojnë mënyrat e punës, të zhvillohet përpos mësimit edhe këmbimi i vlerave, të vendoset rregullorja për vënien e uniformave për nxënësit dhe arsimtarët dhe së fundi, të futet domosdoshmërisht elementi i kërkimit, gjurmimit apo hulumtimit, i cili u mundëson nxënësve të mësojnë se si të mësojnë, apo të mësojnë më pak e të gjykojnë, respektivisht, mendojnë më shumë. Por, nuk duhet kuptuar ndryshimet në shkollë vetëm si domosdoshmëri dhe si asgjë tjetër, sepse ndryshimet në shkollë mund të bëhen edhe nëse shprehet dëshira për diçka të tillë. Si p.sh.: Në vendet Perëndimore shfaqet dëshira për përmirësim të enterierit apo eksterierit të shkollës, apo ndryshimin e stileve të punës, mënyrave, teknologjive dhe strategjive të caktuara mësimore dhe menjëherë mobilizohen forcat për vënien në lëvizje të motorëve ndryshues në shkollë. Pra, mos të harrojmë dhe mos të krijojmë huti, sepse ndonjëherë domosdoshmëria dhe dëshira shkojnë bashkë sikurse them kushtimisht "pula" dhe "veza". Po shtrohet pyetja pse? Sepse ndonjëherë ndryshimet në shkollë janë të domosdoshme, por mund të mos realizohen si të tilla, nëse mungon dëshira, vullneti dhe gatishmëria e faktorëve ndryshues dhe realizuesve të ndryshimeve. Pra, mund të ndodhë që ndonjë shkollë pranon ndryshimet e domosdoshme, por nga fakti se edhe ka shprehur dëshirë për ta bërë këtë, por mund të ndodhë edhe e kundërta. Pa mos e zgjatur më tepër, dua të theksoj se nevoja për futjen e ndryshimeve në shkollë është e domosdoshme më tepër se kurrë, duke e pas parasysh faktin se jetojmë në një botë të kibernetizuar, robotizuar dhe teknizuar, andaj pa marr parasysh se ndryshimet në shkollë realizohen, respektivisht ndodhin me dëshirë apo pa dëshirë, ato duhet të kenë si pikësynim zhvillimin e njeriut krijues dhe përgatitjen e tij për jetë, respektivisht duhet të bëhen në drejtim të krijimit të profilit të ri të qytetarit, të ngritjes së cilësisë së shkollës krahas trendëve evropiane (perëndimore) dhe në drejtim të mësimit të përjetshëm, respektivisht të zhvillimit të aftësive dhe kompetencave të njeriut për mësim të përjetshëm. Shkollat që bëjnë ndryshime domosdoshmërish për shkak të zhvillimeve të ndryshme, janë shkolla krahas trendëve kohore-epokale, krijojnë alternativa, krijojnë fryma krijuese, shpirtëra krijues dhe klima krijuese. Ndryshimet në shkollë që ndodhin domosdoshmërisht janë si reflektim i faktorëve të ndryshëm dhe kësisoj ndryshimet u japin mundësinë shkollave të ekzistojnë, zhvillohen, modernizohen, rinovohen, bashkëkohësohen, pra kjo konsiston në faktin se ndryshimet në shkollë janë dhe duhen të jenë domosdoshmërish të patjetërsueshme, ndërkaq pranimi i ndryshimeve duhet të bëhet me dëshirë dhe pa rezistencë, por pasi se të jenë analizuar dhe vështruar ato ndryshime në mënyrë kritike-vlerësuese. Duke e cekur tërë këtë dhe respektuar njëkohësisht, në shkollë patjetërsisht duhet të ndryshojë: misioni dhe vizioni i shkollës, fizionomia e saj, klima pedagogjike, zgjedhja e arsimtarëve, raportet mësues-nxënës, arkitektura e brendshme shkollore, mënyra e organizimit të vitit shkollor....., në mënyrë që të kemi shkolla efikase dhe nxënës produktiv, respektivisht të suksesshëm.

Kumanovë, 27 nëntor 2008

(POLEMIKË DHE DEBAT)

SIKUR...

Duke lexuar nëpër forume dhe nëpër libra të ndryshëm kam hasur në shumë individë dhe persona të cilët promovojnë idetë e rrezikshme se kinse identiteti i shqiptarëve është gjysmak, është semi-oriental dhe semi-oksidental. E në fakt ata vetëm se afirmojnë tezat serbe se shqiptarët nuk kanë kurrfarë lidhjesh me civilizimin Perëndimor dhe se ata duhet të trajtohen si njerëz ardhacak, me identitet të dyzuar dhe të parcializuar. Poashtu, në mesin e atyre njerëzve gjen edhe të tillë, që nxitojnë të deklarojnë se kinse heroi ynë kombëtar, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu na qenka një figurë e dyshimtë, gjoja se paska punuar në favor të çështjeve kombëtare të të tjerëve, e jo për shqiptarët, duke "harruar" se ishte ai që bashkoi Shqipërinë dhe që qëndroi burrërisht dhe stoikisht kundër pushtuesve turq. Andaj, e pash të udhës që të plasoj disa argumente dhe t`i hedh në shesh për t`i kundërshtuar të gjithë ata që deklarojnë dhe shpifin teza të tilla të rrezikshme. Populli shqiptar nuk ka identitet të fshehtë, konspirativ, gjysmak, të parcializuar.[40] Identiteti kombëtar i shqiptarëve është më se i qartë, andaj edhe nuk duhet shumë përpjekje për ta kuptuar dhe për ta parë atë. Ky identitet është ndër më të vjetrit në Ballkanin e trazuar, e këtë e vërteton edhe gjeografia. Tentativat e njerëzve të ndryshëm se kinse kemi identitet gjysmak, krijojnë impresionet se kinse shqiptarët qenkan një popull në skaj të Evropës, andej kah Iraku, Turqia ose kah Lindja e Mesme, ose Azia. Ndërsa për të kuptuar se ku e kemi vendin, se çfarë identiteti kemi, nuk duhet shumë punë, sepse mjafton që të shihet harta e Evropës, e më konkretisht e Ballkanit, dhe shumë lehtë kuptohet se ku gjendemi gjeografikisht, por edhe historikisht. Pse them historikisht? Sepse është dëshmuar se kemi personalitete të famshme me të cilat mburret, jo vetëm kombi ynë, por edhe Evropa dhe më gjerë. Pra, kemi personalitete shqiptare që gjenden në mozaikun apo panteonin e vlerave ndërkombëtare, të cilët kanë dëshmuar për identitetin tonë evropian. Njeriu i parë që arriti të jetë pjesë e këtij mozaiku ishte ***Gjergj Kastrioti-Skënderbeu*** për të cilin kanë shkruar poetë, shkrimtarë të njohur kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Për Skënderbeun ka shkruar poeti i madh amerikan i shekullit XIX, ***Longfellou.*** [41]Skënderbeu në mes tjerash ishte edhe në fokus diplomatik dhe politik të mbretërisë së Napolit dhe Vatikanit. Në Enciklopedinë e Vatikanit gjendet i gdhendur me ar emri i tij dhe i Shqipërisë si personalitet i madh që *mbrojti* ***pushtimin e Perëndimit nga hordhitë turke.*** Për Skënderbeun janë shkruar shumë vepra. Llogaritet se deri në vitin 1900 janë shkruar. diku rreth 195 vepra historike, filozofike, teologjike dhe artistike. Për Skënderbeun studiuesja e njohur bullgare, Antonina Zheljaskova, do të shprehte mendimet dhe konsideratat më të larta duke e vendosur në piedestalin më të lartë të luftëtarëve me famë ndërkombëtare që ka njohur historia për shekuj me radhë. Për Skënderbeun mendim të lartë dha edhe poeti i madh francez i shek. XVI, Ronsard, ndërsa për hir të tij është kompozuar edhe një operë me emrin "Skanderbeg" nga kompozitori i madh klasik italian, Antonio Vivaldi. Voltaire, filozofi i madh francez, me një rast në veprën e tij të vitit 1756 do të thoshte se po të kishte Roma një njeri si Skënderbeu, ajo do të kishte mbijetuar. Në mesin e atyre shqiptarëve të mëdhenj që dëshmuan se jemi edhe ne Evropë dhe që dhanë kontribut për një gjë të tillë janë edhe nobelistja e famshme

[40] Kadare, Ismail, Identiteti evropian I shqiptarëve, Onufri, Tiranë, 2006, fq. 20
[41] Bashkurti, Lisen, Identiteti, Imazhi dhe diplomacia, GEER, Tiranë 2004, fq. 153

shqiptare, simboli i paqes dhe dashurisë, nëna e famshme, Nëna Terezë, e cila me rastin e marrjes së çmimit Noël për Paqe më 1979 e tha me gojën plot: ***" Nga gjaku jam shqiptare, nga shtetësia jam Indiane, nga feja jam murgeshë katolike. Pas thirrjes sime, unë i përkas botës.***"[42] Andaj shtrohet pyetja se a ka më nderë dhe krenari që të kemi një njeri të tillë në mozaikun e njerëzve ndërkombëtarë! A ka më nder dhe krenari të kemi një **Ferid Murat,** që kanë ëndërr të tjerët ta kenë! Ky nobelist i famshëm e tha me gojën plot se prindi i tij kishte lindur në Shqipëri dhe se ai personalisht me gjak ishte shqiptar. Ky njeri me gjak shqiptari njerëzimit i dhuroi për katër vite 24 medikamente për kurimin dhe trajtimin e sëmundjeve të ndryshme si dhe shumë rezultate të tjera në lëmin e mjekësisë, e që këto rezultate të tija janë tejet utilitare në nivel botëror. Shqiptarët në mes tjerash duhet të mburren që kanë edhe shkrimtarë që i njeh e tërë bota dhe që kanë kontribut të spikatur në drejtim të afirmimit të asaj se shqiptarët janë evropian, apo siç thotë këngëtari i njohur nga Kosova**, Ilir Shaqiri:** ***"Dje dhe sot, sot e nesër jam Evropë".*** **Ismail Kadareja** me pendën e tij arriti të dëshmojë se jemi para të gjithëve që kemi promovuar vlera evropiane dhe e kemi mbrojtur Evropën. Andaj e meritojmë respektin si popull. Ky kandidat për laureat i Çmimit Noël më shumë se të gjithë arriti që me veprat e tij të të ndërtojë një urë mes letrave shqiptare dhe botërore. Më shumë se prej kujtdo tjetër lexuesit e huaj mësuan për vlerat e letërsisë shqiptare. Kadareja ka një mori çmimesh dhe pozitash të larta. Ai është anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, anëtar i Akademisë së Shkencave të Kosovës, anëtar i Akademisë Franceze, ***Doktor Honoris Causa*** i shumë universiteteve amerikane dhe evropiane. Në mesin e mozaikut të njerëzve që kontribuuan dhe që vazhdojnë të kontribuojnë në drejtim të afirmimit të asaj se jemi komb evropian, ndër të parët në Ballkan, që meritojmë të jemi të bashkuar, ka edhe shumë të tjerë. Andaj, me të drejtë do të shtroja hipotetikisht pyetjen se ***sikur*** të bashkohen aktualisht në të njëjtën kohë, apo në një kohë të vetme fuqia e Skënderbeut, bamirësia e **Nënë Terezës,** racionaliteti i **Ferid Muratit,** zëri letrar i **Kadaresë** dhe guximi politik i politikanëve shqiptarë aktual, populli dhe kombi shqiptar do të ishin më ndryshe. Unë nuk mund të di se si do të ishim, por me siguri që do të ishim më ndryshe nga ç`jemi aktualisht. Sigurisht më mirë.

Kumanovë, 18 dhjetor 2008

[42] Mother Teresa, Excerpt from the Nobel Prize Acceptance speech, Sweden, 1979

NACIONALIZMI SHQIPTAR, A ËSHTË RRUGA E VETME E REALIZIMIT TË ASPIRATAVE SHQIPTARE?

Ish- presidenti i ndjerë francez, Fransoa Miteran, kishte thënë me një rast: ”Nacionalizmi do të thotë luftë, ndërsa patriotizmi nder”. [43]Nëse nisemi nga ky gjykim, do të shihet se ai bënte një ndarje mes këtyre dy koncepteve. Por, De Gol kishte dëshmuar se ai ishte nacionalist i bazuar tek patriotizmi Risheljan dhe tek interesat kombëtare franceze.

Shqiptarët nacionalizmin si doktrinë e kanë përjetuar shumë herët. Mirëpo, nacionalizmi shqiptar në përgjithësi mund të thuhet se fillon me periudhën e ***Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe me Rilindjen Kombëtare.*** Ky nacionalizëm ndikoi në sensibilizim të çështjes kombëtare shqiptare të pazgjidhur. Ka autorë që deklarojnë se zgjimi i vonshëm i vetëdijes kombëtare dhe nacionaliste tek shqiptarët vonoi zgjidhjen e çështjes shqiptare në Ballkan. Ata shtojnë se shqiptarët në kërkim të identitetit të tyre të vonuar u vonuan në krahasim me kombet e tjera.[44] Poashtu ata mëtojnë të thonë se përçarja fetare vonoi krijimin e identitetit kombëtar shqiptar. Kësaj teorie shumë më vonë do t`i ndihmonin edhe akademikët shqiptarë, ***Rexhep Qosja dhe Ismail Kadare,*** të cilët duke u nisur nga debati i tyre i panevojshëm mbi identitetin kombëtar të shqiptarëve filluan të hapnin dilema tek shqiptarët, duke nxitur një lloj ndarje me shqiptarëve në baza fetare. Ky lloj debati nuk kishte nevojë të hapej aspak, sepse identiteti kombëtar shqiptar ishte dhe mbeti edhe më tej i konsoliduar, ndërsa aspiratat shqiptare për integrim në familjet euro-atlantike është aspiratë e pazëvendësueshme. Debati Qosja-Kadare, me gjithë kredibilitetin e dyshes së famshme, ishte i dëmshëm dhe i panevojshëm. Nuk ishte koha për këtë hapje debati, sepse kjo dilemë është më se e qartë. Shqiptarët janë një komb të cilët nuk e përkufizojnë kombin mbi bazën e fesë, por mbi bazën e gjuhës dhe ndjenjës së përkatësisë së njëjtë. Kësisoj këta shkrimtarë të mëdhenjë shqiptarë i dhanë mundësi pseudoanalistëve të ndryshëm të nxisin gjuhë dhe identitete të fragmentarizuar ndër shqiptarët, të bazuara në provincializëm. Historikisht shqiptarët nuk kanë pasur kurrfarë divergjencash në lidhje me besimet e tyre fetare. Ata kanë krijuar ndjenjën e vëllazërisë duke u bazuar në gjuhë, flamur dhe atdhedashuri, e jo në besimet fetare. Andaj, le të shpresojmë se ky lloj debati nuk do të shërbejë për thellimin e ndasive, por për një reflektim më të gjerë dhe thënien troç të gjërave të bazuara në argumentim shkencor, e jo në ëndrra miope. Akademikët duhet të shpalosin gjëra në favor të integrimit të ndërsjellë ndërshqiptar, e mandej në favor të integrimit në familjen evropiane, e jo në debate mbi identitetin kombëtar të shqiptarëve të bazuar në provincializëm ***(tezë që shkon në favor të doktrinave sllave)*** ose të debateve mbi origjinën e figurave historike si Skënderbeu, Nënë Tereza etj. Dëshmitë janë të forta se këto figura nuk janë mite, por realitete. Shqiptarët të gjetur përballë këtyre sprovave të panevojshme kanë nevojë për konsolidim kulturor, rishikim të pozitave gjeostrategjike, intensifikim të kontakteve permanente ndërshqiptare dhe ndërkombëtare, integrim kulturor mes veti, sepse duhet të kenë të qartë se ata kanë identitet dhe gjuhë të pastër, komb të pastër, jo të bazuar në fe, në aspekt etnik e jo fetar, kanë identitet evropian të theksuar me vite, jo vetëm në bazën gjeografike, por edhe në atë historike, kulturore dhe gjuhësore. Nuk duhet të krijojnë identitete të bazuar në fe, në pushtues, në rajone apo në diçka tjetër, por të shikojnë realizimin e aspiratave të tyre në

[43] http://fr.answers.yahoo.com/question/index?qid=20090430030310AAKUFNV

[44] Serge Metais, Histori e shqiptarëve nga Ilirët e deri tek pavarësia e Kosovës, Fayard, Tiranë 2006, fq. 15.

drejtim të integrimit në Evropën e Bashkuar, pa përbuzur të tjerët, pa u mohuar përbërja dhe konfiguracioni fetar i shqiptarëve, që nuk ka qenë kurrë pengesë për shqiptarët në drejtim të përforcimit të kombit shqiptar dhe gjuhës shqipe, sepse për interesat kombëtare feja e shqiptarit ka qenë dhe mbetet shqiptaria, ndërsa nacionalizmi shqiptar nuk duhet të eksponohet në drejtim të bërjes një shtet i vetëm, sepse një shtet i vetëm jemi, por formalisht i kemi kufijtë, por ky nacionalizëm duhet të bazohet në intensifikim të kontakteve ndërshqiptare dhe ndërkombëtare, ruajtjen e pastërtisë së gjuhës shqipe, mossajimi i identiteteve apo gjuhëve rajonale, unifikimi kulturor, gjuhësor dhe politik. Në Shqipëri shtetarët dhe akademikët duhet të jenë koshient se roli i shtetit shqiptar duhet të jetë i pashmangshëm në drejtim të përkrahjes pragmatike të shqiptarëve jashtë shtetit amë, Tirana-Prishtina-Shkupi-Tetova-Presheva-Ulqini të intensifikojnë këmbimet e ndryshme kulturore, kombëtare, ekonomike, gjuhësore, shkencore, politike. Shqipëria duhet të frenojë ambiciet e ndryshme për shikim të shqiptarëve me sy nënçmues, si dhe t`i mbarte gjeneratave dhe brezave se shqiptarët janë jo vetëm ata prej Shqipërie, por njësoj edhe ata prej Kosove, Maqedonie, Malit të Zi dhe Preshevës. Kosova nuk duhet të shikojë shpikje të sajesave fiktive komb apo gjuhë kosovare, sepse kjo nuk përkon me realitetin historik apo edhe atë real aktual, sepse Kosova është shtet, qytetarët quhen kosovarë, por nuk duhet që termin e shqiptarëve etnikë ta zëvendësojë me kosovarë, sepse kosovarë llogariten edhe serbët, edhe boshnjakët, edhe romët dhe pakicat tjera. Shteti Kosovë nuk duhet të shërbejë si model i krijimit të kombit kosovar, sepse ky komb është krijuar shumë më përpara shtetkrijimit. Ai është pashmangshmërisht shqiptar dhe i pandarë si i tillë. Edhe pse në serbo-kroatisht serbët e Kosovës quhen kosovci(njëjës kosovac),[45] ata identifikohen si serbë, ndërsa nuk ka nevojë të quhen shqiptarët e Kosovës, kosovarë, vetëm se për të mos u ngatërruar, gjoja se me shqiptarët prej Shqipërie. Fundja, le të ngatërrohet ky koncept, sepse flasim një gjuhë, i përkasim një historie dhe kemi qenë të pandashëm shpirtërisht edhe atëherë kur kemi qenë më së vështiri, e jo tani më kur proceset janë në favor të drejtësisë, pra në favor tonin. Shtetasit nga Maqedonia, politikbërësit shqiptarë, partitë politike shqiptare duhet të jenë më të vendosur në drejtim të kërkesave për mosanashkalim të tyre, sepse Maqedonia si shtet nuk mund të mbijetojë pa shqiptarët. Është dëshmuar kjo. Politikanët shqiptarë duhet të mbajnë kontaktet me vëllezërit e tyre të një gjaku nga viset e tjera shqiptare, të dëshmojnë se janë pjesë e shtetit të Maqedonisë, jo vetëm figurativisht, por edhe realisht, përmes insistimit në negociata për çështjen e emrit të Maqedonisë, drejt realizimit të Marrëveshjes së ”harruar” të Ohrit dhe implementimit praktik të saj, drejt përfshirjes së shqiptarëve në institucionet e shtetit dhe pjesëmarrjes më masive të tyre në sistem, duke e ruajtur kohezionin e tyre kombëtar dhe duke mos cenuar kohezionin e të tjerëve. Por, assesi nuk guxojnë të quhen ”maqedoncat” apo ata të Maqedonisë. Sepse jemi dhe do të mbesim shqiptarë sepse flasim shqip, ndërsa flamuri kombëtar yni është po ai i njëjti me gjithë shqiptarët e viseve të tjera. Thirrjet në librin e Koço Danaj, “Kryengritje e pambaruar” për ”Kryengritje të pambaruar” nuk guxojnë të interpretohen si thirrje që flasin për një kryengritje të sërishme për ta mbaruar, por për rikujtimin e qeveritarëve shqiptarë se kanë për obligim kërkimin e asaj që i takon, pjesëmarrje të duhur në shtet, të mos anashkalohen nga etnocentrizmi maqedonas, si dhe të bëhen pjesë e debatit mbi emrin, sepse kjo situatë pengu, do të mbajë Maqedoninë larg familjes së NATO-s dhe

[45] Raymond Detrez, Kosovo. De Uitgestelde Oorlog (Kosova. Një luftë e shtyrë), Arbëria, Prishtinë, 2004, fq. 7

UE-së. Kjo për shqiptarët do të thotë vonesë në realizim të çështjeve të tyre kombëtare, si dhe përpos që do të ishim të vonuar në krahasim me vëllezërit tanë nga viset tjera shqiptare, do të jemi të prirë drejt margjinalizimit të skajshëm dhe në Rubikonin e etnocentrizmit maqedonas. Kontaktet ndërshqiptare duhet të intensifikohen përmes debateve akademike shkencore, profesorëve universitarë nga të gjitha viset, në drejtim të ngritjes së një kuadri të mirëformuar shkencor që do të dinte t`i bëjë ballë sfidave të kohës dhe problemeve aktuale, të dijë të mbajë raporte fqinjësore të mira, të dijë të mbajë kontakte me ndërkombëtarët që edhe gjuha shqipe të futet në Ansamblin e Multilinguizmit Evropian.

Kumanovë, 8 qershor 2009

O SA MIRË QË JAM SHQIPTAR, O HEJ...

E fillova shkrimin me qëllim kësisoj që të bëjmë një dallim kapital se çfarë paraqet të qenit shqiptar, e çfarë do të thotë eskivimi nga ky identitet. Pse është privilegj të qenit pjesë e identitetit shqiptar? A është vështirë të jesh shqiptar sot apo jo?

Shteti, si subjekt më i vjetër, ka lindur para më se 6000 vitesh për së pari herë në ***Mesopotami,*** tek shoqëritë e para bujqësore. Mandej u përforcua në ***Kinë*** si shtet burokratik i trajnuar. [46]Ndërsa shteti-komb, apo shteti i bazuar në komb ka lindur së pari herë në ***Francë***, edhe atë në momentin kur iniciohet Paqja e Wesfalisë e nxitur nga Franca apo e motivuar nga interesat kombëtare franceze, paqe kjo e cila vendosi sovranitetin si principin më të lartë dhe më domethënës, i cili ngërthen në vete elementet demokratike. Shteti- komb, projekt ky i lancuar nga Franca gjatë sundimit të kardinalit francez ***Rishelje,*** është edhe sot e kësaj dite si lajtmotiv dhe pararojë e çdo shteti dhe kombi. Kemi shtete të cilat përpos grupeve etnike të vetave përmbajnë edhe grupe etnike tjera. Këto shtete janë të prira për të pasur më shumë probleme, sepse rregullimi i raporteve ndëretnike është më i vështirë dhe shoqërohet me probleme të shumta. Ndërsa kemi shtete të cilat kombin e kanë prioritet dhe të cilat bazohen në modelin shteti- komb, dhe nxitojnë të theksojnë se janë shtete të pastra etnike, edhe pse të tilla shtete në kuptimin të pastra nuk ka askund. Por ku gjendemi në këtë debat neve shqiptarët si komb i fragmentarizuar në shumë shtete; Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Serbi (Kosovë Lindore) dhe Çamëri. Ne njiheshim si Albanoi.[47] Shqipëria arriti të pavarësohet më 1912, ndërsa të fitojë njohjen ndërkombëtare vetëm me ndërhyrjen e ***Amerikës së Uilsonit më 1920 në Lidhjen e Kombeve.*** Por, Shqipëria u pavarësua në sajë të sakrificave të shqiptarëve, jo vetëm të Shqipërisë së sotme të cunguar, por edhe të shqiptarëve të Shqipërive tjera të vogla, të cilat sot njihen me emra të tjerë si Kosova, Çamëria, Maqedonia etj. Qysh atëherë u pa dhe shihet edhe sot e kësaj dite që është vështirë të krijohet shteti- komb shqiptar natyral, ashtu siç edhe duhet të jetë, por për hir të rrethanave atëherë të ndryshme historike nuk është krijuar. Por si arritëm ne të mbajmë identitetin tonë të pastër etnik me gjithë tentativat e ndryshme për të na përçarë edhe në aspekt të identitetit, ashtu siç padrejtësisht na ndanë në më shumë shtete. Arritëm falë betimit në flamur, falë të qenit koshient se jemi pasardhës të ilirëve, dhe asaj se jemi këtu,

[46] Fukuyama, Francis, Ndërtimi i shtetit, AIIS, Tiranë 2008, fq 23
[47] Pllana, Qerim, Dilemat për bashkimin kombëtar, PPSHK, Prishtinë 1998, fq. 5

kur nuk kishte as kufi, as fqinjësi veç Iliri. Po të kërkojmë në botë njerëz të tillë si ne nuk mund të gjejmë dot. Pse? Sepse nuk mund të hasësh askund në një ndjenjë të fortë identiteti kombëtar sikurse tek shqiptarët. Po të pyesësh një shtetas belg valon, pra i cili flet frëngjisht se vallë do të donte t`ia bashkëngjiste pjesën frënge të Belgjikës Francës, ai do të thoshte "jamais" kurrë. Sepse ndihet krenar që është belg. Ose një shtetasi zviceran frëngjishtfolës, nuk do të donte të bashkohej me Francën, edhe pse flet frëngjisht. Njësoj është edhe tek gjermanët e Gjermanisë me ato të Austrisë. Edhe pse këto shtete u bashkuan me forcë nga Hitleri, sot e kësaj dite fara e mbjell e dallueshmërisë mes tyre vërehet fare lehte. ***Ndërsa tek shqiptarët jo. Jo, sepse edhe një shqiptar i Kumanovës, edhe një i Vlorës, edhe një i Drenicës, ose Ulqinit zgjohen me ëndrrën e tyre shekullore të kenë shtetin- komb shqiptar të bashkuar dhe jo të ndarë apo fragmentarizuar.*** Ku të shkosh, në cilën do qoftë anë të Shqipërisë Natyrale, has emrin Ilir, Kastriot, Shkumbin, Vjosa, Vlora, Dardan, Flamur etj. [48] Vallë, a nuk është kjo kënaqësi! Secili shqiptar i "të gjashtë Shqipërive të vogla" është koshient për të kaluarën ilire, për luftërat e mbretëreshës Teuta, Agronit, Bardhylit e të tjerëve. Secili shqiptar është kryelartë me figurën e heroit tonë kombëtar, ***Gjergj Kastriotit Skënderbeut.*** Edhe pse ka tentativa për të mitizuar këtë figurë, ose për ta deformuar, ajo mbetet kryelartë dhe e pacenuar. ***Secili shqiptar është koshient dhe krenar për Pashain e Janinës, për Ali Pashën dhe luftërat e tij, për Lidhjen e Prizrenit, për Ismail Qemajlin, për Luigj Gurakuqin, për Isa Boletinin, për vëllezërit Frashëri, për Gjergj Fishtën, për Nolin, për Konicën, për Azem dhe Shote Galicën,*** për Luftën Nacional Çlirimtare Shqiptare, për shumë e shumë figura tjera të rralla, për të arritur deri tek heronjtë e kohërave të sotshme *të* ***Ushtrive Çlirimtare, në krye me Adem Jasharin për të cilin Bernard Kushner, ministër i jashtëm i Francës, do të thoshte:*** **"Po të kishte çmim** ***Nobel për luftë, kjo do t`i takonte Adem Jasharit".*** Por, për fat të keq çmim Nobel për Luftë nuk ka. Por çmim Nobel për Paqe ka. Këtë çmim e kanë prapë figura me gjak shqiptari. E kanë nënë Tereza ***(Gonxhe Bojaxhiu), Ferid Murati.*** A thua a ka më mirë se ky komb 8-milionësh aq i vogël të nxjerrë bijë dhe bija aq të mëdhenj sikur të ishte 60-milionësh! A ka ndokund ndonjë figurë sikurse Adem Jashari, i cili do të bëhet heroi i gjitha kohërave dhe i cili do të shihej me admirim edhe nga personalitete ndërkombëtare! A ka ndokund komb, i cili është aq i vogël në numër, por i madh në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare, sepse nxori bijë dhe bija aq të mëdhenj që janë pjesë e pandashme e mozaikut të quajtur ***Shqipëri Natyrale apo Etnike!*** Cili komb nxori njerëz të penës, të cilët e ngritën shqipen në rrokaqiej? A kanë Kadare të tjerët? Apo Fatos Kongol? Kanë njerëz si Rexhep Qosja? Kanë Ukshin Hot apo Adem Demaç? Kanë Luan Starovë? E shumë të tjerë që nuk po mund t`i përmend se janë shumë. Jo, nuk kanë. Kanë figura si Dobrica Qosiq, të cilët afirmojnë deklarativisht se gënjeshtra është pjesë e pandashme e serbëve dhe të cilët trillojnë rrena dhe prodhojnë fatkeqësi nëpër epoka të ndryshme historike. Dhe që kanë ksenofobi.

Andaj, kushdo që tenton të cenojë këtë identitet të fortë, do ta mallkojnë emrat e heronjve tanë për liri dhe bashkim kombëtar. Do ta mallkojë shqipja dykrenare. Nuk ka popull në botë që megjithë dallimin fetar ka arritur të jetë më i forti kombëtarisht. Shqiptari i vërtetë megjithë fenë e tij myslimane, katolike apo ortodokse që e ka, ndihet së pari njeri, e mandej shqiptar. Ai nuk të vret në besë, ***ai betohet për Zot e flamur. Ai flet shqip, dhe mendon shqip. Ai reflekton guxim, krenari, stoicizëm, vendosmëri,***

[48] Danaj, Koço, Të dënuar të bashkohemi, ALBAO, Tiranë, 2007, fq 16

trimëri dhe mençuri. Asnjë komb nuk është aq altruist sa kombi shqiptar. ***Nuk kemi cenuar lirinë e askujt, por nuk do të lejojmë të na cenohet as liria jonë.*** Ata që na e cenuan lirinë kanë përfunduar me turp. Këtë leksion e kanë marë romakët, e kanë marë mirë turqit, e kanë marë mirë gjermanët dhe italianët, serbët dhe maqedonasit. Andaj me gjithë këto parametra a meritojmë të jemi shtet- komb shqiptar i pandarë? Përgjigjja ime është që "PO". Po dhe vetëm Po. Në një formë apo në një tjetër po. Në formën e bashkimit njëherë e përgjithmonë nën një shtet- komb, apo nën emrin e integrimeve evropiane. Pse po? Nuk kanë mundur të na ndajnë me shekuj dhe me mileniume, e do na ndajnë tani? Identiteti shqiptar është një dhe vetëm një. Nuk ka identitet kosovar. Kosova është Shqipëri. Kosova është shtet, por përbëhet nga shumica kryesisht shqiptare. Maqedonia është shtet, por në asnjë shtëpi të shqiptarit nuk has flamur shtetëror, por has flamurin e shqiponjës me dy krena. Andaj, me gjithë sfidat dhe barrierat gjeografike, historike, diplomatike dhe politike, jemi një dhe vetëm një. Jemi shqiptar, flasim shqip, shkruajmë shqip, këndojmë shqip, recitojmë shqip. Faleminderit nëna jonë që shqiptar na ke lindë përgjithmonë! Ua shtroj pyetjen retorike të gjithë lexuesve. A jeni krenar që jeni shqiptarë? Nga vetë fakti që është pyetje retorike, përgjigjja dihet. Ajo është pohuese dhe kuptimisht, qartazi dhe prerazi – **PO.**

Kumanovë, 09 janar 2009

FESTA E 28 NËNTORIT, NDËRMJET GËZIMIT DHE PIKËLLIMIT!

Nëntori, ky muaj i cili është i karakterizuar me plot ngjarje madhore historike, është një muaj ku ndodhën kthesa të mëdha historike për popullin shqiptar. Ky muaj për ne shqiptarët është më shumë se muaj, më shumë se ngjarje, më shumë se përditshmëri, është shumë më shumë se sa ne dhe të tjerët mundemi të shkruajmë për ngjarjet dhe vendimet që kanë ndodhur po në këtë muaj. Në këtë muaj të vitit 1908 u mbajt Kongresi i Manastirit, në këtë muaj të vitit 1912 u shpall Pavarësia e Shqipërisë, në këtë muaj të vitit 1955 lindi legjenda mbarëshqiptare Adem Jashari, si dhe shumë ngjarje të tjera mjaft domethënëse për kombin shqiptar në përgjithësi. ***Pra është muaji i krenarisë kombëtare shqiptare.*** Dhe sa herë që vjen ky muaj ne shqiptarët ***(ku do që jemi***) ndihemi mjaft të gëzuar dhe këtë ditë e manifestojmë me poezi, dokumentarë, këngë e drama, duke i dhënë kështu një ngjyrë festive dhe kremtuese tërësisht kombëtare. ***Është normale që të ndihemi të gëzuar në këtë ditë, sepse para 96 vitesh, Shqipëria më 28 nëntor e shpalli pavarësinë e saj, ku Ismail Qemaili ngriti flamurin në Vlorë.*** Kjo pavarësi erdhi si rezultat i angazhimit të palodhur të shqiptarëve me anë të pushkës dhe penës, që ishin nga Kosova në veri e deri në Çamëri në jug, nga Adriatiku e Joni në perëndim e deri në Shkup e në Kumanovë në lindje, dhe të gjithë shqiptarët e diasporës kudo në botë, të cilët i thonë bukës bukë e ujit ujë. Por, fatkeqësisht dhe aksidentalisht historia na mëson diçka të hidhur. Se menjëherë pas tri ditëve, nga shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë, e gjithë Kosova, Shqipëria Veri-lindore dhe Shqipëria e Mesme ishin pushtuar nga ushtritë serbe e malaziase. Pra, Shqipëria si një trup i bashkuar me të gjitha pjesët dhe organet e saja zuri të shkëputet dhe t'i uzurpohen pjesë vitale të trupit. Për të shqyrtuar problemet politike që vijuan nga ngjarjet e Ballkanit, Fuqitë e Mëdha (Anglia, Franca, Gjermania, Austro-Hungaria, Rusia dhe Italia) u morën vesh për të mbajtur në Londër një konferencë në nivel ambasadorësh. Pas një diskutimi të gjatë dhe të nxehtë, më 22 mars 1913, Konferenca e Ambasadorëve vendosi t'i copëtonte trojet shqiptare, duke shkëputur nga Shqipëria tërë Kosovën dhe viset tjera shqiptare, si Tetovën, Dibrën, Gostivarin, Kërçovën, Strugën, Kumanovën etj..., të cilët nga pushtimi i Perandorisë Osmane kaluan në pushtim tjetër, pra në atë serbe-malaziase. Ky vendim i papjekur dhe tmerrues ndërkombëtar, u shoqërua me trazira dhe konflikte të njëpasnjëshme në Ballkan. Nga moszgjidhja e problemit shqiptar, Ballkani vazhdon të mbetet një vullkan aktiv. Nëse pyesim se me kënd kufizohet Shqipëria, atëherë do të marrim një përgjigje abstrakte. Nga katër anët e saj, Shqipëria kufizohet me shqiptarët, pra me Shqipërinë natyrale. Askund në botë nuk ndodhë që një shtet të kufizohet me vetveten. E pra kjo është përgjigja abstrakte, sepse edhe pyetja në këto rrethana artificiale për Shqipërinë është po aq abstrakte apo paradoksale. Dihet mirëfilli në aspektin mjekësor dhe logjik, se një trup do të funksionojë ashtu siç duhet, atëherë kur të gjithë pjesët e trupit janë të ndërlidhura mirë ndërmjet vete dhe funksionojnë si duhet. Shqipëria sot është një shtet me gjymtyrë të këputura dhe të keqtrajtuar në maksimum. Sot, vetëm 3.5 milionë, prej 8 milionë shqiptarëve punojnë për zhvillimin e Shqipërisë. Pra, edhe ky është njëri prej shumë indikacioneve, që rezultuan me zhvillim të ngadalshëm të Shqipërisë, ***sepse njëri prej kushteve që një shtet të jetë i zhvilluar është edhe madhësia e shportës konsumuese dhe gjymtyrët e shkëputura të tij.*** Për këtë arsye, ne shqiptarët që u privuam të jetojmë së

bashku me Shqipërinë në një shtet të vetëm, jemi të gëzuar dhe të pikëlluar më 28 nëntor (pavarësisht vitit). Ne shqiptarët e Maqedonisë, Luginës së Preshevës, Kosovës, Çamërisë dhe Malit të Zi do ta festojmë festën e 28 Nëntorit, do të gëzohemi, por me zemër të thyer, e me trup të dërmuar. Kjo ditë për ne (e që duhet të jetë edhe për Shqipërinë kështu) është ditë ku gërshetohet e mira dhe e keqja, ku papritmas në manifestim mund të vjen ndonjë "zhivorad" apo "alfa" e të na largojë nga tubimi festiv edhe atë duke përdorur dhunë. Ne në këtë ditë përskaj gëzimit do të vuajmë për gjendjen tonë të mjerueshme kombëtare e sociale, për zgjimin e vonshëm të vetëdijes, të cilën po e paguajmë shumë shtrenjtë. Ende në këtë ditë ka njerëz që nuk kanë guxim ta manifestojnë në formë publike festive këtë datë (sepse nga shteti janë të privuar për një të drejtë të tillë) si për shembull rasti i qytetit të Kumanovës dhe qytetarëve të saj. Kjo tregon rrezikshmërinë e lartë për ngritje të flamurit kombëtar në një shtet "demokratik". Për ne të cilët, në trojet tona jemi shndërruar në minoritete, kjo ditë është një ditë vaji, dëshpërimi e pikëllimi. Neve na ndan padrejtësisht, na transferuan në minoritete, na detyruan të dalim në tri kryengritje të armatosura (asnjëra e mbaruar), na detyruan të mos jemi të populluar në Manastir (Bitoll), të tubohemi në këtë qytet vetëm pas 100-viteve, edhe vetëm për të festuar. Ne të cilët, në shtëpitë tona jemi bërë mysafirë, ende përballemi me privimin e përdorimit të gjuhës shqipe, apo për një gjë të tillë ende lejojmë të negociojmë. Ne të cilët, u gëzuam pa masë në momentin e bërjes shtet të Kosovës, në mënyrë faktike e pranuam lindjen e një shteti nga po i njëjti shtet. Nipërit e mbesat tona në një të ardhme, jo të largët, do të shquhen me aftësitë e tyre shkencore, por identifikimi i tyre do të jetë "filan personi me origjinë shqiptare", pra vetëm në bazë të origjinës do të identifikohen se paskan pasur gjyshër shqiptarë. E pra, ne të cilët jemi në këtë gjendje, në trupin tonë e me tesha të huaja, me një të ardhme mjaft të pasiguritë, pa mëdyshje se në këtë ditë dhe datë do të jemi të gëzuar dhe të pikëlluar dhe festimi ynë do të jetë gjysmak, ashtu edhe siç jemi të tillë me një shtet shqiptar gjysmak, artificial, jo të plotë. Do ta festojmë këtë festë, ashtu siç duhet atëherë kur aspiratat e të rënëve (dëshmorëve) do të bëhen realitet. Pra, betimi dhe aspirata e tyre kanë qenë rikthimi i trojeve shqiptare, në një shtet të përbashkët të quajtur Shqipëri. Për në fund një mesazh ***"Shtëpia e ndarë nuk mund të qëndrojë. Ajo është e destinuar të bashkohet ose të rrëzohet krejtësisht".*** Mirë thotë Mahatma Gandi, ***"Ce qui est fait sans nous est contre nous" (Ajo që është bërë pa ne, është kundër nesh). Andaj ta kthejmë atë që është e jona dhe e cila na takon natyralisht.***

(Këtë ese e kemi punuar së bashku me kolegun dhe mikun tim Iljasa Salihu)

Kumanovë, 27 nëntor 2008

RREZIKU PËR IDENTITET TË RI KOMBËTAR

Në kohën kur shqiptarët gjenden në prag të finalizimit të ëndrrave të tyre për bashkim shpirtëror, gjuhësor, ekonomik e kësisoj politik, fill pas pavarësimit të Kosovës, në shkurt të vitit 2008, filloi dukshëm të shfaqet mendimi për kombin kosovar, identitetin kosovar, gjuhën kosovare. Këto thirrje të nxitura nga doktrina e shtetit-komb, pra shteti kosovar, kombi kosovar, kanë qenë edhe më përpara, por dukshëm filluan të shfaqeshin pas pavarësisë së Kosovës. Kosova si shtet qytetar sipas Pakos së Ahtisarit, nuk kishte nevojë për hapjen e këtij debati, sepse ai nuk na shpie asgjëkund. Idetë e analistëve të ndryshëm që tentonin dhe tentojnë me çdo kusht të faktorizohen dhe të dalin nga anonimiteti, se normale është krijimi i kombit kosovar, gjuhës apo identitetit kosovar, duke u bazuar tek frankofonët e Belgjikës apo Zvicrës, harronin se në Belgjikë komuniteti frankofon i njohur me emrin si valonët, flasin gjuhën frënge e jo gjuhën valone, që qysh në fillim bie ndesh me thëniet e këtyre analistëve se duhet krijuar gjuha kosovare duke u mbështetur te këto ide dhe kësisoj kjo ide e tyre nuk është funksionale. Valonët frëngjishtfolës në Belgjikë e kanë ndjenjën e tyre të identitetit të lidhur me simbolet e përbashkëta të atyre franceze në Francë, sikurse simboli i gjelit, apo flamuri ***bleu blanc rouge.*** Edhe pse kanë lojalitet ndaj shtetit federativ belg, respektojnë shtetin e tyre, punojnë për atë shtet. Ata nuk shfaqin mendime për krijim të gjuhës valone, siç nxitojnë të deklarojnë disa analistë shqiptarë nga Kosova për një gjuhë kosovare. Frëngjishtfolësit nga Belgjika apo Zvicra kanë lidhje direkte me shtetin e Francës për shumë çështje, madje Franca ka ndikim direkt në këto shtete. Këto shtete kanë gjuhë zyrtare frëngjishten, janë tubuar përkrah frankofonisë si dhe gjuhën e kanë të institucionalizuar. Shqiptarët ende nuk janë faktor për të institucionalizuar gjuhën e tyre, sepse ende nuk janë faktorë apo pjesë e ndonjë organizate sikurse UE-ja, apo ndonjë organizatë tjetër sikurse frankofonia, e leje më shteti i ***Teoria e Smithit se kombi është vetëm një hap larg të qenit shtet.***[49] Kosovës dhe thirrjet për krijim të identitetit gjysmak kosovar apo gjuhës kosovare. Teoria e Smithit nuk përkon me realitetin e shqiptarëve, sepse ndjekja fjalë për fjalë e kësaj pikëpamje smithiane nga ane e disa shqiptarëve nga Kosova apo edhe nga vise të tjera të banuara me shqiptarë është e gabuar, sepse kombi shqiptar është i konsoliduar nga pikëpamja kombëtare dhe gjuhësore. Ajo që po konsolidohet në Kosovë janë institucionet politike dhe sistemi politiko-institucional. ***E kjo nuk do të thotë se kjo arsyeton tezën për krijim të identitetit kombëtar kosovar apo gjuhës kosovare, sepse kjo do të ishte një goditje e fortë për shqiptarët e Maqedonisë, Malit të Zi si dhe luginës së Preshevës dhe Bujanocit.*** Identiteti kombëtar shqiptar nuk mund të fragmentarizohet duke u bazuar në rajone apo qytete, sepse nëse do të ishte ashtu, atëherë shqiptarët do të fillonin të përçaheshin edhe më tutje duke krijuar gjuhën kosovare, gjuhën preshevare, kumanovare, tetovare e kështu me radhë. Identiteti kombëtar te shqiptarët është ndërtuar qysh moti, para se të formësohet shteti tek shqiptarët. Andaj edhe kjo thirrje besoj se do të ngelet vetëm thirrje për të dal ndokush nga anonimiteti. Nacionalizmi shtetëror nuk duhet të shërbejë për shqiptarët si udhërrëfyes i verbër, në vend të tij nacionalizmi gjuhësor, kulturor apo kombëtar duke u bazuar tek të qenit shqiptar është më se i nevojshëm dhe nuk ka nevojë të rishikohet, sepse kemi punë të tjera për të bërë. Iniciativa për një shqipe standarde nga ASHAK e Kosovës ***(Koha ditore, 26 qershor 2004)*** për krijimin e dy varianteve të shqipes nuk

[49] http://fr.wikipedia.org/wiki/Adam_Smith

përkon me realitetin, sepse dihet historikisht se shqiptarët janë ndarë në disa shtete si pasojë e politikave të mëdha, andaj imponimi i fragmentarizmit shqiptar në aspekt gjuhësor dhe kulturor do të sillte shthurjen totale kombëtare të tyre. Krahas prejardhjes së përbashkët, gjuha shqipe, pavarësisht veçorive dialektore, ka qenë themelore dhe është edhe më tej karakteristike për identitetin kombëtar shqiptar, për mbijetesën e tij në shekuj gjatë pushtimeve të ndryshme, apo edhe pas ndarjes së padrejtë të shqiptarëve në disa organizime shtetërore. ***Sipas të madhit Gjergj Fishta, gjuha ka qenë përcaktuese për kombin shqiptar.*** Kjo si e tillë ka qenë sepse kjo gjuhë nuk flitet nga askush tjetër, buron nga gjuha pellazgo-ilire dhe ka ndikim edhe tek krijimet e kombeve dhe gjuhëve të tjera evropiane. Sipas Fishtës, gjuha imponohet ose me forcë të armëve, ose me forcë të kulturës apo qytetërimit, pra është analogjike me doktrinën franceze Risheljane për imponim me qytetërim dhe me gjuhë. Shqiptarët përulen ndaj figurave historike nga cilido rajon i banuar me shqiptarë, ndjenjën e përuljes ndaj shqiponjës e kanë permanente, e andaj nuk ka nevojë që kjo ndjenjë e kultivuar me shekuj të thyhet brenda natës nga nevojtarët e daljes nga anonimiteti. Shqiptarët me gjithë praninë e dy shteteve, dhe me prezencën e tyre në disa organizime shtetërore duhet të jenë lojal ndaj gjuhës, flamurit kombëtar, si dhe të kenë të qartë thënien e Manjanit i cili e quan gjuhën shqipe: ***"Gjuhë të mrekullueshme që i përngjan një vendburimi të pasur, mbi të cilin mjafton të përkulesh, si dhe të mbledhësh kokrriza ari filologjik".***[50] Gjuha shqipe si gjuhë Japetike, si gjuhë e folësve të racës së bardhë dhe djalit të Nohut, duhet të mbetet e vetmja gjuhë për shqiptarët. Sepse gjuha kosovare do të ndikonte në krijimin e gjuhëve maqedono-shqiptare, preshevare etj, pra në krijim të gjuhëve të bazuar në organizime shtetërore. Kurse, valonët e Belgjikës dhe frëngjishtfolësit e Zvicrës, thonë se flasin gjuhën frënge e jo atë belge, apo zvicerane, pra nuk bazohen në gjuhë sipas organizimeve shtetërore.

Andaj tentativa për identitet kosovar, gjuhë apo kulturë kosovare e bazuar në përçarjen e shqiptarëve, në humbjen e orientimit të tyre, në humbjen e kohezionit kombëtar është rrezik jo vetëm për thyerjen e kombit shqiptar anembanë viseve ku jetojnë ato, por edhe si pengesë për kyçje në UE dhe organizatat tjera. Por, tentativat e tilla janë dëshmuar se janë vetëm tentativa të individëve që kanë nevojë të njihen nga të tjerët, përmes tezave dhe hipotezave të gabueshme, si dhe si ide që do të mbeten vetëm si gjurmë të një ***"tentative" alogjike dhe absurde.*** Tentime të tilla ka pasur nëpër shekuj nga sunduesit sllavë, të cilët kanë dashur t`i ndajnë shqiptarët në shqiptarë të mirë dhe të këqij sipas rajoneve ku jetojnë, a dihet se këto rajone vijnë si pasojë e ndarjes së shqiptarëve nëpër Vilajete nga ana e Osmanëve. Pra, këto tentime kanë mbetur vetëm tentativa dhe nuk kanë pasur efekt. Andaj edhe këto tentime të këtyre lloj analistëve janë dhe do të mbesin pa efekt dhe do të venitën. Ndërsa, nevoja e pasurimit të gjuhë shqipe është më se e domosdoshme, sepse ajo duhet të pasurohet si e tillë, e ndoshta të rishikohet ndonjëherë, por nuk duhet të humbë bërthamë e saj të ndërtuar me aq shumë mund nëpër shekuj, e në veçanti nga ideologët e Rilindjes Kombëtare, ndërkaq e standardizuar në nëntor të vitit 1972, me Kongresin e Njësimit të Gjuhës Shqipe, mbajtur në Tiranë.

Tetovë, 01 qershor 2009

[50] Kocaqi, Elena, Roli pellazgo-ilir në krijimin e kombeve dhe gjuhëve evropiane, Dajti 2000, Tiranë 2007, fq. 6

KOMBI SHQIPTAR PËRBALLË SFIDAVE TË JASHTME DHE TË BRENDSHME

Njëri prej popujve më të vjetër dhe autokton të Ballkanit është padyshim populli shqiptar, i cili i kishte banuar këto vise shumë vite më përpara se të vinin ardhacak të ndryshëm dhe të popullonin këtë territor, duke sjell ndryshime të konfiguracionit territorial, demografik dhe politiko-historik. Pa dyshim se dihen rrethanat historike të cilët sollën batica dhe zbatica për këtë komb, por pa mëdyshje mund të thuhet se shqiptarët si popull dhe si komb, u formësuan shumë përpara bekimit të shtetit të tyre. Ata të përkushtuar ndaj gjuhës, gjakut, flamurit dhe ndjenjës për të jetuar të lirë dhe të bashkuar si çdo popull apo komb, kishin vokacionet e tyre për të jetuar nën një shtet të vetëm. Por, diplomacitë e ndryshme të asaj kohe, sollën vendime në dëm të këtij kombi të fragmentarizuar në më shumë shtete. Ajo që i parapriu më shumë këtij fragmentarizmi ishte mosunifikimi i faktorit politik shqiptar, e që solli një humbje të dhembshme në Kongresin e Berlinit,1878, në Konferencën e Paqes në Londër 1913 dhe në Versajë. Sido që të jetë, ky komb i pastër etnikisht, me gjurmë të thella në histori, pasardhës i banorëve të parë të Ballkanit si pellazgët dhe ilirët, ka arritur që t`i mbijetojë dhe t`i bëjë ballë shumë sfidave dhe pushtuesve të ndryshëm. Ky komb i cili është i shpërndarë në disa shtete, nuk ka reshtur së qeni i sfiduar nga shumë faktorë të jashtëm dhe të brendshëm. Ata kanë ndikuar direkt ose indirekt në mirëqenien e këtij kombi. Gjuha e kombit shqiptar, gjuha shqipe, është njëra prej gjuhëve bazë të kontinentit evropian. Llogaritet si njëra prej 5 apo 6 gjuhëve bazë të këtij kontinenti, ndërsa si njëri prej 10 apo 12 gjuhëve të botës. Më të drejtë studiuesja e njohur nga Shqipëria, Elena Kocaqi, e rendit këtë gjuhë si njërën prej më të vjetrave si dhe si një uverturë për formësimin e gjuhëve dhe kombeve tjera evropiane. Ky komb i cili karakterizohet i vogël në krahasim me disa kombe tjera, për së pari herë në historinë e tij po përjeton ditët më të mira dhe më të lumtura. I gjendur me dy shtete, atij të Shqipërisë, të Kosovës, i parë si faktor relevant në Maqedoni dhe në atë që njihet si Lugina e Preshevës, pa marrë parasysh injorimin nga disa të tjerë, mund të thuhet se është faktor i stabilizimit në Ballkan. Nacionalizmi i këtij kombi nuk është vrastar, nuk ka shfaqur kurrë pretendime territoriale apo shovinizëm, për dallim prej nacionalizmit serb apo atij grek që institucionalisht dhe historikisht ka qenë vrastar. Nacionalizmi serb i konvertuar në shovinizëm kërcënoi për vdekje qenien shqiptare. Fatmirësisht, një gjë e tillë nuk ndodhi, falë vigjilencës sonë dhe botës demokratike. Kombi shqiptar, pas rënies së komunizmit, u kthye aty ku e kishte vendin, në aleancë me Evropën Perëndimore dhe SHBA-të, vendin e demokracisë. Guximi, idealet dhe ndihma e tyre solli këtë komb si komb faktorizues në Ballkan, arriti çlirimin e Kosovës, arriti futjen e Shqipërisë në NATO, e nesër besa edhe në BE, arriti avancimin e pozitës së shqiptarëve në Maqedoni etj. Por, kombi shqiptar, sot gjendet përballë disa sfidave sa të rrezikshme, po aq edhe sfiduese. Kombi shqiptar, përballë sfidave të jashtme dhe të brendshme duhet të dijë se si të manovrojë me sukses. Përballë sfidave të jashtme ai ka përballë nacionalizmin serb, i cili ende është i padenacifikuar, kërcënon edhe më tutje Ballkanin dhe shtetin e ri të Kosovës, e kësisoj shqiptarët në tërësi. Diplomacia serbe e përkushtuar me çdo kusht në lobim kundër njohjes së pavarësisë së Kosovës, përmes përkrahjes së strukturave paralele serbe në Kosovë, përmes margjinalizimit të shqiptarëve të Luginës së Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit, përmes oscilacioneve të ndryshme është sfidë për kombin shqiptar. Përballë këtij kombi gjendet e ashtuquajtura çështja çame e cila rri

pezull, dhe nuk faktorizohet, edhe pse shteti i cili pretendon të jetë demokratik Greqia, mban pa të drejtë popullsinë çame në mëshirën e fatit, pa mos i njohur të drejtat elementare. Kombi shqiptar përballë duhet të ketë edhe sfidën tjetër, atë të ndihmesës dhe mbështetjes së shqiptarëve në Turqi, për mos t`u asimiluar shqiptarët atje. Këtë të drejtë duhet kërkuar nga e drejta e krijimit të njëfarë Albafonie, organizatë kjo e cila do të rigruponte shtetet që kanë popullsi që flasin gjuhën shqipe dhe që janë shqiptarë. Kjo lloj organizate duhet të funksionojë sipas modelit të Frankofonisë. Kombi shqiptar përballë ka edhe sfidën e shtetit me këmbë të qelqta FYROM, ku shqiptarët atje duhet medoemos të kërkojnë me ngulm të drejtat e tyre natyrore, përndryshe duhet të kërkohen alternativa të tjera si federalizmi apo ndonjë formë tjetër e rregullimit kushtetues. Ky komb përballë ka edhe sfidat eurointegruese dhe euroatlantike, shkëputjen nga e kaluara komuniste si dhe hyrjen në familjen e kombeve të lira. Kombi shqiptar përballë tij si sfidë të brendshme ka unifikimin ndërshqiptar, në aspekt politik, ekonomik, gjuhësor, arsimor. Ky komb duhet të synojë unifikimin e strategjive dhe qëllimeve të përbashkëta, vijimin e një politike kohezive. Kombi shqiptar përballë ka konceptin monstër të disa pseudoanalistëve si "kombi apo gjuhë kosovare". Kombi shqiptar duhet të luftojë këtë sajesë të rrezikshme dhe armiqësore, sepse ajo sjell përçarjen dhe ndarjen e mëtutjeshme ndërshqiptare. Kombi shqiptar përballë ka heqjen e barrierave ndërshqiptare në çfarë do qoftë fushe qofshin ata, forcimin e ekonomisë, krijimin e mundësive për një lëvizshmëri dhe fleksibilitet më të madh ndërshqiptar, dhe këmbimet e ndryshme akademike, studentore ndërshqiptare. Kombi shqiptar përballë ka edhe një sfidë tjetër, iniciativat haxhiqamiliste që vijnë përbrenda tij, të ndihmuara nga qarqet e ndryshme sllave, greke apo qarqe tjera armiqësore antishqiptare. Tendenca e disa individëve haxhiqamilistë, të cilët dalin dhe deklarojnë publikisht: "Shqiptarëve nuk i duhet Evropa dhe Amerika" sa janë djallëzore, po aq janë edhe armiqësore. Shqiptarëve i duhet Evropa dhe Amerika më shumë se kurrë sot. Përndryshe ekzistimi ynë si shqiptar është në pikëpyetje. Dilema se a duhet të synojmë Perëndimin apo Lindjen e shtruar si dikotomi, nuk është e nevojshme, sepse dihet se ***shqiptarët janë Evropa dhe Perëndimi vet.*** Ata kanë kontribuar në konfiguracionin e këtij kontinenti të vjetër e të lashtë deri atëherë kur nuk u pushtua ky kontinent nga fiset e egra prej Karpateve, si dhe nga pushtuesit tataro-mongole osman. Ky kontribut vazhdon edhe më tutje të jetë i madh dhe pa ndërprerje. ***Prirjet haxhiqamiliste të disa shqipfolësve, të cilët deri dje kanë qenë ose bashkëpunëtorë të sigurimeve shtetërore të UDB-së, apo janë aksidentalisht fëmijë të bashkëpunëtorëve, këta faqezinjë dalin dhe pa fije turpi deklarojnë se Evropa dhe Amerika janë kundër nesh, madje marrin edhe guximin të deklarojnë se figurat historike kombëtare si Gjergj Kastriot-Skënderbeu, Nënë Tereza, Leka i Madh etj., janë figura antikombëtare, sepse na qenkan të krishtere.*** Çfarë gojëligësie e turpshme. Këta shqipfolës, duke u nisur gjoja se nga aspektet fetare, që aspak nuk i kontestoj, por që janë aspekte të marra qëllimisht me gabim, nuk pushojnë së deklaruari se shqiptarët nuk kanë nevojë për këta personalitete, që na bërën të njihemi ndërkombëtarisht. Kombi shqiptar duhet detyrimisht t`i luftojë këta forca të errëta, që tentojnë të fusin përçarjen ndërshqiptare në bazë të feve. Kombi shqiptar duhet të luftojë me çdo kusht iniciuesit e një Shën Bartolomeu ndërshqiptar, iniciuesit e një sllavizimi të figurave tona historike kombëtare. Kombi shqiptar duhet të promovojë shumëllojshmërinë ndërfetare, duke mos cenuar aspak të drejtat fetare ndërshqiptare ose të drejtat fetare të kombeve tjera. Shqiptarët sot edhe pse me shumicë myslimane, nuk duhet të shikojnë me sy armiqësor shqiptarin katolik ose

ortodoks. Kjo sfidë duhet patjetër të sfidohet nga kombi shqiptar. Ndërsa, tentativa haxhiqamiliste ndër shqiptarët duhet të luftohet me mish e me shpirt, prirjet otomane të disa shqipfolësve që synojnë ndarjen e kombit shqiptar në Vilajete duhet të hidhen së bashku me to në koshin e plehërave dhe fundërrinave. Përndryshe do na mallkojë Zoti, të parët tanë dhe pasardhësit tanë. Kombi shqiptar duhet të mos gjendet përballë dilemës poashtu të disa heretikëve dhe qarqeve ortodokse progreke, që u pengojnë xhamitë e larta, e nuk ju pengojnë kryqet gjigante përballë shumicës myslimane, që ju pengojnë marrëdhëniet e mira me Turqinë, përderisa ky shtet është duke ndihmuar aktivisht shtetin e ri të Kosovës si dhe Shqipërinë (së fundi projekti i fundit i rrugës Durrës-Kukës). Pra, kombi shqiptar duhet t`i japë përparësi prezencës së shumëkonfesionalitetit, të respektojë kultet e besimit, të ndërtojë xhami, por në anën tjetër nuk duhet të rrënojë kisha, ose duke ndërtuar kisha të rrënojë xhami, sepse në kompozicionin e tij ka edhe pjesëtarë myslimanë edhe të krishterë. Kombi shqiptar duke i dhënë përparësi ndjenjës së pastër kombëtare, kohezionit ndërshqiptar, respektimit të dallimit fetar, librave të shenjtë fetarë dhe të tempujve të shenjtë fetarë, mbrojtjen e këtij dallimi, mbrojtjes së pastërtisë gjuhësore dhe etnike, ngritjes dhe mbrojtjes së personaliteteve të famshme historike shqiptare, pa marrë parasysh se a janë ***myslimanë (Naim Frashëri, Hoxhë Tahsini, Ymer Prizreni, Adem Demaçi, Adem Jashari, etj), katolikë (Skënderbeu, Gjergj Fishta, Nënë Tereza, etj) apo ortodoksë (Papa Kristo Negovani, Fan Noli, etj),*** do të jetë detyrimisht i suksesshëm dhe me ndikim në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Tjetër alternativë nuk ka. Nëse ka, urdhëroni e potenconi.

Kumanovë, 01 korrik 2009

(MESKAPITULL)

(MAQEDONI)

"UNË DI QË ASGJË NUK DI"

Me të vërtetë ishte tejet shokuese dhe flagrante deklarata e bërë për media e liderit të BDI-së, z. Ali Ahmeti, për televizionin ***ALSAT,*** se kinse për dhunën dhe terrorin shtetëror në Shkup dhe Kumanovë, të kryer nga njësiti policor ***ALFA,*** ai nuk ka kurrfarë faktesh dhe argumentesh konkrete. Ai nuk e din këtë. Ai nuk e di se gjendja në qytetin e Kumanovës me rrethinë është tejet e tensionuar, sepse qytetarët provokohen pareshtur. Maltretohen dhe rrehen me arsyetimin se gjoja nuk mbajnë letërnjoftime si dhe për shkak se kanë veturat me regjistrim të Kosovës. Pra, i pengon ALFAVE regjistrimi kosovar. Maltretohen në emër të vendosjes së rendit dhe ligjit në qytetin i cili u bë bastion i rezistencës së vitit 2001 dhe i cili fatkeqësisht ju solli ju dhe partinë e juaj në qeveri. E ju prapë vazhdon të mos e dini. Prapë nuk e dini se ushtrohet dhunë. Prapë nuk e dini se maltretohen qytetarët shqiptarë, ose nuk keni fakte për këtë. Nuk ju mjaftuan deklaratat dhe inçizimet në televizion që edhe nxënësi i shkollës fillore i din e ju nuk dini asgjë. Merreni me përkujdesjen e të vdekurve duke vendosur memorialë përkujtimore, e të gjallët i keni harruar krejtësisht. Merreni me vendosje të memorialëve e të gjallët i shikoni dhe i mbikëqyrni duke i maltretuar, përdhosur dhe dënuar. Merreni me komplekse memorialë duke bërë promovimin tuaj si hero dhe duke e vendosur edhe emrin tuaj nëpër përkujtimoret e dëshmorëve dhe martirëve (rasti konkret në Sopot) e këndej nuk merreni absolutisht, aspak me rastin e Sopotit, ekzekutori i të cilit rast ishit edhe ju. Çirreshit gjatë kohës kur ishit në opozitë për rastin e Brodecit, manipuluat me ata njerëz të gjorë, e tash jeni strukur në selinë tuaj dhe nuk ju dëgjohet zëri për këta njerëz. Premtuat rehabilitim të luftëtarëve dhe invalidëve të luftës, ndërsa ata çdo ditë jo vetëm që dënohen, por edhe internohen dhe poshtërohen skajshmërisht. Fundja, dënohen edhe deputetët e partisë suaj. E ju ende nuk e dini këtë. Shtroj pyetjen se kur nuk mundët t`i mbroni deputetët e juaj nga dënimi, atëherë çfarë potence do të keni që t`i mbroni të tjerët shqiptarë nga maltretimet. Premtuat çudira, ndërsa çuditët tërë shqiptarët me veprimet dhe deklaratat e juaja të mjera se nuk dini asgjë. Koalicioni po ju funksionon shumë mirë. Ashtu deklaruat, të paktën ju zotrote. Ndërsa nuk përmendni dhe nuk e shihni faktin se jeni poltronizuar dhe servilizuar skajshmërisht, sepse pranuat PRERODBËN e Gruevskit, duke mbyllur apo mos i hapur çështjet etnike të shqiptarëve në Maqedoni; duke mos e zgjidhur statusin e gjuhës shqipe; duke prolonguar bashkimin e qytetit tuaj ku keni lindur ju: duke bashkëqeverisur me njeriun i cili i mbyll çdo ditë shqiptarët. U zotuat se do të angazhoheni për shpërbërjen e ALFAVE, e me hyrjen në qeveri, lëre që nuk guxuat të përmendni një gjë të tillë, por thjesht edhe nuk dini, sepse nuk keni argumente, se ushtrohet dhunë po nga ky njësit. Krekoseni me veprimet e juaja e në anën tjetër e lejoni rrënimin e Institutit të Trashëgimisë Kulturore të Shqiptarëve. U zotuat ju dhe njerëzit e juaj se do të hapni shkolla dhe do të bëni çudira e nuk shihni se arsimi në zonat shqiptare është buzë katastrofës. Krekoset ministri i juaj me hapjen e fakulteteve në Kumanovë e nuk mendoni fare se ai objekt i fakultetit është objekt i adaptuar. Poashtu edhe shkollat e mesme shqipe në Kumanovë janë në objekte të adaptuara pa kurrfarë hierarkie menaxhuese dhe pa kurrfarë peshe vendimmarrëse. Premtoni realizimin e Marrëveshjes

së Ohrit, del zëvendëskryeministri i partisë tënde dhe thotë se 95 % e Marrëveshjes është realizuar e ende nuk keni bërë asnjë punësim të shqiptarëve dhe e keni varrosur këtë marrëveshje. Organizuat spektakël me rastin e 28 Nëntorit në Sheshin e Skënderbeut në Shkup, e këtë spektakël ALFAT e shndërruan në spektakël tragjik ditën e 28 Nëntorit duke rrahur pa mëshirë të rinjë shqiptarë e ju nuk e dini këtë. Edhe të vdekurit e kuptuan se ç`po ndodhë e ju nuk keni argumente konkrete për ato që po ndodhin. Ose shtirreni se nuk i keni ato argumente apo nuk i dini. Por e di që s`keni faj ju. Pranuat të shndërroheni në shërbëtorë dhe tani vetëm bëni sehir. Sepse ju mungon potenca. Ja siguruat fitoren VMRO-së në zgjedhjet e parakohshme parlamentare, u shpërblyet për këtë me hyrjen dhe servilizmin tuaj në qeveri, e tani partneri i juaj strategjik ka filluar misionin e madh të disiplinimit të zonave të luftës, me arsyetimin e gjoja kapjes së strukturave kriminale, ndërsa strukturat kriminale i ka pjesë të qeverisë lokale dhe shtetërore. U betuat për flamur dhe për komb, ndërsa njerëzit e tu çdo ditë nëpër media sulmojnë personalitete që kontribuan në ruajtjen e flamurit kombëtar, që u sakrifikuan dhe u persekutuan mizorisht. E ju heshtni, sepse nuk doni të flisni. Zonat ku jetojnë maqedonasit janë shndërruar në zona oksidentale me të gjitha premisat e duhura dhe shkallë të lartë të urbanizimit e zonat shqiptare janë ruralizuar aq shumë, sikur të bën përshtypje se jemi në Zimbabve. E ju nuk e dini këtë. Por shpresoj se një ditë do të mësoheni se si të dini dhe do të dini patjetër, sepse ***"Tempus omnia revelevat" (Koha i zbulon të gjitha).*** Si dhe një porosi tjetër për ju dhe njerëzit tuaj **"E ardhmja mbetet çdoherë e hapur".**

E përfundoj shkrimin tim me një thënie shqiptare e besoj se e kuptoni ju këtë ***"Populli të bën vezir, populli të bën rezil"*** , ***sepse popullin mund ta mashtrosh për një kohë, por jo për tërë jetën.***

Kumanovë, 05 dhjetor 2008

"ZGJEDHJET PA ZGJIDHJE"

(Reagim ndaj shkrimit, "Zgjedhjet dhe zgjidhja" të autorit dhe mikut tim, Iljasa Salihu)

Pas mbajtjes së zgjedhjeve të shumëkërkuara, pas "fitores" dhe hyrjes në Qeveri të partisë së BDI-së u mendua se gjithçka do të shkonte mirë. Në fakt u mendua nga disa njerëz poltronë dhe servilë, sepse pjesa e shëndoshë intelektuale e dinte se si do të rrjedhin punët, sepse skenari ishte i përgatitur mirë dhe ishte efikas. Kishte vetëm një qëllim, largimin e PDSH-së nga pushteti dhe ngritjen e popullaritetit të partisë VMRO-DPMNE dhe të kryetarit dhe kryeministrit aktual, Nikolla Gruevski. Këtë skenar e mendoi dhe e planifikoi shumë mirë kryeministri Gruevski por, me ndihmën e partisë së atëhershme opozitare, BDI. Dhe vetëm për arsyen se kjo parti ishte "problematike", hynte dhe dilte kur donte prej Qeverisë dhe i bënte presione dhe probleme Gruevskit. Ndërsa qëllimi u arrit, u ndryshua konfiguracioni qeveritar pas mbajtjes së zgjedhjeve, por moszgjidhjet u shtuan edhe më shumë nga çfarë ishin më parë. Pse? Sepse partia e dalë nga lufta çapitej të hynte në Qeveri duke u poltronizuar dhe u servilizuar skajshmërisht dhe duke e pranuar "Prerodbën" e Gruevskit pa as më të voglin hezitim. Dhe këtë e bëri vetëm për hyrje në Qeveri dhe për disa poste shumë minore. Por, fatkeqësia më e madhe është se sot zëri i intelektualëve është aq i ulët, saqë nuk të bën përshtypjen fare. Për hir të ndonjë vendi të punës intelektualët janë strukur dhe pas shkrimeve aty këtu të disave vërehet nga intelektualët një venitje dhe një heshtje vrastare. Heshtje atëherë kur duhet të flitet dhe të përflitet. Gjumë atëherë kur duhet qenë syhapur. Teori dhe retorikë boshe atëherë kur duhet vepruar. Poltronizëm dhe oportunizëm atëherë kur duhet kritikuar veprimet e gabueshme, bile edhe antishqiptare. Por, me sa shohim, kjo nuk ndodh. Andaj e pash të udhës që të marr guximin dhe të shkruaj pa më të voglën mëdyshje për t`i thënë gjërat troç ashtu siç duken edhe në shikim të parë. Në një shkrim të titulluar "Zgjedhjet dhe zgjidhja" autori Iljasa Salihu shkruan me gojën plot se partia e dalë nga lufta është BDI. Një sqarim zotëri Salihu. BDI nuk është parti e dalë nga lufta, sepse luftën e vitit 2001 nuk e bëri BDI, por e bënë shqiptarët. E bëre edhe ti së bashku me to. Por për liri dhe barazi e jo për BDI. Luftën e 2001-shit e bëri edhe komandant ***"Tigri"*** edhe komandant ***"Teli".*** Por ato nuk ishin atëherë BDI. E nuk janë as sot. Luftën e bënë të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen. Secili kishte kontributin e vet. Por të gjithë shqiptarët nuk janë BDI. Andaj mos tento t`ia mveshësh meritat dikujt që si takon. Në shkrimin tuaj thoni gjithashtu se zgjedhjet e korrikut i fitoi bindshëm BDI-ja. Zotëri Salihu, këto zgjedhje i fitoi VMRO-DPMNE-ja, ndërsa i humbën shqiptarët. Andaj, mos u mundo të shpallësh triumfues partinë e cila viktimizoi kërkesat legjitime shqiptare vetëm për hyrje në Qeveri. Në shkrimin tuaj ju thoni më tej, citoj: **"Pas 4 muajve qeverisje, kjo parti (e keni fjalën për BDI-në) arriti të shpallë konkurs (i cili konkurs do ta jetësohet në praktikë shumë shpejt) për pranimin e 570 nëpunësve shqiptarë. Shpresat e popullatës për këtë parti, bazohen në atë se, kjo parti rrënjët i ka nga lufta, apo thënë më mirë është pjellë e kryengritjes së armatosur."**

Për çfarë shpresash flet? Nuk e di nëse se keni të qartë apo shtirreni se kinse nuk e keni, por mos tento t`ia veshësh suksesin BDI-së, sepse me punësim të disa shqiptarëve nuk është arritur absolutisht asgjë, pra nuk është zgjidhur çështja shqiptare në Maqedoni. "Sepse ai popull i cili jeton për një vend pune është i destinuar të shkatërrohet, kurse

populli i cili punon që të jetojë, do të jetë themelues i stilit të ri të jetës, kulturës së re dhe njerëzimit të ri.” Pse nuk është zgjidhur si dhe pse pas zgjedhjeve nuk kemi zgjidhje. ***E para,*** sepse u trumbetua me pranim të pavarësisë së Kosovës fill pas mbajtjes së zgjedhjeve, e kjo ndodhi shumë vonë, edhe atë falë intervenimit të faktorit të jashtëm, respektivisht falë intervenimit të Ambasadorit Ryker dhe përfaqësuesve tjerë amerikanë dhe evropianë. ***E dyta,*** kemi koalicionin me njerëzit të cilët Gruevski i qetësoi dhe i servilizoi me poste “drejtuese” apo me poste in-ekzistente, sepse ata u bënë pjesë e Qeverisë Gruevski pa kurrfarë platforme duke e përkrahur “PRERODBËN “ e Gruevskit, e duke i harruar dëshmorët, invalidët, martirët, zonat e luftës (shembullin më të mirë e ke rastin e komunës së Likovës, ku njerëzit aktual të komunës që janë pjesë e BDI-së së dal nga lufta, nuk investuan asgjë për këtë komunë të dal nga lufta e çorientuar dhe e varfëruar skajshmërisht) Këtë gjë ata “e harruan” edhe gjatë mandatit qeverisës 2002-2006. Ndërsa thirren në emër të luftës. ***E treta,*** ata u bënë pjesë e Qeverisë Gruevski duke harruar lirimin e të burgosurve të Brodecit për të cilët çirreshin kur ishin në opozitë. ***E katërta,*** ata sollën ligjin diskriminues për përdorimin e gjuhës shqipe për shumë pak minuta duke e nënçmuar shqipen, rrënuan Institutin e Trashëgimisë Shqiptare i cili u krijua me mund gjatë qeverisjes së PDSH-së, hapën dosjet e Hagës, apo pranuan hapjen e dosjeve të Hagës, hapën procedurë gjyqësore ndaj deputetëve të saj, prej të cilëve njëri dënohet me burgim, deklaruan se Marrëveshja e Ohrit ka përfunduar, pra është finalizuar me sukses e këtë e din secili, por edhe ti,anashkaluan kulturën shqiptare, ndaluan investimet në zonat shqiptare, hapën rastet e Hagës, dhanë urdhër për burgosje të deputetit pjesëmarrës në luftën e 2001-shit.... Shtrohet pyetja se kur Ali Ahmeti dhe njerëzit e tij nuk mbrojtën deputetët e vet, si mund ai dhe ata të mbrojnë nga ndjekja dhe gjykimi një ushtar të thjeshtë (e ushtar ke qenë edhe ti vet) apo një shqiptar. Kjo flet për shndërrimin e BDI-së në parti kukull në Qeveri. Dhe vërteton se edhe pse fitoi shumicën e votave shqiptare, ajo nuk është e denjë të mbrojë shqiptarët nga trajtimi anashkalues dhe nënçmues i maqedonasve dhe i nacionalistëve të VMRO-së. U vërtetua se ajo nuk i fitoi zgjedhjet. Por zgjedhjet i fitoi “VMRO-DPMNE”. Këtu ia shtojmë edhe zvarritjen e njohjes së Kosovës. Njohja e Kosovës do të bëhej e mundur vetëm pas shumë përpjekjeve diplomatike dhe presioneve ndërkombëtare ndaj kryeministrit kryeneç, Nikolla Gruevskit. Ishin konkretisht këto presione të amerikanëve dhe evropianëve, ndërsa presionet e partive politike shqiptare, e konkretisht ato të partisë së ”dalë nga lufta” as nuk i lëkundnin syrin Gruevskit. Në anën tjetër kemi problemin e këtij shteti problematik me Greqinë për shkak te kontestit me emrin. Partia shqiptare në pushtet në vend që të interesohet për pjesëmarrje direkte në bisedime për emrin, sepse është parti fituese në taborin politik shqiptar, ajo deklaratatë i jep edhe më në favor të mosndryshimit të emrit, thuajse mbron më shumë interesat nacionale maqedonase se sa ato shqiptare? Ndërsa për një emër mban peng dëshirat e popullatës shqiptare, por edhe atë të komuniteteve tjera për mosinkuadrim në familjen euro-atlantike. Është edhe sot e kësaj dite befasues fakti se pse BDI dhe figurat e saja nuk u përfshinë në debatin për emrin apo pse u anashkaluan kur dihet se komuniteti shqiptar është faktorë relevant në Maqedoni. Aktualisht pra, kemi pas zgjedhjeve, shumë moszgjidhje, e jo zgjidhje ashtu siç mëton t`i të shkruash dhe të paraqesësh, pra kemi problemin ende të emrit të këtij shteti i cili mbahet peng, moszgjidhjen ende të statusit të ish luftëtarëve shqiptarë, cungimin e gjuhës shqipe, prolongimin e bashkimit të komunës së Kërçovës, problemet me arsimin e mesëm ku për një nxënës në territoret maqedonase hapen shkolla dhe

punësohen arsimtarë, ndërsa në territoret shqiptare pothuajse në secilin qytet kemi probleme me shkollat e mesme. Kësaj ia shtojmë edhe ligjin diskriminues për stimulimin e lindjeve vetëm në qytetet maqedonase, e jo në ato shqiptare. Ndërsa faktori politik shqiptar në qeveri bën sehir dhe bën konferenca për shtyp ku deklaron se gjithçka është në rregull, raportet janë në nivel, kemi arritur 95 % e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, ndërsa në anën tjetër ministrat shqiptarë të partisë "së dal nga lufta"anashkalohen nga zëdhënëset. Poashtu ministrat shqiptarë anashkalohen edhe nga kryeministri, kemi rastin konkret të anashkalimit të ministrit shqiptar, z. Musa Xhaferi. Ndërsa prapë BDI është në Qeveri dhe çapitet të deklarojë se ka realizuar 95 % të Marrëveshjes së Ohrit, se ka punësuar numër të madh të shqiptarëve, se punët janë shumë mirë. Ndërsa ju deklaroni dhe shkruani se me punësimet e bëra është arritur sukses. Pra, mburresh me një gjë që *është shumë minore. Kjo e vërteton edhe njëherë thënien:* ***"Jepuni gjithçka shqiptarëve si individ, mos u jepni asgjë shqiptarëve si komb".***[51] Por, ***"Tempus omnia revelevat" (Koha i zbulon të gjitha).*** Si dhe një porosi tjetër për qeveritarët aktual dhe poltronët e tyre ***"E ardhmja mbetet çdoherë e hapur".*** E përfundoj reagimin tim apo më mirë të them shkrimin tim me një thënie shqiptare e besoj se e kupton ti dhe të tjerët se përse bëhet fjalë ***"Populli të bën vezir, populli të bën rezil,"*** sepse popullin mund ta mashtrosh për një kohë, por jo për tërë jetën.

Kumanovë, 6 nëntor 2008

[51] E marrur nga thënia: Jepuni hebrenjve çdo gjë si individ, por asgjë si komb- Stannislas De Clermont-Tonerre

Pjesa e tretë

(KOSOVË)
17 SHKURTI – REALITET DHE GËZIM I SHKURTËR

U bë më se një vit që kur shqiptarët e tërë trojeve etnike të Shqipërisë Natyrale apo të pesë Shqipërive e pritën me gëzim të papërshkruar leximin e Deklaratës së Pavarësisë së shumëpritur të Kosovës. Kishin kaluar vite të shumta, shekuj që kur kjo ide u realizua ashtu në dukje. Ishte një dëshirë e cila për shumë vite me radhë ishte vetëm një ëndërr e mirë e shumëpritur nga shqiptarët që të ndodhë. Dhe më në fund ndodhi. U bë Pavarësia e këtij shteti, e kësaj Shqipërie të dytë e cila ishte e ndarë padrejtësisht për shumë vite me radhë nga trungu i Shqipërisë Natyrale. U bë falë përpjekjes shumëvjeçare të shqiptarëve të të gjitha trojeve etnike, u bë falë luftës çlirimtare të UÇK-së, u bë falë intervenimit të NATO-s në krye me shtetin që e konsiderojmë mik permanent të përhershëm, SHBA-të. ***17 shkurti do të vuloset për shumë vite me radhë si dita kur u kurorëzua me sukses shteti i dytë i shqiptarëve në Ballkan. 17 Shkurti do të mbahet në mend si dita kur shqiptarët thyen parcialisht murin që i ndante padrejtësisht për shumë vite me radhë, që nga Kongresi i Berlinit tyre për të pasur një shtet të tyre të fortë, jo të ndarë? Jemi të gjithë koshient që jo. Pse jo? Sepse gjysma e procesit është rrumbullakuar e gjysma tjetër na mbetet ende për t`u rrumbullakuar, që edhe ne shqiptarët të kemi shtetin-komb tonin dhe ta gëzojmë atë, Konferenca e Ambasadorëve në Londër dhe Konferenca e Parisit-Versajës. Por a u realizua ëndrra e Pse e them këtë? Sepse e dimë të gjithë që më mirë të finalizohet procesi i bashkimit kombëtar duke u bërë një shtet i vetëm me emrin Shqipëri, se sa të bëhen disa shtete shqiptare.*** Kësisoj do të krijoheshin shumë identitete kombëtare në bazë të këtyre shteteve. Kjo paraqet rrezik shumë të madh sa edhe vet politika ekspansioniste sllave. **Pse e them këtë?** ***Sepse tentativa për të krijuar identitet në bazë të shtetit apo komb në bazë të shtetit për Kosovën nuk përkon me realitetin historik, kulturor dhe gjeostrategjik.*** Edhe për vet faktin se banorët shqiptarë të Kosovës, kanë filluar të (vet)quhen kosovarë. Edhe atë për arsye të të bërit dallim kapital dhe për të shmangur ngatërrime me shqiptarët prej Shqipërie. Pse? Sepse gjoja se nuk lejohen dy shtete me të njëjtin emër? Po le të bëhet një shtet dhe u zgjidh problemi. Ja formula fare e thjeshtë Do të shmangen dallimet, do të shmangen keqkuptimet dhe do të jemi ashtu siç edhe është dashur dhe duhet të jemi. Përderisa para pak vitesh pavarësia e Kosovës ishte tabu, sot është realitet. Andaj edhe kërkesa permanente për bashkim të Shqipërive (Shqipërisë aktuale të cunguar, Kosovës dhe trojeve etnike shqiptare) ndoshta do të jetë e papranueshme për shumë veta dhe për ca kohë, por pas disa viteve do të jetë patjetër realitet. Patjetër se do të bashkohen, dhe duhet të bashkohen. Nuk mund të funksionojnë dy shtete parciale, shteti funksionon si i tërë dhe komplet. Shqiptarët, edhe pse me shumë gëzim dhe me lot në sy e festojnë njëvjetorin e pavarësisë së Kosovës, duhet të jenë dhe besoj që janë koshient që duhet të bashkohen sepse janë të dënuar që ta bëjnë një gjë të tillë. Sepse ky rajon para shumë viteve dëshmon se ka pasur shqiptar, më saktësisht ka pasur fisin e njohur dardanë, dhe është njohur me emrin Dardani. Dardanët ishin fisi më i madh Ilir që u vu në krye të Mbretërisë Dardane, në Ballkanin qendror, kryesisht në Kosovë. Dy fise të tjera dardane të njohura ishin ***thunatët dhe galabrët***. Qyteti më i rëndësishëm i dardanëve ka qenë Damastioni. Lidhur me lokacionin e Damastionit janë shkruar artikuj të ndryshëm. Sipas

A. Stipçeviq, disa e kanë lokalizuar në Shqipërinë e Jugut (rrethi i Gjirokastrës), kurse disa, si R. L. Beaumont, në Shqipërinë e Veriut, në rajonin e Dukagjinit ose të Mirditës. Po kështu me këtë problem u mor edhe Anton Mayer "***Polozaj Damastija, Numizmatika, 2-4/1934-1936, f. 181-183.*** Por, sidoqoftë, i bie që ky rajon të jetë populluar me stërgjyshër të shqiptarëve si dhe me shqiptarë të cilët ishin të bashkuar në një Mbretëri. E sot janë të ndarë në dy e më shumë shtete. Ndërsa në anën tjetër, ***sllavët sajuan konceptin Kosovo, me qëllim të aneksimit të tokave shqiptare.*** Ata shkuan edhe më larg duke avancuar këtë koncept me emrin ***Kosmet.*** Ky koncept mostër do të shërbente si simbol dhe justifikim permanent për prezencë permanente sllave në këtë rajon, që dikur njihej me emrin Dardani. Kur mbreti Stefan Dushani, pushtoi gjithë Shqipërinë Natyrale dhe u shpall car, rezidenca mbretërore e tij u bë Prizreni, pra qytet në Kosovën e sotshme. Pjesa më e madhe e tokës, duke përfshirë edhe popullsinë, iu dhanë si dhuratë në përdorim kishës dhe manastireve-gjest ky i Carit, prej të cilit Kosova e mori emrin e vet në serbisht Kosovo i Metohija (Kosova dhe Metohija), shkurtimisht Kosmet, që d.m.th. faleminderim. Ndërsa Metohija, vjen prej termit Metoh-që d.m.th. pronësi e manastirit. Andaj është më se e qartë që shqiptarët e Kosovës, me qëllim të shkëputjes përfundimtare nga trungu i Shqipërisë, u aneksuan dhe u tjetërsuan. Për këtë arsye ne si komb duhet të sensibilizohemi, jo në drejtim të inovimit të koncepteve monstruoze të krijimit të dy identiteteve të ndryshme, sepse nuk mund të bëhet një gjë e tillë, se kjo i shkon në favor sllavëve. Duhet të fillojmë që në vend të ***diplomacisë deklarative,*** të bëjmë ***diplomaci aktive vepruese*** drejt përforcimit të identitetit e jo parcializimit, drejt bashkimit e jo fragmentarizmit. Kësisoj si epilog do të kemi Shqipërinë Natyrale ashtu si duhet të jetë e mandej do të aderojmë në UE , si trung i bashkuar, e jo të integrohemi në ***UE mëhallë pas mëhalle.*** Të integrohemi të tërë ashtu si jemi natyralisht, ashtu si kanë qenë të parët tanë pellazgo- ilirë. Gëzimi i shkurtë i të gjithë shqiptarëve duhet të rrumbullakohet me gëzimin e përjetshëm për një Shqipëri të bashkuar. Kjo është rrugë e pashmangshme, katërçipërisht e them e realizueshme dhe zgjidhja e vetme e problemeve për Ballkanin. ***Është e pamundur që të sajohen koncepte të shteteve shumetnike, sepse koha ka dëshmuar se ato nuk janë funksionale.*** Andaj edhe koncepti gjoja se multietnikumi i Kosovës, është prodhim i dal jashtë mode, sepse është model i provuar që nuk funksionon. Sot Kosova, falë këtij modeli është e shkëputur jo vetëm nga Shqipëria, por edhe e fragmentarizuar territorialisht, ***sepse ka 3 pushtete paralele.*** Në momentin kur ne festojmë, në territorin tonë vjen delegacion serb, përgjegjës për masakrat dhe etnocidin e shqiptarëve shekuj me radhë, pa kërkuar aspak falje për krimet monstruoze, pa bërë denacifikimin e tyre dhe ftojnë në djegie të pikave doganore si dhe në rebelim të serbëve. Kambanat kanë filluar të bijnë. Kosova nuk mund të jetë shtet shumëkulturor me shumë pushtete paralele***. Ajo është e destinuar të bashkohet me Shqipërinë, sepse është Shqipëri.*** Është Shqipëri së bashku me Shqipërinë e tretë në Presheve, Medvegjë dhe Bujanoc, është Shqipëri me Maqedoninë (emri Maqedoni poashtu rrjedh nga shqipja, respektivisht nga gjuha pellazgo- ilire, emathia, që d.m.th. E madhja) pra është koncept i yni e jo i sllavomaqedonasve, është poashtu Shqipëri me Shqipërinë e çamëve. Andaj për këtë arsye rruga e filluar e pavarësisë së Kosovës, realitet dhe gëzim i shkurtër dhe provizor patjetër që do të ***finalizohet dhe rrumbullakësohet me krijimin e Shqipërisë Natyrale-realitet dhe gëzim permanent, i përjetshëm deri në amshim. Dy e gjysmë shtete shqiptare janë të përkohshme, jofunksionale, fallco. E fallcoja nuk mund të ekzistojë. Kthim mbrapa nuk ka***. ***Një komb i njëjtë nuk mund të kufizohet me vetveten***.

Kërkesa për të eliminuar këtë paradoks alogjik është politika e letrave të hapura, që ka filluar të luhet, por edhe që duhet të luhet në Ballkan.

Kumanovë, 17 shkurt 2009

(MAQEDONI)

QEVERISJA AKTUALE DHE NGECJA E IMPLEMENTIMIT TË MARRËVESHJES KORNIZË TË OHRIT

Maqedonia pas shkëputjes më të lehtë nga ish-Federata Jugosllave për dallim prej ish-Republikave tjera jugosllave, arriti që për vite me radhë të ndërtojë një shtet me karakter unitar, duke neglizhuar etnitetet e tjera që jetonin në këtë shtet. Normalisht, përballë këtij diskriminimi të pashoq ishin edhe shqiptarët, të cilët edhe pse përbënin një numër të mjaftueshëm të banorëve, ishin të eksponuar drejt një margjinalizimi dhe diskriminimi permanent. Konflikti i vitit 2001, i cili erdhi si rezultat i këtij diskriminimi ishte me përmasa shqetësuese për këtë shtet, saqë e rrezikonte edhe ekzistimin e këtij shteti. Retorika e konfliktit dhe grindjeve që e shoqëruan këtë ish-Republikë Jugosllave, dobësoi mundësitë për një zhvillim pozitiv të saj në shumë aspekte. Kësisoj rrezikohej përpos vet këtij shteti edhe ekzistenca e tërë rajonit, i cili gjendej ende në vorbullën e konfuzioneve dhe sapo kishte dal nga konfliktet e përgjakshme. Andaj ishte e domosdoshme intervenimi i palës ndërkombëtare, i cili ishte vendimtar për të parandaluar shtrirjen e konfliktit më tutje. Kësisoj më 13 gusht të vitit 2001 në Ohër, u nënshkrua Marrëveshja Kornizë e Ohrit. Por shtrohet pyetja se pse praktika e kësaj marrëveshje nuk u realizua dhe pse aktualisht është në ngecje. Republika e Maqedonisë pas përfundimit të luftës apo konfliktit shqiptaro-maqedonas dhe pas Marrëveshjes së arritur në Ohër, duhej të lëvizte më guximshëm drejt implementimit të kësaj marrëveshje, në mënyrë që të krijoheshin kushtet reale për lëvizjen drejt shteteve që kanë demokraci të zhvilluar, për një shtet ku pjesa më e madhe e qytetarëve të saj duhet të kishin një mirëqenie sociale-ekonomike, ku jeta do të kishte kuptim, ku komunikimi do të ishte më efikas. Edhe pse kanë kaluar disa vjet pas nënshkrimit të saj dhe pas marrjes së përgjegjësisë për realizim dhe përmbyllje gjerë më 2004, ende nuk ka asgjë në këtë drejtim. Pra, ekziston frika e transformimit të marrëveshjes në një model dështimi. Edhe pse ishte e parashikuar që të zbatohet parimi i mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë edhe sot e kësaj dite përkatësia kombëtare shqiptare është pengesë apo barrierë që një shqiptar të jetë komandant i një Korparmate apo edhe pjesëmarrës në struktura menaxhuese apo udhëheqëse të gjeneralshtabit, apo komandant i njësive speciale policore. Ka njësi rajonale në këto dy ministri me përqindje simbolike të shqiptarëve. Përpos kësaj, pjesëmarrja e shqiptarëve në Ministritë e ndryshme, e më saktësisht në Ministrinë e Punëve të Jashtme është ende tejet minore. Ende vazhdon të trajtohet policia, ushtria, si dhe instancat e tjera si maqedonase. Edhe sa vjet pas zotimit për zbatim, ende kanë ngelur një mori çështjesh të pazgjidhura siç janë: ndryshimi i Ligjit për nënshtetësinë, me ç`rast automatikisht shumë shqiptarëve do t`u jepej nënshtetësia, ende nuk kemi të zgjidhur problemin e ish-luftëtarëve të 2001-shit, ende nuk është sjell Ligji për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës, etj. Mandej edhe ato ligje që u sollën kishin margjinalizime. Kësisoj Ligji për përdorimin e flamujve të komuniteteve tjera, përpos asaj maqedonase, që u soll në mandatin qeveritar 2002-2006, është përcjellë me shumë

eufori, pakënaqësi dhe kritika, sepse në shumë qytete shqiptare nuk mundet të valojë flamuri kombëtar i shqiptarëve. Këtë peshqesh e kishim nga partia e cila krekosej se kishte dal nga gjiri i luftës. Problemeve të shumta në Maqedoni ia shtojmë edhe heqjen e disa neneve për përdorimin e flamurit kombëtar shqiptar nga ***Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë*** gjatë qeverisjes së mëparshme, me ç`rast edhe më tej u devalvua dhe u venit synimi për një shtet shumëkulturor sipas standardeve evropiane. Njëkohësisht, tani këtë e shoqërojnë edhe ndërhyrjet dhe bastisjet e policisë në vendbanimet shqiptare, rritja e papunësisë, rritja e kriminalitetit apo zbritja e këtij fenomeni fare poshtë në shoqëri, mllef shoqëror, rënie ekonomike, investitorë të pasigurtë, pasiguri politike dhe sociale, status-quo e marrëdhënieve ndëretnike, inkuadrimi i shqiptarëve sipas përqindjes proporcionale, promovimi i një politike grindavece me fqinjët etj. Pra, sipas mendimit tim, këto janë prioritetet që ende nuk janë përmbushur apo realizuar dhe që duhet patjetër të përmbushen. Qeveria aktuale e Maqedonisë është duke ndërmarr disa veprime, që prishin direkt ekuilibrin e prioriteve politike, ekonomike apo edhe të projekteve që kanë të bëjnë me mirëqenien e qytetarëve. Këto veprime janë hapja e lëndëve të Gjykatës së Hagës, vonimi i vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Kosovën, sjellja e ligjeve për shume pak sekonda në dëm të shqiptarëve, të cilat krijojnë dyshimin se në formë të tërthortë me dije apo pa dije, qeveria e Maqedonisë i kontribuon situatave konfliktuoze, mosinteresimi për zonat ku jetojnë shqiptarët, mungesa e investimeve nëpër ato zona etj. Kësaj situate konfliktuoze politike me sjelljet e tyre i kontribuojnë edhe faktori aktual politik shqiptar në Qeveri, i cili është servilizuar tej mase dhe pa u pyetur fare neglizhohet aq shumë, saqë kemi përshtypjen se është inekzistent. Nga përvojat e shteteve në tranzicion, por edhe nga përvojat me të cilat u ballafaqua Republika e Maqedonisë, në tetëmbëdhjetë vitet e fundit u dëshmua fakti se për stabilitetin e shtetit dhe për sigurinë e tij nuk janë vendimtare forcat represive, autoritarizmi, kryeneçësia, oportunizmi, nacionalizmi romantik dhe antik, por se ndikimin për krijimin e një shoqërie të qëndrueshme me një siguri të qëndrueshme e kanë disa parametra të tjerë si: ngritja e nivelit të demokracisë, respektimi i të drejtave të njeriut, kultivimi i raporteve të mira ndëretnike, mirëqenia ekonomike dhe sociale, promovimi i vlerave evropiane etj .

Cilat janë gjërat që sipas meje kanë cunguar dhe e kanë ngecur Marrëveshjen e Ohrit. E para, nga politika maqedonase, kjo Marrëveshje vazhdon të konsiderohet si një lëshim që shteti dhe populli maqedonas u ka bërë shqiptarëve. ***E dyta,*** Aktualisht duke u marë kinse me problemin e emrit, Gruevski dhe shtetarët aktual "harruan" se më me rëndësi është të mos kesh probleme apo t`i zgjidhësh ato përbrenda, se sa të krijosh probleme jashtë. Pra, ka të ngjarë që kjo marrëveshje të jetë larg të qenit natyrale dhe shumë pranë artificialitetit. Andaj, me të drejtë mund të theksoj se Marrëveshja Kornizë e Ohrit tani është në ngecje ose shkon një çik mbrapa. Për dalje nga kriza, Maqedonia dhe shtetarët maqedonas duhet të shohin me kërshëri dhe zell shtetin e Kosovës, i cili ofron modelin shëmbëlltyrë se si duhet trajtuar pakicat kombëtare. Maqedonia e ka edhe më lehtë, sepse popullata shqiptare nuk është pakicë, por shumicë, deshi apo s`deshi ta pranojë këtë realitet pala maqedonase. Fundja, pa u trajtuar si duhet faktori shqiptar, s`mund të ketë perspektivë ky shtet problematik, i cili luan me politikën e dubël standardeve. Shkel të drejtat në shtetin e vet, ndërsa kërkon të drejta për maqedonasit pakicë ose inekzistent nëpër shtetet tjera fqinje. **Kështu nuk ka perspektivë, sepse nuk mund të ketë perspektivë nëse:**

1. e vërteta matet me fuqinë dhe forcën, kokëfortësinë dhe hipokrizinë

2. kur vendimet politike sillen vetëm nga një grup i njerëzve, duke u injoruar të tjerët
3. ku nuk ka bashkëpunim në mes grupeve etnike (rasti i (mos)ftesës së partive shqiptare nga pala maqedonase në negociatat për emrin kushtetues të Maqedonisë apo pjesëmarrja vetëm sa për sy e faqe)
4. ***aty ku nuk ka shumëllojshmëri, ku nuk pranohet alterizmi dhe ku nuk respektohen dallimet***
5. aty ku nuk ka barazi, liri, solidaritet,
6. aty ku sillen ligje për 60 sekonda dhe askush nga shtetarët nuk çan kokën për vërejtjet ndërkombëtare dhe lokale
7. aty ku cenohet dhe cungohet e drejta natyrore, dhe shpiken koncepte monstra si e drejta minoritare, e drejta mazhoritare etj.

Këto duhet t`i dijë edhe partia politike shqiptare, e cila aktualisht është në Qeveri dhe e cila është vetëm në rolin e të përkëdhelurit, në rolin e një shërbëtori dhe servili. I marrin rrogat e tyre nëpër ministri, u qetësuan dhe u rehabilituan me poste, Gruevski i shpërbleu për politikën denigruese dhe për çirrjet që bënin kundër PDSH-së kur ishte kjo e fundit në Qeveri, e kanë "kryer" obligimin kombëtar me luftën e vitit 2001, gjithçka "është" në rregull. Ligji për gjuhët është nënçmues, hapen dosjet e luftës për vetë deputetët e partisë në pushtet, gjykohen edhe më tej luftëtarët e 2001-shit, zvarritet vendosja e marrëdhënieve diplomatike me Kosovën e kështu me radhë. Por ç`të bësh, falja Zot partisë shqiptare në pushtet, se nuk dinë se çka bëjnë. Ndërsa z. Gruevski e din shumë mirë. Por shtirret se nuk din, apo se gjithçka është në rregull. Por ka harruar se Maqedonia lëshon trenat e fundit për t`u bërë pjesë e shteteve me demokraci të konsoliduar dhe shteteve me perspektivë për qytetarët e vet. Andaj mban peng ëndrrën e qytetarëve të vet, e sidomos të shqiptarëve për t`u bërë pjesë e NATO-s dhe e UE-së.

Maqedonia ka harruar se"Tous les êtres humains naissent libres et égaux en dignité et en droits. Ils sont doués de raison et de conscience et doivent agir les uns envers les autres dans un esprit de fraternité. (Të gjitha qeniet njerëzore lindin të lira dhe të barabarta me dinjitet dhe të drejta. Ata posedojnë arsye dhe vetëdije dhe duhet të veprojnë njëri ndaj tjetrit në prizmin e vëllazërisë).[52] Nuk mund të ketë stabilitet pa avancim dhe trajtim të barabartë të të gjithë qytetarëve në këtë shtet, e sidomos të shqiptarëve. Nëse dëshiron të ekzistojë si shtet Maqedonia, duhet t`i trajtojë të gjithë qytetarët njësoj, sepse ky shtet do të mund të ekzistojë për aq sa të duan shqiptarët, sepse edhe ashtu ka probleme për emrin me fqiun jugor, Greqinë, edhe më tej ka problem me identitetin, sepse kontestohet nga fqiu lindor, Bullgaria, ende ka problem me kishat dhe njëkohësisht edhe me identitetin, sepse i kontestohen të dyja nga Serbia. Andaj, është e udhës që të mos hap edhe më tej fronte të tjera, e sidomos me shqiptarët, sepse ata janë mjaft relevant në rajon. Hapja e problemeve me shqiptarët, do të thotë regres dhe ngecje për këtë shtet. Kësisoj epilogu do të ishte margjinalizues dhe katastrofal, jo vetëm për këtë shtet, por edhe për tërë rajonin. Duke e parë krejt këtë situatë, fare në fund mund të themi se kjo marrëveshje duhet të implementohet praktikisht, pa kurrfarë margjinalizimesh ose duhet të rishikohen formula të tjera të (mos)marrëveshjeve.

Kumanovë, 13 gusht 2009

[52] http://www.un.org/fr/documents/udhr/

EDHE MË TEJ AI ËSHTË INVICTUS

E tërë Kumanova u shtang nga një ngjarje e papritur për këtë qytet dhe për qytetarët e saj. Një errësirë i kishte rënë qytetit të Kumanovës, e posaçërisht spitalit të këtij qyteti. Ajo pamja e bukur e spitalit të Kumanovës që për shumë qytetarë ishte burim shprese, papritmas u shua saora. Ky qytet megjithë problemet e shumta me të cilat ballafaqohet, duket se u plogështua nga dorëheqja e një njeriu që për Kumanovën ishte shndërruar në simbol shprese. Nëpër media, nëpër biseda të ndryshme me njerëz të zakonshëm, nuk dëgjoje asgjë përpos pëshpëritjes " Drejtori i spitali ka dhënë dorëheqje". Dhe me të vërtetë ndodhi edhe ashtu. U binda kur dëgjova lajmet nëpër media. Shumica e mediave ishin të rrënqethur nga kjo ngjarje e papritur, ndërsa një pjesë e vogël e medieve dukej se krekosej nga kjo dorëheqje. Poashtu të gëzuar ishin edhe disa persona të cilët, për të dalë ***nga anonimiteti përmes liderit të tyre Ali Ahmeti,*** krekoseshin me thënien ***"Ia dolëm, e ndërruar drejtorin.*** Duke dëgjuar pëshpëritje e tyre thash vet me vete ***"Fali Zot nuk dinë se çka bëjnë. E mbi të gjitha falja atij njeriu i cili është aktori kryesor i këtij veprimi".*** E kisha fjalën për liderin e BDI-së. Struktura aktuale e udhëheqësisë së BDI-së në Kumanovë kishte festuar së bashku me disa maqedonas, sepse ata ia dolën të kenë "sukses". Detyruan shkarkimin e drejtorit i cili e bëri spitalin në qytetin e Kumanovës spital. Spitalit para se të vinte ky njeri kemi mundur t`i themi gjithçka, si vatër korrupsioni apo mundësia më e mirë për pasurim të lehtë, mundësi për të gjetur argëtim të çfarëdo lloji, por jo edhe spital. Spital u bë me ardhjen e z. Selver Jashari në postin e drejtorit. Zaten punën më të mençur që e kishte bërë lideri i BDI-së Ali Ahmeti gjatë gjithë kohës që është në pushtet ishte përcaktimi i z. Jashari në postin e drejtorit. Por, ja që edhe këtë të mirë e grisi shumë shpejt dhe e bëri copa-copa. Tanimë një gjë po dihet, ky qytet i cili e solli në pushtet këtë hierarki qeverisëse aktuale dhe e nxori nga pluhuri i harresës, përmes luftës dhe rezistencës së vitit 2001, do të shndërrohet në vend ku këta qeveritarë do të përjetojnë fiaskon më të madhe dhe do t`i jepet goditja përfundimtare, e filluar tanimë me Tetovën, Gostivarin dhe Haraçinën. Pse? Sepse u detyrua të japë dorëheqje njeriu i cili e theu mitin e ***"Ova e crveno Kumanovo, i crveno qe bide."*** Njeriu i cili ishte i vetmi që implementoi praktikisht Marrëveshjen e Ohrit, me zbatimin e shqipes në spital. Ky njeri i madh, arriti të ndalojë korrupsionin, fenomen ky i cili është bërë kancerogjen për shoqërinë kumanovare. Ky njeri vendosi flamurin e shqipes me dy krena në spital, figurat e heronjve kombëtarë, Skënderbeu dhe Adem Jashari, këtij binomi brilant. E bëri spitalin në një qytezë të bukur e cila e thyente monotoninë dhe mungesën e investimeve në këtë qytet. Por ja që ky imazh u thye saora. Sot spitali nuk është ashtu siç ishte dje. Sepse ashtu vendosën "patriotët". Ashtu vendosën njerëzit të etshëm për tenderë, njerëzit shqipfolës, sepse patroni i tyre, "VMRO" nuk mund të duronte njeriun e luftës së Kosovës, njeriun e ndryshimeve. Në një edicion lajmesh që dëgjova në kanalin televiziv shtetëror thuhej se ministri i Shëndetësisë shkarkoi drejtorin e spitalit për shkak të keqmenaxhimit. E ç`ti thuash këtij njeriu të mjerë! Keqmenaxhim është vendosja e shqipes, e rregullit dhe rendit në spital. Keqmenaxhim është ndalimi i korrupsionit dhe mitos. Dhe e parashtrova një pyetje retorike: Si mund t`i bëjmë njerëzit të lumtur, kur ministrat, drejtuesit e degëve partiake nuk i kemi të mençur dhe të moralshëm. Dhe rashë në konkluzion se njerëzit e paskrupullt të llojit të udhëheqësisë së degës së BDI-së në Kumanovë dhe ministrave të po kësaj partie, të veshur nga një petk i korrupsionit, krimit, tenderokracisë dhe narcisoizmit, nuk janë asgjë përpos monstra të llojit sui generis. Këta njerëz të paedukuar janë karikatura të vetes së tyre. Ata mëtojnë të thonë se ia arritën

suksesit. E ndërkaq harruan, se njeriu është masë e të gjitha sendeve, si dhe se atë e bëjnë të pavdekshëm veprat dhe vlerat e tij. E Selver Jashari kishte arritur të linte gjurmë në këtë qytet. Këto gjurmë do të jenë çdoherë kërcënim për monstrat të cilët bëjnë përpjekje titanike për mbijetesë në këtë qytet. Me të drejtë pajtohem me thënien e filozofit të madh francez, Volter, i cili thotë: *"Është koha kur lavdërohen dhe avancohen njerëzit e dobët"*. Këta udhëheqës aktual të degës së BDI-së në Kumanovë me disa ministra, që përjetojnë orgazëm kur dikush i lavdëron, sepse janë të dobët, nuk janë koshient për thënien e Eskilit: ***"Njerëzit e këqij, kur janë me fat, bëhen të padurueshëm dhe shndërrohen në përbindësha".*** Këta njerëz harrojnë që fati nuk mund t`i ndjeke çdoherë. Leksionin e parë e morën në zgjedhjet e marsit, ku përjetuan fiasko me një zvogëlim drastik të votave në këtë qytet. Poashtu leksionin më të madh e morën në Tetovë, Gostivar dhe Haraçinë. Por, me siguri se do të marrin edhe leksione të tjera. Sepse janë shndërruar në rob të patronit të tyre, VMRO. E Selveri nuk është thyer dot. Ai edhe më tej reflekton pozitivisht, se njeriu është i lirë kur i shërben vetëm të vërtetës. Selveri edhe më tej do të jetë një njeri i madh për Kumanovën e tij, që e deshi dhe e do aq fort. Ai dhe njerëzit si ai, shikojnë më larg se të tjerët, sepse rrinë në shpatullat e veprave të mëdha e të tjerët që brohorisin dhe kënaqen si kalamajtë e lagjes sime, kur ju dhuron ndonjë çamçakëz apo ndonjë karamele dhe i lavdëron, nuk mund të shikojnë aq larg, sepse në shpatullat e tyre, të cilat edhe ashtu nuk i kanë, sepse janë zvarranikë dhe butakë, nuk qëndron asnjë vepër e mirë. Jam i bindur se Selveri si njeri i mençur dhe guximtar, nuk mund të ulet nga të sharat e llafazanëve dhe lakuriqëve të natës. Ai është edhe më tej INVICTUS, i pathyeshëm dhe stoik. Për të do të flasin veprat e tij që i ka bërë për këtë qytet. Me dorëheqjen e imponuar, ai do të jetë edhe më i fortë, sepse mbi të qëndrojnë vetëm vepra të mira dhe për çdo lëvdatë. Ndërsa, këta të tjerët që përjetuan orgazëm me lënien e postit nga ana e Selverit, këta që nuk kanë as komb, as fe, as moral, as ndjenja, por janë vetëm qenie me pamje njeriu, sado që do i shohim si të gjallë, ata janë skelet të vdekur dhe jetojnë duke mos u hetuar. Le të shpresojmë se padituria e këtyre njerëzve demonë, nuk do të jetë aq afatgjatë. Sepse, dalëngadalë edhe ky qytet ka filluar të kuptojë se vetëm me të diturit ecet përpara si dhe do të dijë t`i çmojë të mençurit sikurse u çmuan të mençurit në Tetovë dhe Gostivar e jo halabakët dhe analfabetët. Dhe siç do të thoshte Platoni se pas fjalës dhe fjalimit është dëgjuesi, besoj se edhe pas këtij reagimi tim do të ketë edhe reagime të tjera. Koha është gjykatësi më i drejtë dhe më i ashpër. Sepse ajo e mban të drejtën si vaji në ujë. E drejta i atribuohet njeriut i cili ishte dhe është shëmbëlltyrë për qytetin dhe më gjerë. Ndërsa demonët e pasuksesshëm mund të jenë të vlefshëm vetëm për diçka, të vlejnë si shembull për të keq. Sepse për bëmat e Selver Jasharit mund të thuhet vetëm një gjë se ***"është rregull e njerëzve të mençur t`i lënë gjërat para se ato t`i lënë ata". Kush e hesht të vërtetën, është djall i nemitur.***

Kumanovë, 26 maj 2009

21 VITE TË DHEMBSHME PA BIRIN MË TË DASHUR KUMANOVAR



Kumanova si qytet është mjaft e dalluar për trimëri, guxim dhe devotshmëri ndaj idealeve kombëtare. Ajo si qytet ka nxjerr trima dhe trimëresha, të cilët me stoicizëm dhe guxim i kanë rezistuar barrierave të ndryshme kohore. Varësisht nga rrethanat, ky qytet është krenar që ka lindur dhe rritur njerëz trima dhe të pathyeshëm. Kësisoj ajo mburret me të kaluarën e saj, mburret me trimat e saj, mburret me historinë e saj. Si qytet gjendet në pjesën e Maqedonisë Veriore me një sipërfaqe prej 1193 km katrorë, me një pozitë të jashtëzakonisht të volitshme gjeografike. Popullata shqiptare e këtij qyteti ka qenë e eksponuar ndaj një dhunë të paparë, një gjenocidi dhe një politike antinjerëzore, të kryer nga pushtues të ndryshëm të lashtë dhe bashkëkohor. Ky qytet gjatë periudhës komuniste ka qenë në shënjestër të sigurimit të UDB-së jugosllave, për çka flasin edhe dokumentet edhe arkivat e ndryshme. Të dhënat flasin se ky qytet për shkak të prirjeve kombëtare më të theksuara dhe dëshirës për të qenë të lirë nga ana e popullatës shqiptare, ka qenë eksperiment i sigurimit shtetëror jugosllav dhe po kjo popullatë shqiptare ka përjetuar të zinjtë e ullirit. Mirëpo nga ana tjetër ky qytet ka nxjerrë edhe trima, të cilët iu kanë kundërvënë nacionalistëve dhe shovinistëve sllavë me guxim dhe me një trimëri të rrallë. Fati e deshi që Kumanova të nxjerrë në dritë trima si Sulë Hotli, Sadik Llojani, Enver Destani, Nexhmedin Hyseni, Arif Seferi, Ismet Jashari, etj, e së fundi edhe trimat e rënë në luftën e vitit 2001, të cilët ranë për mbrojtjen e atdheut heroikisht, por që fatkeqësisht edhe sot e kësaj dite nuk ka kush përkujdeset për familjet e tyre, sepse partitë politike shqiptare vijnë e shkojnë e për këta dëshmorë nuk ka kush përkujdeset. Me ç`rast vlen thënia e sllavëve: ***"Jepuni shqiptarëve çdo gjë si individ, por mos u jepni asgjë si komb".*** Kësisoj disa shqiptarëve iu dhanë poste ministrore, funksione të larta, të cilët ata i fituan, pikërisht falë rënies heroike të këtyre dëshmorëve, mirëpo ata nuk çajnë kokën për asgjë, sepse i "kanë" punët mirë. Kjo nuk është çështja që dua ta shtjelloj në këtë shkrim. Ajo që dua të theksoj është se ky qytet ka qenë në sy të sllavëve për shkak të gjoja 'nacionalizmit dhe seperatizmit shqiptar". Thënia sllave: ***"Ova e crveno Kumanovo, i crveno qe bide"*** është ëndërr miope për sllavët e kësaj ane. Për shkak të mospajtimit me këtë politikë shumë trima shqiptarë të kësaj ane kanë rënë në altarin e lirisë për të mos

vdekur kurrë. Ata u vranë, u pushkatuan, u likuiduan pabesisht nga dora sllave e UDB-së së atëhershme dhe asaj të sotshme, por me emër tjetër. Njëri prej tyre është padyshim edhe djali trim nga Kumanova, Nexhmedin Hyseni-Neçkoja, djalë trim, bujar dhe besnik.

Nexhmedin Hyseni-Neçkoja, u lind më 1953 në Kumanovë nga babai Ramadani dhe nënë Hafizja. Ishte djali i vetëm në këtë familje. U edukua në frymën patriotike dhe kombëtare dhe për këtë arsye i pengonte politika çnjerëzore sllave e asaj kohe. Familja e Nexhmedinit ishte në shënjestër të UDB-së sllave. Axha i tij, Nuredini, kishte qenë pjesëtarë i forcave balliste, e për këtë shkak vritet në Sopot, respektivisht, masakrohet nga dora sllave. Djemtë e Nuredinit dhe vajzat, për shkak të dhunës dhe presioneve permanente, detyrohen të shpërngulen në Turqi, njëkohësisht duke i`u marr e tërë pasuria nga ana e shtetit sllav për shkak se kishin qenë familje balliste. Kjo për Nexhmedinin kishte qenë prelud që ai mos të pajtohet kurrë me një gjë të tillë. Kësisoj, me një xhaxha të vrarë, me familjen e keqtrajtuar dhe shpërngulur në Turqi, me pasurinë e fituar me mund dhe djersë, e të marr nga shteti, nuk i mbeti asgjë tjetër, përpos të kundërshtojë me ngulm dhe vendosmëri një politikë të tillë antinjerëzore. Ai, duke filluar nga dita në ditë, ishte therë në sy për pushtetin e asaj kohe, për kriminelët sllavë të asaj kohe, të cilët maltretonin shqiptarët e pafajshëm, e ndërsa Neçkoja për shkak të trimërisë së tij dhe guximit, nuk e lejonte një gjë të tillë. Me trimërinë tij të kanalizuar në rrugë problematike dhe sfiduese, ai do të ishte David kundër Goliathave sllavë, duke i mundur në çdo kohë dhe duke dal fitimtarë. Njashtu ishte i pamëshirshëm edhe ndaj spiunëve dhe shqipfolësve të ndryshëm, të cilët ishin bashkëpunëtorë të pushtetit sllavë dhe UDB-së jugosllave, me ç`rast i sulmonte dhe nuk i lente rehat. I pengonte jashtë mase maltretimi i shqiptarëve. Kudo që cenohej simboli shqiptar në Kumanovë, ai ishte në vendin e duhur duke iu kundërvënë me forcën e tij të pabesueshme fizike, të cilën ia kishte falur Perëndia. Për këtë ai do të shpallej si person i rrezikshëm për shtetin dhe do të kalonte shumë kohë në burgje. Aty së fundi do t`i kurdisej edhe likuidimi fizik. Trimëria e tij në Kumanovë është shembull edhe sot e kësaj dite. Aty ku nuk flitej shqip, aty fliste shqip Neçkoja, aty ku nuk këndohej shqip aty këndonte shqip Neçkoja, aty ku nuk frymonte shqip frymonte shqip Neçkoja. Kësisoj kriminelët dhe rrugaçët sllavë, si dhe ata shqipfolës nuk ishin rehat nga ky trim i rrallë. Për shkak të trimërisë së treguar në Kumanovë, guximit, shkathtësisë dhe forcës së tij të paimagjinueshme fizike, ai do të angazhohet edhe në strukturat e Lëvizjes së atëhershme Popullore të Kosovës në Zvicër, e cila ende nuk ishte e tillë, me ç`rast do të ushtronte shqiptarët luftën me thika. Ishte i ngarkuar me këtë mision. Pra, mori përsipër një detyrë të madhe, sepse e dinte se për çlirim të Kosovës nevojitej luftë. Ai nuk stopoi me kaq, kriminelët dhe mafiozët e ndryshëm sllavë në Kumanovë si dhe disa shqipfolës dhe shërbëtorë, i disiplinonte pa ngurrim, përmes metodave të tija. Por, UDB-ja, nuk do t`ia falte këtë kurrë. E hetuan për aktivitetin e tij në Zvicër, poashtu edhe i pengonte që një shqiptar të jetë INVICTUS në Kumanovë, apo i pathyeshëm, e për këtë organizoi likuidimin e tij tinëzar, për shkak se frikoheshin t`i dilnin përpara këtij Vigani sypatrembur. Më 5 gusht 1988, ditë e premte, ora 17:45, një ditë para se të shkonte në Zvicër, për aktivitetin e tij dhe misionin e tij konspirativ kombëtar, i organizohet prita përpara spitalit të Kumanovës, përballë kafenesë "Esnafi", në rrugën Kumanovë-Shkup, nga ana e UDB-së së Kumanovës. Preteksti për likuidimin e tij ishte "ai është nacionalist dhe separatist i përbetuar dhe ***"nemirna dusa" (shpirti parehatshëm),*** pretekst ky që u provua edhe me ngjarjen e 29 gushtit 1988, kur shumë shqiptarëve do t`iu shqiptoheshin dënime të rënda pa seancë

gjyqësore për vepra të inskenuara. Më 5 gusht 1988, UDB-ja, lokalizoi vendndodhjen e Nexhmedinit trim, dërgoi forca të shumta policore përreth spitalit, që në rast të mosrealizimit të skenarit të paraparë dhe planit A, të kalohej në planin B, respektivisht në vrasje nga policët. Pasi u sigurua që Neçkoja nuk kishte armë me vete, skenarin e vrasjes së paramenduar dhe planifikuar me kohë, do ta kryenin 3 persona kryesorë dhe shumë të tjerë përreth, me ndihmën e policisë. Këta persona që nuk guxonin t`i dilnin para syve këtij trimi shqiptar, sepse ai iu kishte dhënë leksionin e duhur shumë herë, ishin nga fshati Mateç, të shpërblyer dhe organizuar nga UDB-ja e Kumanovës, me urdhër të Beogradit. Ky shpirt i parehatshëm duhej të vritej patjetër, sepse ishte pengesë dhe mur kinez për kriminelët sllavë të Kumanovës. Kësisoj Nexhmedinin do ta thërriste një polic për bisedë, që t`ia tërhiqte vëmendjen. Polici quhej Millorad. Ai ishte i dërguar për kryerjen e kësaj vepre të inskenuar. Nexhmedinin e vranë: Romeo Zhiviq, Dragan Zhiviq (vëllezër) dhe Nebojsha Geleviq, djalë i Denko Geleviqit (Denkit). Të tre ishin serbë dhe kriminelë shovenë. Anash kishte edhe kriminelë të tjerë serbë me suportin e vazhdueshëm policor. Ata kishin armë, thika speciale, zinxhirë për ta furrë dhe çekan hekuri. Përderisa bisedonte me policin, ai sulmohet prapa shpine dhe kështu fillon përleshja me kriminelët. Për shkak të pranisë së shumtë të kriminelëve tjerë dhe sulmeve të vazhdueshme me mjete të rënda, ai bie në tokë. I mëshojnë edhe më tej me mjetet e lartpërmendura dhe një pjesë hekuri ia fusin në bark. Përfundon me 36 therje me thikë. Vdes pas 5 minutave, duke pëshpëritur me fjalët e fundit "***Ah nënë, më vranë shkijet".*** Kriminelët pas këtij akti "patriotik" shkojnë dhe festojnë me policinë në Manastir të Mateçit. E "liruan" Kumanovën nga Neçkoja. Nuk kishte kush t`i ndërpriste më në rrugën e tyre kriminele. Vetë shtypi maqedonas dhe i huaj i asaj kohe shkruajnë për këtë vrasje, si vrasje të rëndë. Asnjëri nga vrasësit nuk do të gjykohej, përkundrazi do të shpërbleheshin dhe do të bëheshin udhëheqës të nëntokës mafioze sllave në Maqedoni, me lidhje direkte me kriminelin serb Arkan. Këta kriminelë do të dërgohen në luftë në Bosnjë dhe në Kosovë, për të kryer vrasje dhe krime të tjera barbare. Në varrimin e të ndjerit Nexhmedin do të merrnin pjesë i gjithë qyteti, si dhe shqiptarë nga tërë trevat shqiptare, sepse trimëria dhe guximi i tij kishin bërë emër gjetiu. Për këtë vrasje edhe më tutje ekziston një heshtje që të vret dhe një enigmë, sepse ka munguar guximi për të shkruar, nga frika, sepse kriminelët e lartpërmendur deri para ca kohe ishin edhe më tej aktiv në Kumanovë dhe në Maqedoni, me përkrahje institucionale dhe policore. Guximin për të shkruar për këtë vrasje si dhe për disa të tjera, për shembull për Arif Seferin, e mori profesori i ndjerë Mr. Tefik Jahiu. Me qëllim që auditori të mos i harrojë krimet sllave e shkrova tekstin që auditori shqiptar të ketë qasje në informata të sakta dhe autentike. Ajo që është edhe më tej enigmatike dhe që duhet të zbulohet patjetër është malltretimi i vazhdueshëm i shqiptarëve pas vrasjes së Neçkos, nga ana e Romeo Zhiviqit dhe kriminelëve të tjerë, bashkëpunimi i tij me politikanët dhe funksionarët e ndryshëm, bashkëpunimi i tij me disa shqipfolës, që për hir të biznesit me drogë nuk shihnin asgjë tjetër. Pjesëmarrja e këtij krimineli në dasmën e Arkanit dëshmon lidhjet e tija me Arkanin dhe strukturat e tjera kriminale serbe. Thënia e tij se unë jam ***Arkani i Kumanovës*** shërbejnë si një argument i bollshëm për këtë. Kapja peng e këtij krimineli nga ana e trimave të UÇK-së në vitin 2001, do të ishte një lajm i mirë, po aq sa edhe shpallja e zonës së lirë, sepse po ky kriminel në atë kohë merrej me stërvitjen e forcave të ndryshme paraushtarake sllave, për luftën e vitit 2001. Kapja e tij evitoi masakrimin e shumë shqiptarëve. Për këtë lirisht mund të thuhet se trimat e devotshëm të UÇK-së kanë

kryer një akt patriotik. Lirimi i tij me ndërhyrjen e Kryqit të Kuq, edhe pse ishte i padëshirueshëm për shumë shqiptarë, ndikoi në disiplinimin e tij pas luftës së vitit 2001 e deri në vrasjen përfundimtare të tij nga ana e Jane Pavllovskit-Tica, për qërim hesapesh kriminele. Fatkeqësia qëndron në mosnxjerrjen e argumenteve për bashkëpunimin e këtij krimineli me disa komandantë të UÇK-së, me ç`rast pas lirimit të tij nga ana e Kryqit të Kuq ai do t`i falënderohej atyre publikisht. Poashtu pjesëmarrja e disa shqipfolësve në varrimin e këtij krimineli më vitin 2004, mbetet si rast për t`u hulumtuar.

Në përvjetorin e vrasjes makabër të Nexhmedin Hysenit-Neçkos, e kujtojmë me dhembje dhe mall këtë trim nga Kumanova. Për të vlen thënia e Ciceronit ***"Jeto si trim, e nëse fati nuk është me ty, kundërshto rënien me zemër trimërie"***. Të jesh hero në Kumanovë, është një sakrificë e madhe dhe kërkohet çmim i madh. Me të drejtë Aristoteli thekson se ***"aty ku çmohet urtia, ka të urtë. Aty ku çmohet guximi. Ka trima"***. Kumanova posedon me të dy llojet e njerëzve dhe për këtë arsye është krenare. Sepse bota është e guximtarëve e jo e të druajturve. Në botën e tillë padyshim se është pjesë e pandashme edhe Nexhmedin Hyseni-Neçkoja i Kumanovës.

(Vargje kushtuar Nexhmedin Hysenit-Neçkos)

NEXHMEDIN, O TRIM I RRALLË

Re të zeza të ranë mbi qiell
E ti shkove lart nën qiell
Shkove trimi i shqiptarisë
U vrave nga dorë e pabesisë.

Jetë të qetë unë nuk kam kalue
Më kaloj jeta në burgje mue
Më kaloj jetë në mundim
Gëzohem që shkova sikur trim.

Heshta vetëm kur më prenë
Vatra ime më s`më ndjenë
Gjaku i derdhur në pusi
Seç u fik o një qiri.

O Nexhmedin o trim i rrallë
Ty nëna të pati asllan djalë
Të përkujton Kumanova krenare
Jo nuk ke vdekur trimëri shqiptare.

Kumanovë, 27 korrik 2009

BLASFEMITË E RADHËS

Këtyre ditëve doli në botim libri ***« Istorija na makedonskiot narod »*** i botuar prej Institutit Kombëtar të Historisë me para të Qeverisë aktuale. [53]Nuk ishte problem titulli i librit, por ajo që më tërhoqi vëmendjen ishte ajo që është thënë dhe shkruar në lidhje me këtë libër, i botuar me paratë e Qeverisë ku aktualisht bën pjesë parti shqiptare, e cila thirret në emër të interesave kombëtare dhe legjitimitetit të harxhuar të saj. Sipas asaj që thuhet këtu mëtohet se Maqedonasit nuk janë shumicë dominuese sllave, por se tek ata dominon etnosi antik. Si çdoherë, sipas autorit Mitko Panov, sllavët të cilët ishin shpërngulur në shek. VII nuk kishin qenë në numër të madh që të ndikonin në prishjen e mozaikut dhe raporteve ndëretnike. Sipas tij maqedonasit antik nuk kishin humbur, por se ata kishin vazhduar të merrnin pjesë në procesin e simbiozës së sllavëve dhe të futnin pjesë të traditave të tyre. Krejt ky mëtim dhe ky përkushtim në këtë "studim" ka një qëllim. Diskreditimin e faktorit shqiptar në Maqedoni, i cili dita ditës vazhdon të margjinalizohet tej mase. E tani doli edhe ky "studim" i bërë nga "studiues të famshëm" dhe me "reputacion" saqë marrin guximin të botojnë edhe diç të tillë, dhe të kërkojnë zëvendësimin e epokës së Aleksandërit III me "maqedonizëm" në vend të asaj "helenizëm". Ata harrojnë dhe bien ndesh me vetveten, kur thonë se janë maqedonas antik. Në çdo 10 vjet kemi ndryshim të identitetit të tyre. Para 10 viteve origjina e këtij "kombi" të kontestuar kërkohej tek sllavët, e tani kërkohet tek Antika. Në fakt maqedonas të tillë jo që nuk ka pasur, por edhe këta që janë tani rrezikojnë që të jenë më të tillë, sepse kontestohen nga secili. Përballë gjenden me rezistencën greke, e cila me të drejtë kërkon rishikimin e blasfemive të tilla dhe kërkon me ngulm heqjen dorë nga vjedhja e historisë së tyre dhe të tjerëve. Absurdi që të vret më shumë është heshtja përballë këtyre gjërave nga ana e faktorit politik shqiptar, pjesëmarrës në Qeveri si dhe financimi i këtyre trillimeve dhe sajesave përrallore që do t`ia kishte lakmi çdo fëmijë i parashkollores, me bekimin e po të njëjtës parti shqiptare. Shtetarët maqedonas në vend që të merren me të ardhmen e pakontestuar evropiane, merren me të kaluarën e mjegulluar saqë edhe vet nuk dinë se çka do të dalin më tutje. Do të kërkojnë t`i gjejnë gjurmët e tyre të lashta edhe tek majmunët parahistorik e një ditë do të marrin guximin të thonë se edhe njeriu i parë ka qenë maqedonas antik. Ndërsa prapë heshtja e faktorit politik qeveritar shqiptar na vret të gjithve. Janë në dilemë të madhe hamletiane, të flasin diçka që ndoshta do të kishte reperkusione për ta, ose të heshtin, e kësisoj heshtja është pohim. Ndërsa në anën tjetër Shkupi shqiptar vazhdon të sllavizohet dhe të mbushet me statuja të "maqedonasve antikë". Prap heshtje. Prap nëpër spotet televizive të CNN-it promovohet Maqedonia me gjithçka sllave dhe maqedonase përbrenda, ku nuk figuron asgjë shqiptare aty e ca politikanë shqiptarë thirren ende në Marrëveshje të Ohrit dhe në raporte të mira me partnerin qeveritarë. Kjo marrëveshje jo vetëm që është harruar, por tani është duke u implementuar një marrëveshje tjetër, ajo e maqedonizimit të Maqedonisë e cila njihet me emrin FYROM e shkohet deri aty sa kërkohet edhe maqedonizimi i helenizimit. Dhe çuditem nga ky guxim i shtetarëve aktual, të cilët "harrojnë" kontestimin e kombit të tyre surrogat dhe renegat nga bullgarët, grekët, e të tjerët si dhe provokojnë të gjithë fqinjët përreth tyre. Kështu provokojnë edhe shqiptarët. Asnjë qeveri në botë nuk do të tentonte të merrte kësi lloj hapash të "guximshme" dhe të marra, për shëndrrimin e blasfemive në realitet. Këtë afinitet e kanë vetëm qeveritarët e

[53] http://www.nnet.gr/historein/historeinfiles/histvolumes/hist04/historein4-brunnbauer.pdf

Gruevskit dhe Gruevski vetë. Por cili duhet të jetë veprimi i partive shqiptare përballë kësaj gjendjeje? Ato duhet të kërkojnë me ngulm nxjerrjen në pah të të vërtetave duke argumentuar njëkohësisht ekzistencën autoktone të tyre, prezencën e tyre permanente në këto treva, të kërkojnë me ngulm pjesëmarrje aktive në bisedat për emrin, të bashkërendojnë qëndrimet me partitë simotra nga Kosova dhe Shqipëria, të promovojnë qëndrime kohezive për çështjet madhore e jo të shikojnë si sehirxhinj dhe të bekojnë blasfemitë dhe gënjeshtrat e një qeverie, e cila nëpër botë dhe rajon bën ushtimën e një material piroteknik që njihen këtu tek ne me emrin petardë, por që për ne shqiptarët është duke e pasur efektin shkatërrues të një *bombe.*

Kumanovë, 23 qershor 2009

(POLEMIKË)

AMBIGUITETET DHE DILEMAT E SHPËTIMTARIT TË NJË KOMBI TË KONTESTUAR

(Përkitazi me reagimin e bërë nga Zenun Rexhepi në gazetën "24 orë", me titull "Blasfemitë dhe hamendjet", datë 4 shtator 2009, fq. 11)

Është më se e vërtetë se bota, siç thotë Gandi i famshëm, po mos të ishte e ndryshme, nuk do ta njihnim njëri-tjetrin më mirë. Respektimi i mendimit tjetër, i asaj që quhet "mendim i lirë", është një vlerë dhe virtyt njëkohësisht. Por, respektimi i tjetrit bëhet vetëm atëherë, kur ajo që flitet apo shkruhet nga tjetri, ka peshë argumentative, si dhe nuk ka paragjykime dhe blasfemi të radhës. Kësisoj mëtimi i Zenun Rexhepit për të nxjerrë, gjoja se në pah "hamendësitë" e mia, si i quan i nderuari, që qenkan në dëm të shqiptarëve të Maqedonisë dhe më gjerë, nuk është asgjë tjetër përpos mision i kotë i një personi, i cili në vend se të merret me kontestimin e politikave dhe tentimeve sllavomaqedonase për të përvetësuar gjithçka nga periudha pellazgo-ilire, nga periudha antike, nga periudha helene dhe nga tërë periudhat vijuese, merret me kontestimin e kontesteve të mia të bëra ndaj një kombi i cili në çdo dekadë nuk merret me asgjë tjetër, përpos me rishikimin e origjinës së vet të kontestuar. Kësisoj z. Zenun është më se e qartë, me gjithë respektin për dallueshmërinë e theksuar në moshë, t`ju sqaroj ju dhe auditorit disa gjëra në lidhje me shkrimin tim, në lidhje me animin tuaj të (pa)qëllimshëm kah tezat sllave të Mitkos dhe tentativa e tyre për përvetësim të gjërave që në fakt janë tonat, pra shqiptare, e kurrsesi të atyre që sot thirren me emrin sllavomaqedonas.

E para, shkrimi im kishte të bënte me heshtjen e zymtë intelektuale përballë blasfemive të Mitkos dhe Mitkove të tjerë që me çdo kusht tentojnë të promovojnë ide që gjoja se këta maqedonasit e sotshëm të kontestuar nga secili komshi e bile edhe nga vetvetja, paskan lidhje direkte me maqedonasit antik. ***E dyta*****,** që financimin e projekteve të tilla, Qeveria maqedonase e bën me qëllim që të dalë fitimtare në kontestin me Greqinë e indirekt të sfidojë shqiptarët ashtu siç është edhe duke tentuar t`i sfidojë vazhdimisht, duke tentuar të përvetësojë Aleksandërin e Madh, Skënderbeun, e së fundi edhe shkupjanen shqiptare, Nënë Terezën tonë të famshme. Qëllimi im nuk kishte të hyja në debate mbi lashtësinë e maqedonasve të lashtë, me viset e banuara nga to etj, edhe pse

pretendon ti. Ato janë vetëm paragjykime tuaja që i sajon personalisht ti, e që tenton që përmes pyetjeve të bëra në tekst të dialogosh me veten tënde. ***E treta*,** fushata sllavomaqedonase shkon direkt drejt hegjemonizimit të Shkupit dhe Maqedonisë, duke e stërmbushur Shkupin dhe Maqedoninë me figura antike, që gjoja se na qenkan të tyre. E ato i din secili, që nuk janë figura të tyre. Të kujt janë e lë të përgjigjesh ti, ti zbulosh dhe të interesohesh ti. Njëkohësisht tentativa e Gruevskit dhe e Qeverisë aktuale, si dhe e sllavomaqedonasve të tipit të Mitkos, që të gjejnë gjurmët e lashta edhe në Pakistan (në bazë të termit Paki Stani-Paki Zgjohu), e ku e di se ku tjetër, janë veprime të pajustifikueshme, që duhet të dënohen nga secili intelektual shqiptar. Maqedonia e sotshme e Gruevskit në vend se të shikojë të ardhmen e ajo është integrim në familjen evropiane, ajo merret me kërkime të gjurmëve të lashta në parahistori, e nuk e di se ku do të vejë. Unë mezi pres të arrijnë deri në Kurdistan, në bazë të ndonjë termi domethënës prapë në maqedonisht. (Kuptimin në shqip të këtij termi u kërkoj ta zbuloni vet ju z. Zenun). A thua pse ne shqiptarët nuk jemi aq të marrë që t`i kërkojmë gjurmët tona të lashta në Amerikë, në bazë të kuptimit domethënës të Amerikës në shqip, që i vjen Ha, merr edhe ik? Shkrimi apo reagimi i juaj është përplot me ambiguitete dhe dilema. Ju thoni se në kohërat antike dhe më të vonshme nuk ka se si të mohohet prania e maqedonasve, krahas ilirëve dhe të tjerëve. E në fakt nuk e dini, se maqedonasit e lashtë nuk kanë qenë asgjë tjetër përpos ilirë. Ju i ndani këta nga ilirët. Me ç`rast i dilni në krah tezave sllavomaqedonase. Ju nuk keni shpjeguar se pellazgët janë të një etnie me ilirët. Ju nuk shpjegoni se epirotët, maqedonasit e lashtë, trakët, dakët quheshin me emra të ndryshëm, por ishin etni e njëjtë me ilirët. E njëjta gjë ndodhi edhe me pellazgët. Maqedonasit antik janë quajtur nga autorët antik si Pellazgë, pra direkt të një etnie me epirotët. Edhe Justini, edhe Herodoti e pranojnë një gjë të tillë. Kësisoj del se Maqedonia antike është quajtur Pajoni, pra ka qenë ilire, ose më saktësisht që ta kuptosh ti, nuk ka se çka të kërkohet nga Mitkoja gjurmë antike tek etni që nuk kanë lidhje me etninë e Mitkos, sepse sllavomaqedonasit janë krejtësisht krijesa tjera për dallim nga maqedonasit antikë që në fakt kanë qenë ilirë, e kjo i bien shqiptarë të sotshëm. Kësisoj të thuash se teza e dominimit të trojeve ilirike apo ballkanike nga maqedonas antik, ilirë dhe trakas është e favorshme për shqiptarët si dhe për malazezët, boshnjakët, dhe këta maqedonasit e sotshëm, që unë i quaj sllavomaqedonas, është blasfemi e radhës. Pse? Sepse nuk mund të jetë e favorshme për ata, diçka që është e favorshme për ne. Ata nuk pranojnë lidhje të shqiptarëve me ilirët e ti del si shpëtimtar i tyre dhe thua se është teza jote e favorshme për maqedonasit, malazezët, boshnjakët. Nga vet fakti që i ndan maqedonasit antik nga ilirët bën gafë të madh. Maqedonët antik që shtriheshin diku nga liqenet e Ohrit, Prespës kishin në kufi në lindje Trakinë, e në veri mysët, ndërsa në jug Epirin dhe Thesalinë. Por çfarë ishin në fakt këta maqedonasit si dhe epirotët? Ata ishin të një etnie me ilirët, pra nuk mund të bahet një veçim mes tyre, ata ishin ilirë. Maqedonia është quajtur EMATHIA[54] që në shqip d.m.th. e madhja, me kryeqytetin Pela, e në shqip dihet se çfarë është Pela e kjo ngaqë maqedonasit antik ishin ruajtës të kuajve. Straboni bile thotë se Maqedonia është konsideruar si pjesë e Trakisë e me këtë na bën me dije se nuk ka ndonjë etni maqedone të veçantë. Ata janë, thjesht, fise ilire, trake, epirote, të një etniciteti. Homeri maqedonasit i quan si pajon, ndërsa nuk kemi aspak veçim të maqedonasve nga ilirët, ata, thjesht, janë ilirë. E ndërsa Epiri vjen nga shqipja që d.m.th. i epërm, ose i lartë. Grekët e sotshëm thonë që i kanë vendosur emrin Epir, për shkak të

[54] http://en.wikipedia.org/wiki/Emathia

tokës që është stere ose tokë mbi ujë. Plutarku thotë që maqedonasit dhe epirotët flitnin të njëjtën gjuhë. Krejt në fund konkludojmë se maqedonasit antik janë ilirë, sikurse epirotët dhe pellazgët. Ndërsa Leka i Madh kishte gjuhë nëne ilirishten dhe greqishten artificiale që përdorej për letrat që ia mësoi Aristoteli. Kësisoj maqedonasit antik, që në fakt janë ilirë të së djeshmes dhe shqiptarë të sotshmes, janë njerëz të një gjuhë të ndryshme nga greqishtja e sotshme dhe ajo e lashtë, si dhe nga sllavomaqedonishtja. Meqë maqedonët antik përdornin gjuhën greke në monedha, kjo nuk do të thotë që duhet të zëvendësohet periudha helene me periudhë maqedonase. Nëse lypset të zëvendësohet, duhet të zëvendësohet me periudhë ilire. Pra, nëse duhet të kemi polemika dhe konteste me grekët, jemi ne shqiptarët e assesi sllavomaqedonasit e Mitkos dhe Gruevskit. Andaj edhe tentativa e tyre për maqedonizim të helenizimit është blasfemi. Ata janë sllavë dhe asgjë më shumë, sepse kanë ardhur në shek. VII në këto troje si fise barbare. E ndërsa ne si shqiptarë, lypset të kërkojmë që në vend të helenizimit të përdoret termi ilirizim. Po kjo e drejtë na takon vetëm neve shqiptarëve e jo sllavomaqedonasve të Gruevskit dhe Mitkos. E ti zotrote duhet të kundërshtosh me ngulm përpjekjet dhe orvatjet e Mitkos e jo duke mëtuar mbi "hamendësitë e mia" të kundërshtosh orvatjet e mia për nxjerrje të vërtetës si dhe për demaskim të demagogjive të Mitkos dhe qeveritarëve maqedonas. Tentimet e Mitkos shkojnë në dëm të shqiptarëve e në dobi të tij. Sepse ai është në mision për të gjetur diçka, gjoja se që do të ketë lidhje me maqedonasit antik, që të shpëtojë kombin e tij renegat dhe surrogat, që është sajuar mbi gërmadhat dhe fatkeqësitë e shqiptarëve, nga ana e Titos në Jajce të vitit 1944, me një qëllim: Shpëtimin nga kontesti grek, bullgar e pse jo edhe ai shqiptar. Andaj zotrote, mos u bëni shpëtimtar i një kombi të kontestuar me tezat e juaja, sepse me (pa)dije i ndihmoni Mitkos dhe të tjerëve si ai. Thjesht, shndërroheni në Shën Nikollë dhe shpëtimtarë për këtë komb të kontestuar. Andaj, nuk ka edhe shumë nevojë të pastroni me mua të kaluarën, sepse duke e pastruar të kaluarën, e turbulloni të tashmen dhe të ardhmen.

Kumanovë, 9 Shtator 2009

MUND TË NDODHË EDHE KJO

Ishte me të vërtetë një akt i turpshëm injorimi i faktorit politik shqiptar të Kosovës dhe shtetarëve të Kosovës, nga ana e "presidentit" të Maqedonisë. Poashtu këtij turpi i shtohet edhe turpi tjetër i radhës. Pjesëmarrja e faktorit politik shqiptar nga Maqedonia, heshtja përballë asaj që nuk duhej heshtur, pranimi i asaj që nuk duhej pranuar. Loja e kurdisur me shumë mjeshtri nga ana e Gruevskit, Ivanovit dhe të tjerëve po ia del të sfidojë politikën mbarëshqiptare në Ballkan. Kjo lojë politike e tyre arriti të vendosë dhe zbatojë me shumë sukses politikën "Divide-Impera" ndaj faktorit politik shqiptar në Maqedoni. Tani faktori politik shqiptar, i bazuar në parime krahinore, ku secili qytet ka më nga një parti, nuk ka kohë të merret me atë që na takon. Në vend që të merremi me problemet madhore të shtetit ku bëjmë pjesë edhe ne, ne merremi me problemet e mëhallëve e bile as këto probleme nuk mund t`i zgjidhim deri në fund. Faktori politik pjesëmarrës në Qeveri në vend që të kundërshtojë dhe të ushtrojë ndikimin e tij ndaj politikës së paskrupullt të Gruevskit dhe instrumentit të tij, Ivanovit, ata shkuan dhe morën pjesë në inaugurimin e presidentit të maqedonasve. Kësisoj ata vërtetuan se nuk janë më faktor legjitim i shqiptarëve, sepse po të ishin, nuk do të shkonin në ceremoninë e inaugurimit të një presidenti të zgjedhur nga të gjithë, përpos shqiptarëve. Ky president i një komuniteti, atij maqedonas, nuk e kishte legjitimitetin e shqiptarëve në zgjedhje. Andaj edhe prezenca e shqiptarëve në atë ceremoni ishte e panevojshme. Dy partitë pjesëmarrëse në këtë ceremoni inaugurimi dëshmuan se nuk janë asgjë tjetër përpos një vegël që mashtrohen shumë lehtë, si dhe që janë sehirxhinj par excellence të Gruevskit. Mosftesa e presidentit Sejdiu, dëshmoi se kjo çupa adoleshente e quajtur Maqedoni, ende nuk e ka harruar dashurinë e saj të parë, Serbinë. Kjo çupë që me shumë mjeshtri po luan lojën e më të fortit, duke hapur probleme edhe më tej me fqiun e saj, Greqinë, si dhe me shqiptarët në të gjitha anët, po ia del me sukses të tregohet se gjoja është faktor relevant në Ballkan. Po normal që ka të drejtë të synojë kështu. Kur në legjitimimin e politikës së saj marrin pjesë direkt politikanët shqiptarë, të cilët të etshëm për pushtet kanë harruar çdo gjë sublime, për të cilën janë zotuar. Faktori politik shqiptar, në vend që të ofrojë alternativën e bashkimit, ofron alternativën e parcializimit dhe fragmentarizimit. Ky faktor e ka mësuar përmendësh togfjalëshin "Marrëveshja Kornizë e Ohrit" thuajse kjo marrëveshje është e shenjtë, është kuranore ose bibël, e jemi në vitin 2009 e do të kalojnë shumë vite e nga kjo marrëveshje me sa duket asgjë. Faktori politik shqiptar, në vend të unifikimit, ofron përçarjen në baza të qyteteve, në vend të shikimit të çështjeve madhore, ata merren se kush është më lojal ndaj interesave të shtetit të ndërtuar prej qelqi. Ndërsa uji shkon në mulli të qeveritarëve maqedonas, të cilët siguruan pushtetin absolut, mbollën mollën e sherrit ndër partitë shqiptare dhe i përçanë ata. Gruevski dhe të tjerët e sojit të tij triumfuan ndaj shqiptarëve, tani potencën e tyre dhe krenarinë e të qenit më i fortë e treguan edhe ndaj Kosovës. E kësisoj edhe ndaj Shqipërisë. Tani me sa duket kanë filluar tregimin e muskujve edhe ndaj Greqisë. Do të vendosin përmendore, statuja, do ta budizojnë Shkupin me statujat e miteve të rrejshme, të cilat nuk kanë lidhje aspak me realitetin e këtij shteti dhe kombi surrogat, do të ndërtojnë kisha dhe kryqe dhe kësisoj Maqedonia dhe kryeqyteti i saj, Shkupi, do të duket sikurse Perandoria e Shenjtë Habsburge, ndërsa Gruevski do të ngjasojë me Ferdinandin II. Edhe pse Habsburgët ishin katolikë, e kryeministri ynë është ortodoks, vetëm feja i bën të dallueshëm mes veti. Ata kanë shumëçka të përbashkët. Fanatizmin dhe zellin

fetar, shpalljen e vetes superior ndaj të tjerëve, kokëfortësinë etj. Por, Gruevski harron se Habsburgët janë pjesë e historisë së dështuar. Atë duhet t`ia përkujtojnë partitë politike shqiptare. Sllavizimi i Shkupit nuk ndihmon në mirëqenien e këtij shteti. Qeveritarët shqiptarë duhet të ndërmarrin diçka e jo të rrinë si sehirxhinj e të presin se çfarë do u thonë të tjerët. Ndodhën një sërë veprimesh antinjerëzore të kësaj Qeverie e shumë pak kemi reagim nga këta qeveritarë. Sllavizohet Shkupi, burgosen "kriminelët" shqiptarë, tmerrohen shqiptarët me aksione policore, injorohen shqiptarët e prapë heshtje. Prapë si më parë. Zvarritet vendosja e marrëdhënieve diplomatike me Kosovën, e prapë heshtje. Mbahen zgjedhjet presidenciale, kandidati i VMRO-së si dhe fituesi i zgjedhjeve nuk ofron asgjë konkrete për shqiptarët. E absurdi i radhës, po ky presidenti jolegjitim i shqiptarëve, legjitimohet nga partitë politike shqiptare, si dhe nga disa "këshilltarë" shqiptarë që sorollaten rreth tij. Kjo nuk është mëkat, kjo është më shumë se mëkat. Por, e ardhmja e cila si çdoherë mbetet e hapur nuk parasheh të mirën për këtë shtet, nëse vazhdohet me këtë politikë. Sepse ambiciet, siç na mëson historia, shpiejnë në dështime. Gruevski dhe marionetat e tij, Ivanovi, e të tjerët, si dhe legjitimuesit e politikës së tij ndër shqiptarët, duhet të kenë të qartë se kjo Republikë e brishtë siç ja ka filluar të sillet me fqinjët, vështirë se mund të mbijetojë. Sepse politika e fqinjësisë së mirë nuk është në provokim të fqiut e as në provokim dhe nënçmim të popullit shtetformues. Qeveritarët aktualë shqiptarë në vend se të ndërpresin këtë politikë, ata merren me degët dhe riorganizimin e degëve si dhe me kërcënimet për ngarkime e shkarkime nga postet e drejtorëve, ministrave etj. Në mesin e qeveritarëve aktual ka zënë vend amullia dhe një mjegulli e paparë, saqë edhe veprimi i intelektualëve brenda tyre është venitur dhe limitizuar maksimalisht. Ndërsa maqedonasit "antik" të Gruevskit në kërkim të identitetit të humbur, janë shndërruar në kërkues të gjurmëve të humbura e të pagjetshme në Pakistan, sepse sipas tyre, e gjithnjë të bazuar në gojëdhëna, ata i kanë gjurmët edhe atje, gjoja se duke kërkuar nga Paki të zgjohet. Me të drejtë ndaj brengën me një analist shqiptar të njohur nga Maqedonia, i cili brengoset se mos vallë këta maqedonas antik të Gruevskit do t`i kërkojnë rrënjët edhe në Kurdistan, në bazë të ndonjë gojëdhënie tjetër, më të çuditshme. Atyre, edhe pse ju ka rënë unaza në ndonjë det, ende mëtojnë të kërkojnë unazën në ndonjë pus. Por, duke kërkuar në pus dhe duke e përulur kokën sa më thellë, "brengosem" se mos vallë do të rrokullisen në pus, të bijnë në të e mos të nxirren më as nga pusi, por të pusohen së bashku me sehirxhinjtë dhe me marionetat e tyre shqiptarë. Andaj, kujdes se mund të ndodhë edhe kjo.

Tetovë, 19 maj 2009

Pjesa e katërt

(Kapitull i veçantë dhe ekskluziv)

ENCIKLOPEDIA E MONSTRUMËVE

Me të vërtetë, i gjithë kombi shqiptar, të gjithë intelektualët dhe mbarë kori diplomatik në Maqedoni u shtang nga publikimi i këtyre ditëve i një enciklopedie fashizoide të ca njerëzve akademikë ksenofobë, të cilët të mpirë nga ëndrra për të mos parë shqiptar, vodhën helm e vrer në këtë libër mbi kombin më të vjetër në Ballkan. Kjo enciklopedi, e cila pushtoi faqet e gazetave, internetit dhe medieve, përderisa në njërën anë acaroi në kulm marrëdhëniet edhe ashtu të brishta ndëretnike në shtetin e quajtur Maqedoni, ajo në anën tjetër sensibilizoi opinionin shqiptar këtu, në Kosovë dhe Shqipëri për t`u bërë tok si dhe më në fund për t`i pasur qëndrimet në një vijimësi. Por, shtrohet pyetja se ç`farë mesazhesh për shqiptarët përçoi publikimi i kësaj enciklopedie të përpiluar nga monstrumë dhe kanibalë të llojit të veçantë. ***E para,*** ajo dëshmoi se në shtetin e quajtur Maqedoni, shqiptarët janë të padëshiruar dhe se zgjidhja e problemeve të tyre nuk mund të bëhet asnjëherë, pra nuk ka predispozita për zgjidhjen e problemeve të tyre**. *E dyta,*** ajo mëton të bëjë relevant kombin e kontestuar maqedonas, i cili për çdo vjet vjedh herë nga shqiptarët, herë nga grekët, herë nga bullgarët, herë nga serbët histori, e kësisoj dëshmon se ky komb më shumë armiqësi ka me shqiptarët se sa me tjerët. ***E treta,*** kjo enciklopedi nxjerr në pah ambiciet e sëmura dhe shovene të të sëmurëve, që fatkeqësisht janë akademikë, por edhe i bën të qartë auditorit mbarë shqiptar se herëdo kurdo këta maqedonas do të çlirojnë Maqedoninë e tyre nga pllanincat dhe malësorët shqiptarë. ***E katërta,*** kjo enciklopedi e cila është në të njëjtën vijimësi me ***"Nacertanien "e Grashaninit, me "Mein Campf"in e Hitlerit, me "Megalidhenë e Venexelosit"*** dëshmon edhe më tutje se Ballkani është shumë larg të qenit stabil dhe nuk meriton ende të jetë pjesë e UE-së, ose t`i hiqen vizat për Evropë. Ky nacionalizëm shoven, po të buronte nga qarqe rruge, me siguri se do të ishte shqetësues, por jo edhe aq, mirëpo të vjen nga qarqe akademike, kjo nuk mund të kapet absolutisht nga njeriu normal, sepse vetëm njerëzit që nuk janë normal me mendjen nxjerrin haptazi ksenofobinë feudale apo skllavopronare nga qarqe akademike ndaj një kombi, i cili bëri çmos që të mbajë gjallë këtë shtet me këmbë të qelqta. Kjo enciklopedi e monstrumëve në krye me Blazhe Risteskin, dëshmon proverbin se më me rëndësi është të studiohen njerëzit se sa librat, se librat i shkruan njeriu. Por, do të merresha me studimin e personalitetit të Bllazhe Risteskit, sikurse ky i fundit të ishte njeri, po ja që nuk merrem me studimin e monstrumëve. Andaj, e lë që me studimin e tyre të merret ndonjë njeri kompetent në këtë fushë, nëse eventualisht ka.

Enciklopedia përderisa poshtëroi mbarë shqiptarët, ajo sensibilizoi këta të fundit të jenë më vigjilentë dhe në kohezion të gjithëmbarshëm. ***E para,*** ajo detyroi partitë shqiptare në Maqedoni të mendojnë më thellë para se të zhyten në aventurat qeveritare, ***e dyta*** i detyroi të reflektojnë me thellë shqiptarët që marrin çmime nga kjo akademi e monstrumëve që t`i kthejnë ato çmime, sepse ata që i japin këto çmime të njëjtë kanë qenë edhe atëherë kur i kanë akorduar këto çmime e edhe tani, ***e treta*** detyroi partitë shqiptare dhe akademikët shqiptarë të reflektojnë mbi krijimin e një akademie paralele shqiptare në shtetin e quajtur Maqedoni, ku me të vërtetë shkenca do të zinte vend aty, e

jo ksenofobitë dhe idetë kanibaliste. ***E katërta*****,** i bëri me dije faktorit ndërkombëtarë amerikan dhe britanik se ky shtet është larg të qenit i gatshëm për hyrje në UE, ***e pesta*** i bëri me dije Shqipërisë dhe Kosovës se ky shtet nuk i sheh me sy miqësor këto shtete, por me sy armiqësor, andaj edhe veprimi duhet të jetë reciprok, e shumë e shumë gjëra të tjera, që janë thënë e që kanë për t`u thënë me tutje.

Për çfarë shkence maqedonase mund të flitet, kur ajo nuk i shërben mirësisë, por urrejtjes. A. Stipçeviq në një rast kishte thënë që asgjë nuk e prishë njeriun më shumë se libri i keq. Andaj, ndaj kësaj fatkeqësie të quajtur libër, njeriu jo rrallë është i pafuqishëm. Por, mbi të gjitha ai duhet të reagojë. Po ku ishte reagimi i akademikëve maqedonas dhe i qeveritarëve maqedonas. Ata duke përdorur fjalorin e tyre me ambiguitete dhe përplot dilema, nuk thanë atë që duhej thënë, distancimin nga shkrimet shovene dhe dënimin e tyre. Të cilësosh një komb më të vjetrin në Ballkan si pllaninci, të vjedhësh historinë e tyre, personalitetet e tyre që kanë marrë çmime nobel për paqe, të njollosësh lider të cilës do qoftë partie politike qofshin ata, të cilësosh ato si terroristë kur dihet se të njëjtit kontribuan për këtë shtet për të mos u prishur, të fyejsh një komb të tërë e edhe më tutje të jesh pjesë e kësaj akademie, kjo është pjesëmarrje në krim. Andaj, hapin që duhet bërë shqiptarët, edhe pse u dha lajmi që enciklopedia do të tërhiqet (e ajo u publikua më, tani sikurse të shkruhet gjithçka mirë për shqiptarët aty nuk ndez dot, sepse u fyem dhe u poshtëruam e nuk kemi nevojë për mëshirë), është që të nxitet hapja e Akademisë së mirëfilltë shqiptare në Maqedoninë e kontestuar si dhe në rishikim të pjesëmarrjes në Qeveri të partisë shqiptare në pushtet. Këtu nuk duhet të rrijë duarkryq edhe opozita. Ajo në vend se të protestojë duhet të veprojë. Sepse ata që na poshtëruan me këtë enciklopedi janë monstrumë që nuk u trembet syri nga protestat, po nga veprimet konkrete. Se këta akademikë monstrumë para se të merreshin me shkencë, është dashur të emancipohen, po ja që nuk janë emancipuar. Andaj nuk kemi kohë te merremi me to, por duhet të merremi me veten tonë, pra të fillojmë të veprojmë si duhet dhe të bëhemi zot të vetes sonë.

Kumanovë, 26 shtator 2009

ZGJIDHJA ËSHTË ATY, PO JU "NUK E SHIHNI" DOT

Kombi është një grup njerëzish politikisht të vetëdijshëm që kanë një ndjenjë të përbashkët përkatësie në saje të veçorive dhe rrethanave të caktuara historike. Ky definicion mbi kombin është i pranuar nga shumë sociologë. Ka edhe definicione të tjera, që normalisht janë të përshtatshme dhe llogariten si të sakta, por ky i mësipërmi më tërhoqi më shumë vëmendjen. Por, ky definicion vlen për kombet që janë të vetëdijshëm politikisht, e jo për kombet artificiale apo renegate.

Kësisoj duke e dëgjuar kryeministrin e Maqedonisë, z. Nikolla Gruevskin, duke tentuar të fajësojë BE- në për gjoja se ndëshkimin e Maqedonisë për shkak të mospranimit të kësaj të fundit të zhduken si komb më vie për të qeshur dhe për të qarë njëkohësisht. Ditë më parë Brukseli për shkak të vetos greke i tha "Jo" Maqedonisë, dhe i dha afat edhe 6 muaj për të zgjidhur problemin e emrit. Por, duket se ky problem nuk do mund të zgjidhet dot me kryeneçësinë e shtetarëve maqedonas dhe me tentimin e tyre për përvetësim të historisë së të tjerëve. Jo rastësisht kombet artificiale nuk kanë probleme me emrin dhe me qenësimin sot. Kësisoj edhe kombi antik maqedonas i Gruevskit bie në këtë kategori. Pse e them këtë? Sepse, asnjë kronikan, asnjë historian nuk i përmend në asnjë vepër apo enciklopedi këta maqedonasit e sotshëm si komb. Hapësira e quajtur Maqedoni është hapësirë gjeografike që i ka takuar historikisht shqiptarëve e më vonë helenëve. Shpesh herë kam thënë që termi Maqedoni, vjen nga gjuha pellazgo- ilire "Emathia" që do të thotë e madhja, sepse si hapësirë gjeografike Maqedonia ishte e madhe. Por, sllavët e Maqedonisë, të cilët me ngulm kërkojnë të kenë monopol mbi këtë emër, janë duke bërë tentim si çdoherë për vjedhje të historisë nga të tjerët. Kombësinë maqedonase e sajoi Tito në Jajce me të vetmin qëllim, krijimin e një tampon zone apo linje mazhino mes serbëve dhe bullgarëve, për të penguar ekspansionin serb si dhe për të penguar afrimin mes serbëve dhe grekëve. Kësisoj Tito duke u dhënë beneficione të mëdha pjesës pro bullgare, i detyroi ata që të heqin dorë nga ndjenja e tyre nacionale dhe të përqafojnë një ndjenjë tjetër. Kjo strategji e Titos, ishte në dëm të shqiptarëve kuptohet, sepse me krijimin e shtetit të Maqedonisë, shqiptarët të gjendur përballë gjenocidit sllav u detyruan të shpërngulen nëpër Turqi, të migrojnë nëpër Evropë, të shpërndahen gjetiu etj. Fakt më i gjallë për këtë është shifra e përqindjes së shqiptarëve në Shkup para LDB-së, respektivisht para krijimi të Maqedonisë së Titos. Pas krijimit të shtetit surrogat, me ndihmën e sivëllezërve të tjerë sllavë, sllavët e Maqedonisë krijuan administratën e tyre sllave, sipas modelit jugosllav duke anashkaluar shqiptarët, ndërsa të gjithë ata që nuk ishin shqiptarë fjala vjen, vllahët u deshtë të emërtoheshin detyrimisht sllavomaqedonas. Ata edhe sot e kësaj dite flasin gjuhën e imponuar sllave. Një gjë të tillë e përjetuan fatkeqësisht edhe vëllezërit tanë shqiptarë të konfesionit ortodoks që në Maqedoni ishin numeroz, të cilëve iu morën kishat dhe iu ndryshua përkatësia në maqedonas. Kemi edhe sot raste ku shumë nëna shqiptare ortodokse nuk dinë të flasin asnjë fjalë sllave, ndërsa djemtë e tyre nuk flasin shqip, sepse janë asimiluar dhe heshtur me dhunë.

Çfarë flet kjo? Kjo flet se sajesa Maqedoni, është artificiale dhe si e tillë nuk mund të ekzistoje dot si emër. Për këtë arsye Greqia përsërit të drejtën e saj suspenzive në mënyrë permanente dhe kategorike duke mos bërë lëshim. Po ku jemi ne shqiptarët në këto lojëra diplomatike? Të heshtur si gjithnjë. Në vend se të kërkojmë edhe ne ndërrimin e emrit të këtij shteti, neve na ndërrohet përkatësia jonë shqiptare nëpër pasaporta dhe na

bëhet maqedonase, e ne heshtim dot. Neve na mohohen të drejtat elementare e ne prapë heshtim. Ne mbahemi peng që të mos hyjmë në Evropë, asaj të cilës i takojmë në çdo aspekt, për hir të një krenarie abdalle për etni apo komb antik maqedonas e ne prapë heshtim. Ne duke heshtur, kështu rrezikohemi të kemi fatin e njëjtë sikurse të vllahëve. Kësaj i ndihmon edhe opinioni i ca mjeranëve të tipit Maks Vello apo Fatos Lubonja në Shqipëri që na quajnë maqedonca, e këtë emërtim për ne do ta përdorte edhe presidenti z. Gjorgji Ivanov para auditoriumit shqiptarë në Universitetin e Evropës Juglindore gjatë një vizite, e ne heshtim prapë si dhe mjeranët tjerë nga Kosova të sojit të Nexhmedin Spahiut, Migjen Kelmendit dhe Halil Matoshit, të cilët duan që shtetin kosovar ta njësojnë me kombin kosovar, duke ndihmuar indirekt sllavët e Maqedonisë për të asimiluar shqiptarët e Maqedonisë, me pranimin e kombësisë maqedonase, sepse sipas tezave të tyre shteti-komb i Maqedonisë nuk ka vend përbrenda për shqiptarët si dhe për pakicat tjera.

Andaj, përpjekja donkishoteske e mullinjve të erës për përvetësim të çdo gjëje prej të tjerëve, të sjell risqe të mëdha, bile edhe risqe për qenësim si etni apo si shtet. Po zgjidhja të nderuar është aty. Emri duhet ndërruar patjetër, ndërsa shteti duhet të jetë i barabartë ndaj shqiptarëve dhe pakicave tjera. Ky shtet duhet të bashkëqeveriset me shqiptarët, sepse jemi të vetmit që ju kemi njohur kombësinë e juaj të paqenë, vetëm e vetëm mos të krijojmë probleme para ndërkombëtarëve, në emër të kozmopolitizmit tonë., përderisa as Greqia, as Bullgaria e as Serbia nuk ju pranojnë dot. Një gjë duhet ta keni të qartë të nderuar shtetarë të këtij shteti. Në mungesë të historisë suaj mos merrni historinë prej të tjerëve, në mungesë të emërtimit gjeografik mos abuzoni me emrin MAQEDONI duke e bërë këtë të fundit edhe përkatësi kombëtare të juajën. Thuani troç që jeni sllavë e mos i lodhni shqiptarët dhe ndërkombëtarët si dhe pakicat tjera me spotet televizive të maqedonasve antikë, e me planet për të budifikuar kryeqendrën dardane Shkupin me përmendore e statuja të figurave historike të të tjerëve, si dhe me kisha në kalanë e Shkupit, sepse dukeni tejet grotesk, sikurse në rastin e tentimit për të përvetësuar Skënderbeun dhe Nënë Terezën. Ashtu edhe me enciklopedinë. Përjetuat fiasko. Tek ne ekziston thënia:” Të hysh dhëndër me pantallona të huaja”. Kjo nuk bën. Andaj, vishni pantallonat e juaja e mos u vidhni pantallonat të tjerëve.

Kjo është zgjidhja dhe çelësi që të bëhemi bashkërisht pjesë e Evropës dhe mos të përjetojmë Bukureshtin e radhës.

Kumanovë, 20 dhjetor 2009

KUMANOVA SHQIPTARE NË PRAG TË VITIT TË RI 2010

Kumanova. Qytet mjaft i dëgjuar. Me një vlerë mjaft të madhe. Me njerëz bujarë, fisnikë, patriotë, të devotshëm kombëtarisht. E pasur me njerëz të penës, artit dhe shkencës. E poashtu edhe me njerëz të pushkës. Besa edhe të politikës. E sfiduar nga halle të ndryshme. E harruar nga politikanët çdoherë. Si qytet gjendet në pjesën e Maqedonisë Veriore me një sipërfaqe prej 1193 km katrorë, me një pozitë jashtëzakonisht të volitshme gjeografike. Çuditërisht edhe këtë vit e kaloi keq e më keq. Përshtypja e parë që krijon secili vizitor është magjepsja dhe hamendja prej dy Kumanovave. Ajo "maqedonase" dhe ajo "shqiptare". Nuk e di se pse. Ky qytet duhet të funksionojë si i tërë, komplet dhe jo i ndarë. Po ja që politikanët deshën ashtu. Ja që qeveritarët shqiptarë të mëparshëm dhe aktual deshën ashtu. Me të vërtetë të vjen për të qarë kur shikon dy pjesët e këtij qyteti legjendar. Pjesa maqedonase evropiane në njërën anë, dhe pjesa shqiptare afrikane në anën tjetër.

Edhe këtë vit Kumanova shqiptare e kaloi me vështirësi zi e më zi. Edhe më tutje rrugët e Kumanovës shqiptare të stërmbushura me ngarkesë komunikacioni, sepse semaforët nuk punojnë. Ndërsa pjesa evropiane e Kumanovës ka semaforë më modernë që të krijojnë përshtypjen se gjendesh në Bruksel. Edhe më tej gropat e rrugëve të Kumanovës shqiptare janë aq të mëdha sa gëlltisin njerëz së bashku me fatet e tyre. Ndërsa Kumanova evropiane e maqedonasve antikë apo e sllavomaqedonasve (këtë nuk arrita edhe më tutje ta kuptoj) është e asfaltuar në çdo centimetër dhe e pajisur me të gjitha gjërat e nevojshme. Edhe më tej Kumanova shqiptare mbeti me objekte shkollore të adaptuara edhe më tej shkollat e Kumanovës shqiptare kanë kulmet e shek. XVII pa menaxhues funksional, ndërsa pjesa tjetër ka objekte shkollore të tipit evropian dhe amerikan. Edhe më tej nxënësi shqiptar nuk mund të mësoj si duhet, sepse nuk ka as nxehje, as karrika e as banka, e besa nuk është si duhet i furnizuar edhe me librat, sepse i mungojnë, ngase Ministria nuk ka menduar për të, ndërsa ai në pjesën tjetër të qytetit i ka të gjitha edhe laboratorët, edhe mësojtoret edhe kabinetet edhe sallat, edhe .....

Edhe më tej Kumanova shqiptare nuk ka kanalizime, e as ujë të pijshëm si duhet, ende pamja e zymtë të vret dhe të krijon përshtypjen e ndonjë qyteti në Togo, ndërsa vetëm disa qindra metra më tutje gjithçka si në ëndërr ndryshon. Edhe më tutje Kumanova shqiptare ballafaqohet me problemin e papunësisë, e me shumë probleme të tjera, ndërsa Kumanova duket sikurse *Champs Elysée* në Paris. Edhe më tutje fëmija shqiptar nuk ka se ku të luaj, ngase në secilin moment është në rrezik jete ose nga ndonjë kamion, ose nga ndonjë veturë, ndërsa ai i pjesës tjetër nuk ngopet me të mirat e dynjasë. Ndërsa prindërit e këtyre dy fëmijëve të të dy Kumanovave paguajnë tatime njësoj. Bile këta të këtij që nuk i përket Kumanovës shqiptare shpesh i ikën tatimeve, sepse thonë "L`etat c`est moi" (Shteti jam unë). Edhe më tej Kumanova shqiptare të vret me pamjen trishtuese të njerëzve me cigare në gojë, të njerëzve që ngjasojnë me Lulin e Migjenit, të njerëzve që ngjasojnë me Shërbëtorin Jernej, me praninë gjithnjë e më të madhe të veturave të llojllojshme të parkuara vend e pa vend, të rrugëve për një kah, po që kalojnë vetura nga të gjitha kahet e mundshme, të dyqaneve dhe trafiqeve të vogla, ndërsa Kumanova tjetër ndërtohet me depo, shitore e supermarkete më moderne. E "intelektualët dhe politikanët" shqipfolës shkojnë pinë makiato në Kumanovën tjetër. Ata paguajnë makiaton 80-120 den. E nuk çajnë kokën për shumicën që pinë makiaton njëri afër tjetrit, sikurse në birë të miut dhe që heqin të zinjtë e ullirit. Edhe më tej Kumanova shqiptare

shtratin e lumit të saj poashtu shqiptar e ka përplot me bërllogje, ndërsa parkun vend për pushim e ka të shndërruar në vend për helmim, ndërsa Kumanova tjetër të kënaq syrin, po jo shpirtin, ngase gjithçka është në vendin e duhur. Edhe më tej fushat sportive të pjesës shqiptare janë vetëm utopi, ndërsa pjesa tjetër i gëzon disa syresh. Kumanova shqiptare e kalldërmave dhe e baltës edhe më tej frymon dhe i numëron ditët e fundvitit me mijëra probleme të tjera të pazgjidhura e pjesa tjetër i numëron ditët e fundvitit me mijëra projekte tjera për vitin pasues. Kumanovës tjetër i mungon vetëm edhe spitali. Të gjitha tjerat i kanë bërë me paratë edhe të vetat e aq më shumë të Kumanovës shqiptare. Kanë besa edhe bibliotekën e qytetit. E Kumanova shqiptare që fatmirësisht përpos pamjes së xhamisë së bukur të ndërtuar me paratë e shqiptarëve e jo të shtetit (ngase shteti ynë "laik" ndërton kisha e jo xhami) nuk ka asgjë të bukur.

Kjo Kumanovë shqiptare më duket edhe më e shëmtuar kur shoh fytyrat e liga të njerëzve që "merren me politikë" apo që e konsiderojnë veten politikanë apo pushtetarë e të tillë nuk janë asesi, të cilët në Kumanovën shqiptare vijnë shesin broçkulla dhe patriotizëm folklorik, ndërsa paratë e tyre i harxhojnë në Kumanovën tjetër, por vetëm dhe jo në çift me bashkëshortet e tyre. Ata në Kumanovën që nuk është shqiptare shkojnë sodisin, pinë, hanë dhe kullosin sytë përballë kamariereve të veshura me mini dhe pasi të kthehen në Kumanovën shqiptare, ju mbushen "sytë me lot". Kumanova shqiptare edhe më tej nuk ka as flamur, as institucione të konsoliduara, nuk përdor as gjuhën shqipe në komunikime me këto institucione, po ç`të bësh, jeta vazhdon.

E pra të nderuar vëllezër, ja, kështu Kumanova shqiptare e mirëpret Vitin e Ri 1010. Ndërsa Kumanova tjetër që nuk është shqiptare, e pret Vitin e Ri 2010.

Në mënyrë të ngjashme me simotrën e saj shqiptare, Vitin e Ri 1010 e presin edhe Shkupi shqiptar, Kërçova shqiptare, Struga shqiptare e shumë qytete tjera shqiptare, me shumë pak dallim Tetova shqiptare dhe Gostivari shqiptar (fatmirësisht në qytetet e fundit shqiptarët për shkak të numerozitetit kanë investuar më shumë e nuk e kanë lënë shtetin të "harxhohet"). Kështu pra e presin Vitin e Ri shqiptarët e shtetit që nuk po e di as vet se si e ka emrin, ngase e quajnë me dy apo tre emra e nuk e di se si do ta quajnë edhe më tej. Ka mundësi t`i shtohet edhe ndonjë emër i ri së shpejti.

Kumanovë, 30 dhjetor 2009

Literatura e shfrytëzuar:

1. Bashkurti, Lisen, Diplomacia shqiptare, Vëllimi 1, Geer, Tiranë 2005
2. Boriçi, Gjon, Mardhëniet ndërkombëtare, GEER, Tiranë 2006
3. Danaj, Koço, 50 Vjet histori e pahumbur, Zëri i Kosovës, Zvicër, 2005
4. Semprini, A.(1997) Le Multiculturalisme, Paris
5. De Carla, M., (1999) Le Multiculturalisme et l`interculturel, Paris
6. Bashkurti, Lisen, Mbi të drejtën ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtare, GEER, Tiranë 2006
7. Clausener, Magali -Petit, Marine Lath-Jeunesse, Les défis en Europe et dans le monde entière, Paris 1999
8. Le rapport de l`Organisation mondiale de la santé, 2003
9. Daniel, Maja/ Jean Marie, Achard: L`état du monde junior -Encyclopédie historique et géopolitique, Paris 2002.
10. Georgieva, Lidija: Menaxhiranje na rizici, Shkup 2006
11. Deniau, Xavier, La francophonie, Paris 2001
12. Zajazi, Tahir, Metodologji të mësimdhënies dhe nxënies, Vinsent Graphic, Shkup 2003
13. Murati, Xheladin, Ndryshimi i arsimtarit dhe i shkollës, Çabej, Tetovë 2005
14. Kadare, Ismail, Identiteti evropian i shqiptarëve, Onufri, Tiranë, 2006
15. Bashkurti, Lisen, Identiteti, Imazhi dhe diplomacia, GEER, Tiranë 2004
16. Mother Teresa, Excerpt from the Nobel Prize Acceptance speech, Sweeden, 1979
17. Serge Metais, Histori e shqiptarëve nga Ilirët e deri tek pavarësia e Kosovës, Fayard, Tiranë 2006
18. Raymond Detrez, Kosovo. De Uitgestelde Oorlog (Kosova. Një luftë e shtyrë), Arbëria, Prishtinë, 2004
19. Fukuyama, Francis, Ndërtimi i shtetit, AIIS, Tiranë 2008
20. Pllana, Qerim, Dilemat për bashkimin kombëtar, PPSHK, Prishtinë 1998
21. Danaj, Koço, Të dënuar të bashkohemi, ALBAO, Tiranë, 2007
22. Kocaqi, Elena, Roli pellazgo-ilir në krijimin e kombeve dhe gjuhëve evropiane, Dajti 2000, Tiranë 2007
23. Beqir, Sadikaj, (2004) Hyrje në sociologjinë juridike, Prishtinë, fq. 63-64
24. Pierre Lequiller, *Head-to-Head, Turkey and the EU,* BBC News, 10/3/2005

Faqe interneti:

1. http://anty83.blogspot.com/2006/02/je-pense-donc-je-suis.html
2. http://en.wikipedia.org/wiki/Emathia
3. http://epautistes.coolbb.net/debats-f15/nationalisme-ou-patriotisme-t1946.htm
4. http://europa.eu/legislation_summaries/enlargement/western_balkans/r18002_fr.htm
5. http://europa.eu/scadplus/glossary/accession_criteria_copenhague_fr.htm
6. http://forums.vmacedonia.com/f11/padni-stani-prerodba-na-nikola-gruevski-22869/
7. http://fr.answers.yahoo.com/question/index?qid=20080716124330AAGDgeI
8. http://fr.answers.yahoo.com/question/index?qid=20090430030310AAKUFNV
9. http://fr.wikihow.com/dire-bonjour-dans-plusieurs-langues
10. http://fr.wikipedia.org/wiki/Adam_Smith
11. http://fr.wikipedia.org/wiki/Balkans
12. http://fr.wikipedia.org/wiki/Chiffres_de_population_en_France
13. http://fr.wikisource.org/wiki/Mahatma_Gandhi_(Revue_de_Paris)
14. http://gazetajava.com/ortman/publish/printer_821/.shtml
15. http://showcase.netins.net/web/creative/lincoln/speeches/gettysburg.htm
16. http://www.infoarkiv.com/media/artikull/iden/123756/titulli/Xhon-F.-Kenedi-dhe-vizioni-i-tij-i-ri-per-Ameriken
17. http://www.ladocumentationfrancaise.fr/dossiers/francophonie/onesime-reclus.shtml
18. http://www.legiondhonneur.fr/
19. http://www.mesazhi.com/author_article_print.php?id=814
20. http://www.nnet.gr/historein/historeinfiles/histvolumes/hist04/historein4-brunnbauer.pdf
21. http://www.un.org/fr/documents/udhr/
22. *www. google. com. fr. TERRE DES FEMMES. org. Fr*
23. www.google.com.les droits des femmes dans le monde entière 20%html.fr

Lista e shkurtesave

AKSH- Armata Kombëtare Shqiptare
ALFA- Njësit Policor Special i Ministrisë së punëve të brendshme maqedonase
ASHAK- Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës
ASHAM- Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Maqedonisë
AUPELF- Agence francophone pour l'enseignement supérieur et la recherche (Asociacioni i Universiteteve Frëngjishtfolëse)
BBC- British Broadcasting Corporation
BDI- Bashkimi Demokratik për Integrim
BE- Bashkimi Evropian
BEE- Bashkësia Ekonomike Evropiane, sot Unioni Evropian
BRSS - Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike
CARDS- Community Assistance for Reconstruction, Development and Stabilisation
CH.F.- Charte de la Francophonie (Karta e Frankofonisë)
CNN- Cable News Network
DALF- Diplome approfondi de langue française (Diploma për mësim thelbësor të frëngjishtes)
DDNJQ- Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarëve
DELF- Diplome d`etude de langue française (Diploma për studime të frëngjishtes)
DELF- Diplome d`etude de langue française (Diploma për studime të frëngjishtes)
DUDNJ- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
EU- Erasmus Mundus (program i shkëmbimit midis universiteteve të BE-së).
FYROM- Former Yougoslav Republic of Macedonia (Referencë e shtetit maqedonas në organizatat ndërkombëtare)
GDP- Bruto prodhimi vendor(gross domestic product)
HIV- Sida
KSBE- Këshilli për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian, sot OSBE
LDB - Lufta e Dytë Botërore
LK- Lidhja e Kombeve
LPB- Lufta e parë Botërore
LSDM- Lidhja Social Demokrate Maqedonase
LSHP- Lidhja Shqiptare e Prizrenit
MKO- Marrëveshja Kornizë e Ohrit
NATO- North Atlantic Treaty Organization (Organizata e Atlantikut të Veriut)
OIF- Organisation Internationale de la Francophonie (Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë)
OKB. - Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
OSHA- Organizata e shteteve afrikane
PDSH-Partia Demokratike Shqiptare
PHARE- Poland and Hungary: Assistance for Restructuring their Economies programme- Programi i Asistencës dhe Rikonstruksionit Ekonomik për Poloni dhe Hungari
PP- Partneriteti për paqe

PPD- Partia për Prosperitet Demokratik
RK- Rilindja Kombëtare
RM- Republika e Maqedonisë
RSFJ- Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
SME- Sistemit Monetar Evropian
Sui Generis- Lloj i veçantë
SHBA - Shtetet e Bashkuara të Amerikës
TGV- Train a grande vitesse (Treni me shpejtësi të madhe, inovacion francez në mjetet e komunikacionit)
TV5- Television 5
UÇK- Ushtria Çlirimtare Kombëtare
UDB- Uprava Drzavne Bezbednost (Sektori i Punëve të Brendshme)
UE- Unioni Evropian
UEJL- Universiteti i Evropës Juglindore
UNPROFOR- United Nations Protection Force (Forcat mbrojtëse të Kombeve të Bashkuara)
USHT- Universiteti Shtetëror i Tetovës
UT- Universiteti i Tetovës
VMRO-DPMNE- Vnatresna Makedonska Revolucionarna Organizacija (Organizata e brendshme revolucionare maqedone)

Daljen në dritë të këtij libri e ndihmuan dhe e sponsorizuan:

1. **Fondacioni "Ramadan Sinani"- Tetovë, znj. Shpresa Sinani**
2. **NTP "Benton"- Kumanovë, z. Nazmi Ejupi**
3. **Restoranti "Oaza"- Kumanovë, z. Rufat Ajdini**
4. **NTP "Selman Turizëm"- Kumanovë, z. Taxhedin Ademi**
5. **Restoranti "Metropol"- Tetovë, z. Sherafedin Ahmeti**
6. **NTP "Hulusi Komerc"- Kumanovë, z. Ismail Osmani**
7. **N.P."Neocompani"- Kumanovë, z. Nehat Osmani**
8. **Ordinanca private "Lulja"- Mitrovicë, z. Agim Peci**

Ardian Ramadani është i lindur më 1983 në Kumanovë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu me sukses të shkëlqyer në Kumanovë.

Studimet deridiplomike i ka mbaruar në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, ku ka mbaruar Fakultetin e Trajnimit Pedagogjik e Metodologjik, Dega e gjuhës dhe letërsisë frënge duke u zgjedhur Student i dalluar.

Ka mbaruar studimet postdiplomike me sukses të shkëlqyer, në kuadër të Fakultetit të Administrimit Publik dhe Shkencave Politike në UEJL, Drejtimi i studimeve të diplomacisë, ku ka magjistruar me temën *"Franca dhe diplomacia franceze në periudhën e Risheljesë, shteti-komb dhe doktrina Raison d`État",* me ç`rast mori edhe titullin magjistër i Studimeve të Diplomacisë në kuadër të Fakultetit të Administratës Publike dhe Shkencave Politike.

Ka qenë deputet i Maqedonisë në Parlamentin Frankofon të të Rinjve në Bruksel. Ka punuar për tre vite me radhë profesor i gjuhës frënge në gjimnazin e Kumanovës si dhe për tre vite të tjera profesor i gjuhës frënge në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë. Është ligjërues edhe në Akademinë Diplomatike Shqiptare në Tetovë.

Aktualisht është sekretar i Fakultetit të Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë.

Ardian Ramadani është autor i rregullt i shumë shkrimeve, artikujve dhe analizave nëpër web portale të ndryshme, revista dhe gazeta të përditshme shqiptare në Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë.

Deri më tani ka botuar librin "*Franca dhe diplomacia franceze në periudhën e Risheljesë, doktrina Raison d`État dhe Shteti-Komb*". Ky është libri i tij i dytë.
Ardian Ramadani jeton në Opajë të Kumanovës.